Rruga e Arbërit

SKËNDERBEUT - 2018 - VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (151) / 2018. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Profil

Liman Hoxha, jo vetëm sukses, por edhe vlerë për të tjerët

Nga **SHAQIR SKARRA**


12

Reportazh

Përkujtohet rikthimi i Skënderbeut nga Nishi në Dibër


Nga **AZIS KETA**


7

Homazh

Zeqi Agolli dhe Mit'hat Frashëri në Betejën e Dibrës, nandor 1943

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**


22

Ja ku po punohet në Rrugën e Arbrit

- **Nga 6 tunele qe ka projekti i Ndërtimit të Rrugës së Arbërit, deri më sot janë hapur 2 prej tyre, është në përfundim tuneli i tretë dhe po punohet per hapjen e tunelit të Murrizit. Gjatësia e tuneleve të hapur është 1.55km, nga rreth 8km gjithsej që ka projekti.**

- **Një punë kolosale është kryer për ndërtimin e katër urave kryesore. Kështu është përfunduar struktura e Urës mbi Lumin Zalli i Bulqizës me gjatësi 150m, si dhe është ne përfundim ndërtimi i strukturës së Urës mbi Drinin e Zi, e cila ka një gjatësi prej 270m.**

- **Një punë tepër voluminoze dhe e vështirë po kryhet për ndërtimin e Urës së Vashës me gjatësi 280m dhe lartësi 152m mbi nivelin e Lumit Mat. Ketu po kryen punimet për ndërtimin e themeleve, për të mundësuar që brenda këtij viti të fillojë montimi i strukturës së çeliktë të urës.**

Nga **ALMIRA ZEBI XHEMBULLA** - faqe 8



Aty ku hidhen themelet e Urës së Vashës. Foto: © Grehans Uka



Ndërtimi i rrugës Arras - Lurë, domosdoshmëri për zhvillimin e turizmit dhe kërkimin e mineraleve

Nga **VESEL HOXHA***

- **Para se të përfundoj ndërtimi i Rrugës së Arbërit, dibranët duhet të mendojnë për hapat e mëtejshëm të projektimit e ndërtimit të magjistraleve të tjera rrugore për të garantuar një zhvillim të shpejt e të qëndrueshëm, për ti paraprirë perspektivave zhvillimore që ofrojnë pasuritë natyrore të saj në të gjithë territorin e bashkisë, të mbitokës dhe të nëntokës.**

(lexoni në faqet 3-4)

NË BRENDËSI:

- Velenja e Sllovenisë, shembulli që duhet ndjekur për zhvillimin e Bulqizës
- Përtej kufirit të Dibrave, me fare pak identitet
- Çfarë i kemi borxh Gjergj Kastriotit?
- Kuvendi i Lezhës
- Skënderbeu dhe martirizimi i pashoq i Dibrës
- Për një Shqipëri europiane, jo otomane
- Orkestrina e Matit njëra nga mrekullitë e trashëgimisë shpirtërore shqiptare
- Zjarret në pyje, si të bashkëveprojmë për t'i parandaluar



Rruzhdi Lata e donte Dibrën pa kufij

E donte Shqipërinë e Kosovën.
I donte shqiptarët pa dallim.

Nga **MUSA RIÇKU**

Rruzhdi Latën e kam njohur në vitin 1992. Ishte kohë që ai jetonte mes Prishtinës e Dibrës. Ai jepte ligjërata në Universitetin e Prishtinës në fakultetin e Orientalistikës, por jo në mjedise auditoresh, por në një shtëpi private. Pashë në sytë e tij dhe ndjeva në fjalën e tij se Dibrën e kishte në zemër.

Ajo që na afroi e na miqësoi ishte besimi.Pas atij takimi, shumë shpejt u kthyer në Dibër dhe prej atëherë jemi takuar vazhdimisht. Ndarja e tij nga kjo botë ishte e parakohshme, bash në kohën kur puna dhe angazhimi i tij fetar, politik e shtetar po jeptë frytet e veta. Tashmë këto arritje do t'i shohë nga Xhehneti.

(lexoni në faqen 15)

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 151
speciale

Unaza e Peshkopisë, asfaltohen 3.3 km

Unaza e qytetit të Peshkopisë duket se është drejt përfundimit. Sic raporton ABC Neës, 3.3 km të kësaj rruge janë asfaltuar ndërsa pritet që së shpejti të përfundohet edhe pjesa tjetër.

Unaza e qytetit po shkon kështu drejt përfundimit. Ajo ka një histori të vjetër për banorët e Peshkopisë, pasi ndërtimi i saj ka filluar 33 vite më parë, që në vitin 1985, por pavarësisht premtimeve fushatë pas fushate, ajo vetëm tani po shkon drejt përfundimit. Financimi i saj, prej 2 milionë Eurosh, është bërë i mundur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Rruga është projektuar me të gjithë infrastrukturën mbështetesë, kanale kullimi, ndricim etj.

Ndërtimi i saj do të ulë fluksin e lëvizjes së makinave në qytet si dhe do të krijojë shumë lehtësi për makinat e tonazhit të rëndë.



Bulqizë, mungon landfilli për përpunimin e mbetjeve urbane

Organizata “SHERM” po realizon në Bulqizë projektin “Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane” që financohet nga Lëviz Albania. Organizata ka vëzhguar mjedisin në të shtatë njësitë administrative të Bashkisë Bulqizë (Krastë, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht) dhe ka arritur në përfundimin se mbledhja dhe përpunimi i mbetjeve urbane është një problem i pazgjidhur.



Ekspertë të mjedisit kanë parë në terren gjendjen reale të ofrimit të shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane dhe situata paraqitet ndryshe nga sa është thënë, shumë përkeqësuese. Të flasësh për menaxhimin e mbetjeve urbane, riciklimin, reduktimin, ripërdorim apo ndarja e tyre që në prodhim, kjo është e pamundur për momentin në Bashkinë e Bulqizës, pasi mungojnëkazanët ndarës dhe mungon trajtimi i tyre në Landfill. Mbetjet depozitohen ilegalisht në vendin e quajtuar “Qafa e Buallit”. Ai venddepozitim është pa një leje mjedisore dhe në shumë raste ju vihet zjarri dhe tymi mbulon qytetin.

Bulqiza ka problem dhe mbetjet inerte, të cilat hidhen vend e pa vend si nga subjektet private po ashtu dhe nga komuniteti.

Menaxhimi i Mbetjeve në zonat rurale është tepër i vështirë, pasi ky shërbim nuk ofrohet fare në Njësitë Administrative Trebisht, ku banorët e zonës kanë gjetur si zgjidhje alternative djegien e tyre, hedhjen në perrej e natyrë, ku të munde, dhe ku gjejnë hapësira boshe, duke i kthyer në kosha mbetjesh pa marre parasysh ndotjen që shkaktojnë në mjedis dhe dëmtimet që marrin nga kjo ndotje e shkatuar prej tyre.

Gjatënjë takimi me komunitetin e Trebishtit, u dëgjua mendimi i tyre sesi e mendonin shërbimin e pastrimit, problemet që vijnë nga shërbimi i pastrimit dhe për ti adresuar këto problematika në këshillin Bashkiak, që zëri i tyre të dëgjohet. Në këtënjësi pastriminuk është ofruar nga Bashkia e Bulqizës, edhe pse një vit më parë ishte ofruar një kamioncinë dhe mbetjet ishin larguar nga zona, duke i dërguar në një gropëtë hapur larg fshatit, e cila nuk krijon një ndotje të tokës.

Danjel Bica, ekspert mjedisor i SHERM, së bashku me administratorin lokal Fitim Balla vizituan venddepozitimin dhe ndërhyrjet që mund të bëhen për përmirësimin e kërij shërbimi, në mënyrë që fshati i tyre të jetë më i pastë. Gjatë rrugës, grupi i punës konstatoi mbetje tëdjegura dhe të depozituara buzëlumit Drin, qëvjen nga Dibra e Madhe, që kalon në zonën e Bulqizës. Mes tyre u diskutua edhe mundësitë e bashkëpunimit me Bashkinë e Bulqizës, në mënyrë që sa më shpejtë të përmirësohet mbledhja dhe përpunimi i mbetjve urbane.

Më shumë rreth projekteve mejdisore në Bulqizë ndiq lidhjen: www. sherm-al.org

Posta e Rrugës së Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11 (151). Nëntor 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit dhjetor 2018.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA / BIRN
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:
Vesel HOXHA
Esat RUKA
Edi RAMA
Hajri SHEHU
Irfan ZEBI
Rezehana HYSA
Selman MËZIU
Azis KETA
Besnik KËBEJ
Martin NIKA
Renato TOTRAKU
Mevlud BUCI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **ëëë.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

aktualitet

Ndërtimi i rrugës Arras - Lurë, domosdoshmëri për zhvillimin e turizmit dhe kërkimin e mineraleve

Dibra ka nevojë për shumë rrugë dhe magjistrale të tjera rrugore që duhet të ndërtohen për tu vënë në shërbim të përshpejtimit të vënies në qarkullim ekonomik të pasurive te saj mbitokësore e nëntokësore.

Para se të përfundoj ndërtimi i Rrugës së Arbërit, dibranët duhet të mendojnë për hapat e mëtejshëm të projektimit e ndërtimit të magjistraleve të tjera rrugore për të garantuar një zhvillim të shpejt e të qëndrueshëm, për ti paraprirë perspektivave zhvillimore që ofrojnë pasuritë natyrore të saj në të gjithë territorin e bashkisë, të mbitokës dhe të nëntokës.



Rruga e Lurës. Foto: © FB/ KetuMblidhenDibranët

Nga **VESEL HOXHA***

Për rrugë ka nevojë çdo skaj i atdheut. Rruga sjell zhvillim dhe pa rrugë, zhvillimi nuk duhet pritur. Por, për Lurën ndryshon puna. Bile ndryshon shumë. Një krahinë e tërë pa rrugë lidhëse me qendrën e saj historike e administrative gati një shekullore Peshkopinë, një krahinë që ndër shekuj ka bërë emër të mirë në gjithë Shqipërinë për bëmat e saj në historinë tonë të vjetër e të re, një krahinë aq e njohur për bukuritë natyrore madhështore, ndër më të bukurat e vendit tonë, për vetë specifikat që ajo ka, pa harruar pasuritë minerale etj. që janë dokumentuar jo vetëm nga shumë studiues të vendit tonë por edhe nga të huajt.

Lura turistike me emrin e saj të njohur *jo vetëm për 14 liqenet akullnajorë* me bukuri të rralla por, edhe për hapësirat e tjera pyjore që po ringjallen bashkë me ato livadhore të pa fundme me gjithfarë lulesh, me një morfologji terreni befasuese e mahnitëse, ku midis tyre veçojmë Lanë Lurën e famshme, Fushën e Pelave etj., pa hyrë më në detaje. Në këngët popullore Lura "*nuk ka 14 liqene por, paraqite tme 7 liqene akullnajorë*", me tekste të shkruara dhe kompozime muzikore nga i paharruari dhe eruditi lurian *Hilmi Kolgjegja*, për të cilin shkrimtari, poeti e studiuesi i spikatur *Xhafer Martini*, shkroi një libër me titullin kuptim plotë "Një vend në panteon".

Lind natyrshëm pyetja, *pse nuk ka një rrugë të ndërtuar me projekt nga shteti*, që do ta lidhte Peshkopinë me perlën e natyrës Shqiptare, me Lurën, qoftë dhe pa asfalt, që të funksiononte të paktën në 10 muajt e vitit, duke përjashtuar muajt e dimrit me shumë dëborë? Pse nuk u ndërtua kjo rrugë *gjatë 46 viteve* të kohës së *socializmit enverian* dhe*28 viteve* të *demokracisë laramane*, që për shumë arsye të pa arsyeshme, po vonohet së tepërmi vendi ynë drejt Europës, drejt përparimit e zhvillimit, të paktën të ishim të krahasueshëm me fqinjët? Përgjigjet janë komplekse dhe shumë të vështira për tu dhënë.

Vendi ynë po humb shumë kohë me gjëra që vetëm zhvillim nuk sjellin, as për fshatin, as për njësinë administrative, as për bashkinë e as për Shqipërinë tonë të dashur, por vetëm luftë partish për pushtet ku secila paraqitet me etur se tjetra, pa alternativa të qarta zhvillimi, *me caktim deputetësh nga listat e kryetarit të partisë*, në një kohë që e kemi lënë pas diktaturën, dhe jemi në të ashtuquajturën demokraci!? A thua se emisionet e "Opinion-it"në tv Klan apo të gjitha simotrat e kësaj kategorie nëpër televizione të tjera, do të zgjidhin problemet reale të popullit, do të zgjidhin problemet e investimeve prodhuese në Shqipëri, për ta shpëtuar vendin nga papunësia që e ka pllakosur bashkë me varfërinë? Apo emisione televizive si kategoria e emisionit "Histori Shqiptare" dhe drekat me mish qingji në përfshatrat e Shqipërisë do ta zhvillojnë turizmin etj.!? Mendoj se jo. Ata"*rrahin fjalët në debate shterpe*" por, nuk ndërtojnë rrugë, as nuk sjellin investime prodhuese për të zhvilluar edhe fshatin më të thellë të vendit.

Rrugët ndërtohen edhe duke u zgjuar komuniteti nga gjumi i thellë e duke ngritur zërin kudo ku frymohet e jetohet, duke kërkuar e duke kryers tudime e projekte cilësore, jo duke realizuar debate shterpe me *tollovi pa fund* në studiot televizive, deri në mani. Janë *shtuar fjalët dhe pakësuar punët* në dobi të popullit. Ka një mijë arsye pse ndodh kështu, por unë do nënvizoja vetëm një: *Vënia në krye të punëve e njerëzve të pa aftë në çdo qelizë drejtimi të vendit dhe në çdo fushë zhvillimore, të cilëve nuk u ha meraku për hallet e komunitetit por e bëjnë gjumin të qetë. Populli thotë: Nuk i bihet në "thupër Kalit" kur i vihet "gomari" përpara.*

Një krahinë e tërë pa rrugë, e habitshme por e vërtet. *Për dekada lurasit kanë ardhur në Peshkopi në këmbë dhe janë kthyer në Lurë po në këmbë, të torturuar e të rraskapitur*, në një kohë që drejtuesit shkonin në Lurë vetëm me makina, jo për të takuar popullin e për të qarë hallet me të por për të parë liqenet e saj, dhe kjo vetëm në muajin që mund të lëviznin pa ju rrëshqitur makina në

Rruga funksiononte vetëm në verë një muaj ose e shumta dy muaj. E thënë shkurt, rrugë e rregullt me projekt për Lurën ose më saktë nga Arrasi në Lurë, nuk është ndërtuar asnjëherë. Çdo thënie tjetër është një gënjeshtër e madhe ose një"shpifje" siç po përmendet shpesh kjo fjalë kohët e fundit.

baltën e rrugës së traktorit që hapi ushtria para 50 viteve! Habia më e madhe është *edhe ana mashtruese* e bërë sistematikisht ndër vite rreth këtij problemi sa herë vjen dimri, duke publikuar nëpër televizione e gazeta si *të bllokuar nga bora një rrugë të pa ndërtuar*, ku makinat mund të lëvizin vetëm një muaj në periudhën e verës dhe vetëm veturat e larta. Më keq akoma është heshtja ndaj këtij fakti, jo vetëm i Lurasve por dhe i intelektualëve dibranë?! Më ka bërë përshtypje të madhe fakti kur jepej rëndomë në lajme me titra pothuajse nga të gjithë televizionet e Tiranës, *se është e pakalueshme rruga Peshkopi - Lurë*! Pë rtë qeshur dhe për të qarë nga ky lajmi neveritshëm dhe krejt i pa vertet. Turp! Bile turp i madh! Si mundet të shkruajnë gjëra të tilla të pavërteta. Nuk e di a futet kjo në kategorinë e "shpifjes"!? Po ministria përkatëse si nuk reagon?! Nuk e din ajo se *nuk ka ndërtuar asnjëherë rrugë Peshkopi - Lurë* ose më saktë *Arras - Lurë*!? Sigurisht që e dinë mirë të gjithë, të majtë e të djathtë, por, me sa duket ecin sipas parimit - *sa ta haj ky populli*!

Unë gjykoj se ndaj këtyre lajmeve duhet të reagojnë institucionet e shtetit nga njësia në bazë, bashkia, Këshilli i Qarkut, Institucioni i Prefektit të Qarkut (*që për habinë time e thërrasin në mënyrë të kundraligjshme Prefekturë deri dhe nga kryeministri i vendit*).

Unë nuk jam nga Lura. Jeta dhe profesioni me ka lidhur ndër vite me Lurën në kërkim të pasurive minerale që mbart nëntoka e saj, pa lënë pas dhe natyrën e saj. E njoh këtë trevë me pëllëmbë kur i thonë, bile që në fëmininë time kur shkonin me stane për verim në Lanë Lurë e bukur, me ajrin e pastër, të gjelbëruar dhe ujëplotë. Në vitet e largëta të të ashtuquajturit *socializëm,* u ndërtua një rrugë traktori 2.5 m e gjerë ose një rrugë ushtarake për *makinat e ushtrisë*, makina të larta e me tek goma, që ishin në gjendje të kalonin në rrugë të tilla për të transportuar artilerinë e luftës për në repartin ushtarak në Qafën e Tajanit, afër Lanë Lurës, artileri e cila kishte për qellim të pengonte në rast lufte, futjen e forcave tokësore të armikut në drejtimin e Malit të Sorokolit dhe Rrafshit të Korabit.

Pra, rruga funksiononte vetëm në verë një muaj ose e shumta dy muaj. E thënë shkurt, rrugë e rregullt me projekt për Lurën ose më saktë nga Arrasi në Lurë, nuk është ndërtuar asnjëherë. Çdo thënie tjetër është një gënjeshtër e madhe ose një*"shpifje"* siç po përmendet shpesh kjo fjalë kohët e fundit. Si mundet të gënjehet ditën për drekë edhe nga autoritetet shtetërore, duke thënë, *"është bllokuar nga bora rruga Peshkopi - Lurë ose Arras- Lurë"?* Shpresojmë që të mos e dëgjojmë më këtë togfjalësh në këtë dimër që po vjen.

Rruga është domosdoshmëri për lurianët edhe sikur ajo të hapej vetëm për të lidhur Lurën me qytetin e Peshkopisë, ku ata kanë qendrën e bashkisë së tyre, me të cilën e lidhin hallet dhe problemet. Pas dy viteve e gjysmë pritet të përfundoj edhe ndërtimi i Rrugës së Arbërit, e cila do ta afroj Tiranën

(Vijon në faqen 4)

Rruga e Arbërit nr. 151

aktualitet



Liqenet e Lurës. Foto: © Fation Plaku

Për rrugë ka nevojë çdo skaj i atdheut. Rruga sjell zhvillim dhe pa rrugë, zhvillimi nuk duhet pritur. Por, për Lurën ndryshon puna. Një krahinë e tërë pa rrugë lidhëse me qendrën e saj historike e administrative gati një shekullore Peshkopinë, një krahinë që ndër shekuj ka bërë emër të mirë në gjithë Shqipërinë për bëmat e saj në historinë tonë të vjetër e të re, një krahinë aq e njohur për bukuritë natyrore madhështore, ndër më të bukurat e vendit tonë, për vetë specifikat që ajo ka, pa harruar pasuritë minerale etj. që janë dokumentuar jo vetëm nga shumë studiues të vendit tonë por edhe nga të huajt.

Ndërtimi i rrugës Arras - Lurë, domosdoshmëri për zhvillimin e turizmit dhe kërkimin e mineraleve

(Vijon nga faqja 3)

me Peshkopinë në rreth 90 km, nga 170 km që është sot dhe *Lurën me Tiranën nëpërmjet Peshkopisë në rreth 125 km*. Deri në Arras ajo tashmë ka ardhur, me hapjen e rrugës së re nga Shkolla e Kastriotit, me urë të re në lumin e Drinit të Zi, duke shkurtuar distancën Peshkopi - Arras rreth 10 km. Kësisoj, rruga Peshkopi - Arras-Lurë do të këtë një gjatësi totale rreth 34 - 36 km, nga 45 km që ka qenë sipas variantit nga Rruga e Rinisë nëpërmjet Muhurrit. Mbetët për tu ndërtuar18 apo 20 km rrugë, qoftë dhe më gjerësi 5 apo 6 m e asfaltuar, për të cilën mendojmë se nuk do të këtë kosto të lartë falë dhe faktit se gjysma e gërmimit është bërë nga ushtria dekada më parë. Rruga gjarpëron në një terren malor që nga ana gjeologjike ka përparësi, duke kaluar në formacione karbonatike të forta (kryesisht gëlqerorë), duke kërkuar pak ura të vogla apo turbina, në ato pak përroska që e ndërpresin aksin e saj. Rruga Arras - Lurë duhet të ndërtohet një orë e më parë për perspektivat që do të hap në disa drejtime zhvillimore për krahinën.

Para ca kohësh bëri një vizitë në Lurë edhe kryeministri Rama. Nuk dua të futem në komentimin e vizitës por dua të nënvizoj një fakt. Një bashkëbisedues i kërkoj kryeministrit rregullimin e rrugës Lurë - Kurbnesh - Perlat, ndërkohë që Rruga e Arbërit është në ndërtim dhe pritet të mbaroj në marsin e vitit 2021 nga ku, me ndërtimin e rrugës Arras - Lurë, lurianët jo vetëm lidhen me Peshkopinë por, do të udhëtojnë nga Lura në Tiranë në kohën më të shkurtër të mundshme se në çdo drejtim tjetër, pra krahasuar edhe me drejtimin Kurbnesh - Përlat - Rreshen.

U habita edhe me faktin që nuk e kërkuan lurianët rrugën Arras - Lurë, një rrugë që nuk kërkon shumë para, një rrugë e shkurtër që i lidh me Dibrën, jo thjeshtë se varen nga *Bashkia e Dibrës* apo i lehtëson lurasit në shumë aspekte zyrtare, private a biznesi etj., por dhe perspektivën e lidhjes me kryeqytetin e kanë nga Rruga e Arbërit e cila, shpresojmë të ndërtohet në afat e me standardet e kohës ashtu siç po thuhet e shkruhet.

Rruga Arras - Lurë jo vetëm do të zhvilloj atë krahinë të lënë pas dore por, kjo rrugë do të jetë në vetvete dhe një rrugë panoramike e papame dhe, jo vetëm kaq.

Mineralet me origjinë magmatike si ato të Kromit, atome origjinë efuzivo-sedimentare të Bakrit, apo dhe disa minerale të Aluminit, të Manganit etj., si dhe shumë minerale të tjerë jo metalorë, që natyra nuk i ka kursyer, kanë perspektiva në Njësinë Administrative të Lurës e cila, sipas meje, kurrsesi nuk duhet llogaritur si një vend ku mund të zhvillohen vetëm turizmi malor, blegtoria, ajo pak bujqësi apo ndonjë investim tjetër prodhues me leverdi etj.

Në stacionin e parë të saj në Çidhën do të hap perspektiva turizmi veçanërisht për të vizituar *gjeomonumentet e natyrës* që ndeshen në *Grykën e Setës* nga *Ura e Setës e Kepi i Xhitetit e deri ne afërsi të Gur - Lurës*, me kanione të shumta të thella e magjepse, me shpella karstike interesante e ujëra që rrjedhin prej tyre si kristali etj. Në vazhdim ndeshet me *Luginën karstike të Pratit,* e cila në anën perëndimore ka Qafën e Tajanit. Tajani, një pikë dominuese *ku shikohet* si në pëllëmbë të dorës*80 % e Dibrës* e më gjerë, ku në anën lindore vrojtohet Mali i Gjallicës, Malësia e Sorokolit, Malësia e Korabit, Malësia e Gramës, Mali i Velivarit etj., dhe në anën perëndimore Mali Xharxhixhtit, Mali i Pllajut, Mali i Runjës, Mali i Pratit etj. Në vazhdim kjo rrugë do të ndërpresë mes për mes *Lanë - Lurën* që të mrekullon që në shikimin e parë, *një fushë e madhe karstike* me vlera të jashtëzakonshme nga të katër anët, e njohur në rang kombëtar e rajonal. Vazhdimi i saj drejt jugperëndimit - *Luginës karstike të Xharxhishtës* apo drejt verilindjes, *Majës së Madhe*, e bënë atë më madhështore dhe piktoreske.

Dua të nënvizoj faktin se kjo rrugë kalon në territorin e *Vendorigjinës* së *Kastriotëve*, aty ku u zhvillua *Beteja e Madhe e Torviollit* midis *Ushtrisë Osmane* dhe *Ushtrisë së Lidhjes së Lezhës*, që komandohej nga *Skenderbeu*. Më tej vazhdon në Arras, aty ku filloj *Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912* kundër ushtrisë osmane, me 26-27 mars dhe, aty ku u formua *Qeveria e Arrasit e vitit 1920*. Pasi kalon Urën e Përroit të Setës, rruga fillon ngjitjen *drejt fshatit Çidhën, aty ku, në vitin 1466 u krye nga Sulltan Mehmeti i II masakra më e madhe në historinë tonë kombëtare*, në territorin *midis dy kalave* të kësaj treve, ku i shkoj në thikë *sipas Barletit, 8 deri 10 mijë burra, veç grave dhe femijëve*. Pra është një rrugë e mbushur me përmendore e lapidare që dëshmojnë dhe gjëmojnë për historinë, një vlerë tjetër e madhe kjo, në *shërbim të turizmit dhe memories tonë kombëtare*, shumë pranë *Muzeut të Kastriotëve* në Sinë. Në këtë rrugë ka kaluar edhe dërgata e *mbretit Maqedon Perseu* në vitin *169 para Krishtit* për bisedime me *Gentin (mbretin ilir)* kundër romakeve, pasi kreu masakrën mbi *Oenen*, kryeqendrën e *Penestëve*.

Pra pa u zgjatur më tej, kjo rrugë do të jetë rruga që do të rilind jo vetëm Lurën në tërësinë e saj por, dhe zonën ku kalon në çdo kilometër të saj. Jam tejet i bindur se ndërtimi i kësaj rruge strategjike, me plotë kuptimin e fjalës, *edhe pse tejet e vonuar*, do të tërheq shumë investitorë vendas e të huaj të interesuar për pasuritë nëntokësore të saj, për kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e disa mineraleve që ka krahina e Lurës, që për shumë e shumë arsye kërkimet gjeologjike që u realizuan në kohën e monizmit, vetëm sa*"e kanë gërvishtur"*atë. Pa dashur të futem në histori në analiza e fakte, mund të them se nga Bulqiza e largët nuk mund të kërkoheshin mineralet në Lurë. *"Hija e Malit të Duriçit"* në atë kohë, pengoi intensifikimin e kërkimeve gjeologjike në të gjithë Dibrën, pra edhe në Lurë. Qendra e ndërmarrjes gjeologjike në Bulqizë, fokusoi punimet dhe investimet vetëm rrotull *vendburimit të njohur të Bulqizës*, duke u përqëndruar në realizimin e detyrave të kromit aty e, *duke lënë në hije zonat e tjera*.

Midis shume e shume arsyeve, edhe këtu mungesa e rrugës padyshim që ka pjesën e luanit. Mineralet me origjinë magmatike si ato të Kromit, atome origjinë efuzivo-sedimentare të Bakrit, apo dhe disa minerale të Aluminit, të Manganit etj., si dhe shumë minerale të tjerë *jo metalorë, që natyra nuk i ka kursyer*, kanë perspektiva në Njësinë Administrative të Lurës e cila, sipas meje, *kurrsesi nuk duhet llogaritur si një vend ku mund të zhvillohen vetëm turizmi malor, blegtoria, ajo pak bujqësi apo ndonjë investim tjetër prodhues me leverdi etj*.

Dibra ka nevojë për shumë rrugë dhe magjistrale të tjera rrugore që duhet të ndërtohen për tu vënë në shërbim *të përshpejtimit të vënies në qarkullim ekonomik të pasurive te saj mbitokësore e nëntokësore*.

Para se të përfundoj ndërtimi i Rrugës së Arbërit, dibranët duhet të mendojnë për hapat e mëtejshëm të projektimit e ndërtimit të magjistraleve të tjera rrugore për të garantuar një zhvillim të shpejt e të qëndrueshëm, për ti paraprirë perspektivave zhvillimore që ofrojnë pasuritë natyrore të saj në të gjithë territorin e bashkisë, të mbitokës dhe të nëntokës.

Unë parashtrova apo sugjerova si fillim, si *aksin më emergjent, Rrugën e Lurës*, një rrugë për të cilën nuk justifikohet mosndërtimi i saj *prej më shumë se një shekulli* nga drejtuesit e Lurës, ato të Dibrës e deri tek autoritetet qendrore që kanë peshën kryesore, duke penguar me ose pa qëllim *zhvillimin e kësaj krahine aq të dëgjuar në të gjithë Shqipërinë*.

** Autori i shkrimit ka titullin akademik profesor i asociuar, ish punonjës shkencor në Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit dhe pedagog i jashtëm në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.*

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

analizë

Rruga e Arbërit rrit shpresën te qytetarët dhe i jep një zhvillim të ri rajonit verilindor e në veçanti qytetit të Bulqizës.

Velenja e Sllovenisë, shembulli që duhet ndjekur për zhvillimin e **Bulqizës**

Nga **Irfan ZEBI**

Në maj 2018, me një grup teknikësh të servisit të fabrikës të prodhimit te elektroshtëpiakëve "Gorenje" të udhëtonim për në Velenjë, Sllloveni. Rrugë e gjatë, por e bukur. Në mëngjes pasi lanë kufirin, kalojmë me radhë qytetet e bukura dhe të sistemuara të Tivarit, Budvës deri tek trageti për në pjesën tjetër të Malit të Zi. Pas një orë tjetër udhëtimi jemi në Kroaci. Nga ballkoni i Dubrovnikut, qytetit të vjetër, magjepsesh nga bukuria dhe kaltërsia e detit. Ndalojmë për pushim dhe nuk ngopemi me bukuritë e kësaj qendre të madhe turistike, por dhe mënyrën se si janë ruajtur në shekuj këto pasuri të lashta. Lamë Dubrovnikun për të vazhduar udhëtimin tonë. Ura e bukur e varur me radhë qytet pas qyteti përmes Kroacisë. Pasi dolëm nga kufiri me Kroacinë për në Sllloveni, udhëtuam përmes fshatrave sllovene. Një natyrë mrekulluese, gjelbërim i paparë, fshatra të vegjël dhe të bukur,ndërtuar gjithçka si në përralla. Rruga zgjati më shumë se zakonisht pasi ishim të detyruar të ndalonim herë pas here për të fotografuar këtë natyrë fantastike realizuar nga dora dhe mendja e njeriut të ditur dhe punëtor. Fusha të mbjella, kodra të veshura më së miri me pyje e gjelbërim. Dalëngadalë po i afroheshim qytetit të Velenjës, ku do të qëndronim për disa ditë për një seminar të organizuar nga fabrika Gorenje.

Velenja shtrihet në verilindje të Sllovenisë midis kodrave të gjelbëruara të luginës së Shalegut. Kufizohet me alpet Kamnik-Savinja dhe malet e Pohorjes në lindje, 400 m mbi nivelin e detit me një popullsi prej 25 000 banorë. Qyteti filloi të popullohej në fillim të viteve '50 të shekullit të kaluar me hapjen e një miniere qymyrguri i ngjashëm me qymyret e Fushë Kosovës për sa i përket fuqive kalorifike. Në këtë minierë u punësuan rreth 2000 punëtorë, kryesisht meshkuj. Për punësimin e grave drejtuesit e minierës menduan të ndërtonin një fabrikë për prodhimin e elektroshtëpiakeve, fabrikë e cila njihet me emrin "Gorenje". Sot ajo ka rreth 10 000 punëtorë, me një teknologji bashkëkohore dhe eksporton në të gjithë botën.

Pak fjalë për qytetin, zhvillimin e tij, njerëzit dhe mjedisin qe e rrethon.

Miniera është komplet e mekanizuar. E gjithë sasia e qymyrit nxirret me 300 punëtorë. Teci është shndërruar në një gjigant të prodhimit të energjisë elektrike, mbulon rreth 50% të kërkesës për energji elektrike në gjithë Sllloveninë. Niveli i ndotjeve 0. Gropa e dikurshme ku merrej qymyri është kthyer në një liqen shumë të bukur me ujë të pastër si kristali.

Në Velenja ka vetëm 5% papunësi sipas statistikave zyrtare. Nuk njihet asnjë krim penal, mjedisor e administrativ. Qytetarët janë korrekt dhe shume mikpritës. Jashtë kohës së punës studiojnë e marrin pjesë në veprimtari shoqërore, shkencore etj. Qyteti është harmonizuar midis lashtësisë, ku kalatë, kishat dhe ndërtesat e vjetra ruhen me fanatizëm, projektit modern, lulishteve dhe gjelbërimit të pafund.

Në qytet ka 6 shkolla fillore, 8 shkolla tetëvjeçare, 7 shkolla të mesme, një shkollë muzikë, universitet, qendra kulturore dhe institucione të tjera në shërbim të komunitetit. Velenja është një nga qendrat më të zhvilluara ekonomike dhe e pajisur me infrastrukturë rrugore moderne. Lidhet me autostradat e Sllovenisë dhe me Austrinë.

Në qytet shërbimet janë shumë sociale, transporti urban është falas. Qytetarët mund të përdorin biçikletat bashkiake pa pagesë.

Patëm rastin të ngjitemi në malin e qytetit 1000 m mbi nivelin e detit. Gjithkund rrugë asfaltuar dhe pisha shekullore. Në maj të malit shërbime tregtare dhe fusha sporti. Sipas ritit të vendasve në majën më të lartë





ishte një kuti çeliku, brenda saj një bllok dhe stilolapsa ku gjithë secili shkruante emrin dhe adresën nga vinte. Këtë eveniment të rëndësishëm do ta mbyllte një darkë e improvizuar në shtëpinë e shoqëruesit tonë.

BULQIZA

Kur pashë e preka nga afër zhvillimin e Velenjës mendja më shkon tek Bulqiza. Me modesti mund të them se kam një pjesë të vogël të jetës time. Atje pata rastin dhe privilegjin të njoh njerëzit që punuan dhe punojnë me heroizëm e vetëmohim. Njoh historinë e këtij qyteti, pasuritë përrallore të nëntokës, mentalitetin e këtyre njerëzve punëtorë, bujar, arsimdashës dhe me kulturë.

Në minierën e kromit, së bashku me ndërtim minierën, gjeologjinë dhe ndërmarrjen e furnizimit të punëtorëve punonin mbi 6000 punëtorë, 200 gra në fabrikën e pasurimit, shumë të tjerë në arsim, shëndetësi, komunale N/bujqësore etj. Qindra minatorë, të rinj e të reja, teknikë, inxhinierë miniere, gjeologë, me një punë të mirëfilltë vetëmohuese dhe shkencore i dhanë zhvillim të paparë minierës në Bulqizë, Batër, Tërnovë, Balgjaj e në shumë pika të tjera. Studiuan shkencërisht dhe me përpikëri zonat mineralmbajtëse të trevës së Dibrës për t'i vënë në shërbim të shoqërisë e në dobi të atdheut.

Inxhinierë të talentuar si Bujar Pata, Fatmir Beqiri, Sefedin Shabani, Jorgo Kola e shumë të tjerë të shpjegonin me imtësi për çdo cep të minierës. Shfytëzim në galeri të gjata pa fund, kate dhe nënkate në një thellësi disa metra nën nivelin e detit. Poshtë qytetit të Bulqizës, një qytet tjetër ku punohej me sakrifica dhe heroizëm nga nxirrej minerali i kromit. Ky brez shkencëtarësh dhe ato me të rinjtë e viteve '80 i lanë qytetit të Bulqizës dhe Shqipërisë një pasuri të paimagjinueshme e cila pas viteve '90 u shpërdorua nga administrimi i keq, privatizimi pa kriter nëpërmjet koncensioneve pa studim për zhvillimin e kësaj pasurie fitimprurëse.

Bulqiza para viteve 80 trashëgoi plagë të mëdha sociale, si strehimi, punësimi, shkollimi, mekanizimi i minierës, përmirësimi i kushteve të punës, sigurimit teknik në punë, etj. Vërtet filluan të bëhen disa ndryshime, si rregullimi i fjetoreve, ngrohja qëndrore e qytetit, ndërtimi i pallateve me kontribut vullnetar, ngritja e një ndërmarrjeje ndërtimi vetëm për Bulqizën. Këto masa e zbuten disi nevojën për strehim, por ishin ende të vogla krahasuar me kërkesat e minatorëve të shumtë të ardhur nga Zerqani, Shupenza, Maqellara etj. Sistemimi i tyre nëpër godinat e punëtorëve linte shumë për të dëshiruar, nuk plotësoheshin as kushtet me minimale për jetesë. Parulla 'Kromi çan bllokadën' ishte vetëm parullë për të rritur moralin e punëtorëve. Megjithëse një punë heroike ku minatorët përqafonin të afërmit dhe shokët e tyre para se të futeshin në minierë me përshëndetjen e zakonshme mirë u takofshim në përfundim të punës. Në galeri nuk dallohej kush ishte minatori, kush ishte brigadieri, inxhinieri apo drejtori. Kuadrat ishin pranë punëtorëve të interesuar për shëndetin, jetën e punëtorëve, argëtimin dhe zgjidhjen e problemeve.

Ka ardhur koha që të mendohet dhe veprohet ndryshe që pasuria kombëtare të vihet më mirë në shërbim të njerëzve, që institucionet të mendojmë më shumë për qytetarët, të merren masa të rrepta për shfrytëzimin me kritere shkencore të kësaj pasurie. Duhen gjetur mundësi punësimi për gratë, duhet organizuar më mirë jeta sociale e kulturore në qytet. Për këtë përvojë ka në Velenja dhe në gjithë Europën.

Me zgjerimin e minierës, perspektivën që ajo kishte në fronte të hapura e të gatshme për prodhim pas vitit 90-të për ironi të fatit filluan të largoheshin nga miniera disa figura publike dhe shkencore, të cilët ishin shtylla e organizimit dhe prodhimit. Si në gjithë Shqipërinë filloi të ulet prodhimi, të keqadministrohej puna, të shtoheshin humbjet etj., dhe miniera shkoi keq dhe më keq. U mbyll shërbimi gjeologjik, ndërmarrja e ndërtim minierave, po shfrytëzoheshin vetëm frontet e hapura duke i mbyllur perspektivën minierës. U bë koncensioni i parë, i dyti, i treti duke ndërruar disa herë pronar. Koncensionari i fundit duket se diçka po bën për prodhimin, kushtet e punës dhe hapjen e perspektives ne minierë.

* * *

Krahasuar me Velenjën e Sllovenisë, Bulqiza dhe simotrat e saj Rubiku, Ballshi, Memaliaj janë shumë larg në kohë, cilësi, mentalitet dhe siguri. Nuk mund të vazhdohet me këtë mentalitet drejtimi. Nuk mund të lihet jashtë vëmendjes qyteti dhe qytetarët me këtë pasuri që ai qytet mbartte në trupin e vet të drobitur. Duhet të ndryshojë mentaliteti i vetë shtetit për këtë pasuri kombëtare e cila nuk është e pafundme. Kapacitet intelektuale nuk mungojnë, fuqia punëtore e specializuar jo. Ka ardhur koha që të mendohet dhe veprohet ndryshe që pasuria kombëtare të vihet më mirë në shërbim të njerëzve, që institucionet të mendojmë më shumë për qytetarët, të merren masa të rrepta për shfrytëzimin me kritere shkencore të kësaj pasurie. Duhen gjetur mundësi punësimi për gratë, duhet organizuar më mirë jeta sociale e kulturore në qytet. Për këtë përvojë ka në Velenja dhe në gjithë Europën.

Mjafton dëshira e mirë për të bërë diçka më shumë e më mirë për qytetin dhe për njerëzit. Rruga e Arbërit rrit shpresën te qytetarët dhe i jep një zhvillim të ri rajonit verilindor e në veçanti qytetit të Bulqizës. Këtij investimi të madh që tashme ka marrë udhë duhet t'i paraprijmë me studime e projekte jo vetëm në Bulqizë por dhe për gjithë rajonin. Pasuritë dhe resurset që ka rajoni i Dibrës dhe i Matit duhet të vihen gjithnjë e më mirë në funksion të rritjes e mirëqenies së popullit. Pushteti qendror dhe ai vendor duhet të mendojnë që projektet të jenë për perspektivën, afatgjata në unitet me kërkesat e shoqërisë dhe të njësive vendore qe administrojnë bashkitë në këtë rajon.

Rruga e Arbërit nr. 151

debat

Akoma Gjergj Kastriotit i jemi borxhlinj ne shqiptarët me institucionet kërkimore në fushën e historiografisë, universitetet etj...

Çfarë i kemi borxh Gjergj Kastriotit?

Dr. **Selman MEZIU**

Nuk mund të debatosh, të hedhësh ide të ndryshme për një figurë mbarëkombëtare, me vlera të shumta në kuadrin e ujdhesës ilirike, të kontinentit evropian e më tej, pa studiuar imtësisht dokumente, shkrime, libra historik, folklor etj., të mjaftueshëm, të historikërkuesve, bashkangjitur me toponomistikën gjeografinë dhe të dhënat arkeologjike.

Këtij strategu të madh ushtarak, politikani të urtë, atdhedashurues me aftësi të mëdha kompromisesh politike e ushtarake, i cili i ka dhënë emrin shekullit të pesëmbëdhjetë i janë kushtuar me qindra vepra, artikuj, poema, poezi, piktura, sonate etj. Megjithatë akoma Gjergj Kastriotit i jemi borgjëlinj ne shqiptarët me institucionet kërkimore në fushën e historiografisë, Universitetet etj., por edhe çdo intelektual e patriot shqiptar kudo që jeton për të zbuluar me vërtetësi, seriozitet e argumente gjithë veprimtarin e tij të vrullshme luftarake, politike, diplomatike, ekonomike, fetare, etj.

Historianët shqiptarë luftuan me dije, këmbëngulje, vullnet, patriotizëm,me penë e dokumente dhe arsyetime mbi fakte për ta kthyer në atdhe që nga *Frang Bardhi "Gjergj Kastrioti i Epirit, i quajtur përgjithësisht Skënderbeg, princ shumë trim e i pathyeshëm i shqiptarëve".Venecia 1636* kundër boshnjakizimit të tij nga prifti kroat Joan Tomko Margnaviçit, e më rradhë historiani Fan S. Noli kur e donin serbët dhe grekët pastaj e kërkonin bullgarët, turqit, Malazezët me Stefan Zanoviçin etj., dhe pothuajse atdhetarizimin e këtij strategu luftarak e heroi kombëtar e kemi kthyer ne atdheun natyral. Përfundimisht, historiografia shqiptare këtë borxh ia ka shlyer Kastriotit të madh.

Por, mbetet ende për të bërë që të kthehet përfundimisht në mjedisin natyral, brenda kufijve të dhunuara të kombit shqiptar. Një fillesë e kësaj lufte për të përcaktuar mjedisin natyral të kastriotëve e gjejmë në: *"Historia e Skënderbeut (Gjerq Kastriotit) mbretit të shqipënisë (1412- 1468) (Boston 1921) në të cilin shkruesi i saj Fan Noli thekson: "….Kastriotët rrjedhin nga katundi Kastriot i Dibrës ose nga një fshat i quajtur Kastria, qe ndodhet a ne Mat, a në Mirdite a në Has, Drinit;…(Vepra 4; Shkr. hist. f.. 67; Tiranë 1989).*

Shkëndinë e parë e hedh *Eugjenio Barbarik në: "Albnia" Roma 1905* ku shkruan Kastriotasit e kanë origjinën nga Mazrekat e Kastrati i Shkodrës. Më pas historianit *Aleks Buda "Historia e Skenderbeut në dritën e studimeve të reja."* në: Bul.i inst. Të shk. nr. 3,4 Tirane 1951; ai ngjitet në Mazrekat e Hasit të Kukësit i përkrahur me artikuj e botimin e librit *"Tedeli i Kastriotëve është Hasi." Tirane 2006, të Prof. Dr. Shefqet Hoxha*, e akoma flamurin e kesaj historie e ngren dhe e tund edhe sot *Prof Dr. Jahe Drancolli me shkrimin "Origjina kosovare Gjergj Kastriotit Skenderbeut." Prishtine 2018.* Në Mazrekat në afërsi të Prizrenit.

Në bregun e djathtë të Drinit lind një mendim i formës së prerë, ku e shpreh Shkrimtari Haki Stërmilli në librin *"Dibra në prak të historisë"Dorëshkrim i vitit 1940* i cili shkruan:*"Mbi origjinën e fisit të Skënderbeut, flet vetë fjala "Kastriot" që asht emni i familjes së tij."*

Por këto shkrime për dhjetëra vjeçar nuk e shqetësuan aspak Fakultetin e Historisë në Universitetin e Tiranës, as historian të tjerë. Filluan kërkimet e Hazis Ndreut nëpërmjet toponimeve dhe gojdhënave, si dhe të intelektualëve, historianëve Dibranë si Murta Koltraka, Rakip Sinani, Ali Hoxha, Moisi Murra, Hilmi Sadiku, Arkeologu Iliaz Kaca, Fatos Daci, Besnik Këbej etj. të cilët kanë dalë me përfundimin se Kastrioti i Dibrës si nga pikëpamja dokumentare, strategjike, toponomastikës dhe gojëdhënave të shumta të përcaktonin Kastriotin si vendbanim i Gjon Kastriotit. Kjo tezë u përkrah fuqishëm nga Prof. Kristo Frashërit, nëpërmjet disa artikujve dhe së fundi me librin e tij të fundit



Miniaturë, portret i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në dorëshkrimin De Romanorum Magistratibus të Domenico Fiocco-s në vitin 1465, gjatë kohës së qendrimit të Skënderbeut në Romë. Ruhet në Houghton Library të Universitetit të Harvardit, me signaturën Ms Typ 496. Anash portretit shihen shkurtesat E V, Epirus Victor.

"Skënderbeu" Jeta dhe vepra, Tiranë 2002.

Por, nuk është e lehtë që të thyhen matjanët, të cilët me lagjen Kastriot në fshati Shqefën, me disa toponime e kërkime të tjera në fushën e historisë i shtyjnë historianët Qamil Alushi dhe Mexhit Demiri të shkruaj librin *"Skënderbeu" nga M. Barleti tek O. Schitt." Tiranë. 2000.* E përkrahu idenë e dëshirën e matjanëve për të patur heroin Kombëtar në gjirin e tyre, historiani Ferit Këputa me librin: *"Origjina e Kastrioteve është Mati", Tirane 2007,* i cili arrin në përfundimin se Kastriotët janë matjanë.

Nuk mund të heshtin historianët e intelektualët Mirditor, nisur nga Kastria e tyre e përmendur edhe nga udhëtari francez Ami Boue "Turqia e europës." Paris 1840, e ushqyer me plotë devotshmëri e vendosmëri sublime nga historiani Mirditor Preng C. Leshi në librin e tij *"Polemika për Kastriotët", Tiranë 2010, ku* thekson origjinën e tyre, Kastratin e Kastriotëve në fshatin Vig të Mirditës, të shoqëruar me një seri artikujsh e duke shfrytëzuar një literaturë të gjerë.

Ende pas gjashtëqind e pesëdhjetë vjetësh vendorigjina dhe vendlindja janë në një mjegullnaje pikëpamjesh, idesh, faktesh të palidhura, të padokumentuara e vërtetuara bindshëm.

Në këte endje merimangash është origjina e Vojsava Tribaldi, nëna e Gjergjit, ku edhe sot e kësaj dite i mëshohet origjinës serbe. Ndër studiuesit që e nxjerrin Vojsavën sllave, mund të përmendim: J.Ivanov, Q, Radojiçiq, M. Dinić, R. Mihalqiq, M. Shuica, B. Petrovski dhe S. Dimitrov. Prof. Kristo Frashëri, në lidhje me këtë do të shkruaj: *"... mbiemri Tribalda nuk është me origjinë sllave por ilire. Ndër shkrimtarët e hershën, Gjon Muzaka e thotë shkoqur se Tribaldët qenë shqiptar." "K. Frashëri,"Skënderbeu". F. 71; Tiranë. 2002)*

Një tjetër ide mbi prejardhjen është:*"Gjergj Kastrioti u lind nga nëna shqiptare Vojsava (Vaissa-vajzë) Tribalda, me fe asokohe ortodokse, e bija e Gërgur Tribaldës nga Gësradeci – Pollog, i shpallur zot i Pollogut në kishën e Leshës (Leshkë/Leshok), Tetovë, princ nga dinastia e Topiajve, dhe baba katolik shqiptar." shprehur nga historiani Nelson Qirjako," Prejardhja e Vojsava Tribalda-Kastriotit." Konica.al. 5 Shtator, 2017.*

Dhe një origjinë tejtër nga studiuesi Preng C. Lleshi citon arbëreshin Gavril Dara i Riu dhe shkruan*: "Ndër këta, të parët, prindërit e mi, që emërtohen gjer më sot Mërkuri e Njani i Dharenjëve, gjërinj (gjini, fis, gjak-shënimi im) të Kastriotit nga ana e Vojsavës, së jëmës së tij, së biljes (bijës-shënimi im), së Prenkut të Mirditëve".në artikullin "Dara: Vojsava, nëna e Skënderbeut ishte halla e Lekë Dukagjinit." Nacional Albania 25.04.2016.*

"Më jeni borxhlinj deri në fyt", kërkon me zanin kumbues Heroi ynë kombëtar: Reposhi vëllai im vdiç si murg në malin e shenjtë Atos apo si princ?

"Sipas studiuesit të njohur kroat, Milan Shuflaj, mbi varrin e Reposhit, i varrosur në brendësi të objektit kryesor të manastirit të Hilandarit, në kishën e Shën Mërisë, është gdhendur identifikimi historik "Duka i ilirëve." (Pirro Prifti, Reposh Kastrioti – e verteta për famijen e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti" 25.10. 2018by Rrjetat in Dossier.

Akoma historianët shqiptar nuk njohin as gjeneologjit më të thjeshta të vëllezërve të mi si Reposhi, Stanishi, Kostandinin dhe Gjergji, të motrave,Mara, Jela (Gjela), Angjelina, Vlaitsa dhe Mamica.

Paçka se turbullira, mjegullnaj hedhin në historinë e Kastriotit të Madh edhe profesorë që kane një jetë të tërë me veprimtarinë e shumanshme dhe jetën e tij. Dhe ja: *"Pretendimet e Hazis Ndreut, të Adem Bungurit dhe të Myzafer Bislimit për ekzistencën e mureve të një kështjelle në Koxhaxhik dhe të varreve të ushtarëve të Skënderbeut janë vetëm dëshira dhe deklarime të tyre të papërgjegjshme, që nuk kanë asgjë të përbashkët me shkencën." (Prof. Asoc. Dr. Kasem Biçoku Tirane; "Shtrirja lindore e zotërimeve të Kastriotëve."* në *"Akad. Shk e shqip. "Skënderbeu dhe evropa." f. 73- 74; Tiranë 2006)*

Profesor dr. Adem Bunguri për të vërtetuar edhe pohimet Marin Barletit (1510) ndërmerr tri ekspedita me historianë e të tjerë, përkatësisht në Shtator 1993, në Prill 2006 dhe të tretën më 10 Korrik 2007 duke u ngjitur tek kalaja e Koxhaxhikut në lartësinë 1160 m., ku bëri kërkime arkeologjike në sipërfaqe, matje të ndryshme, skicime të mureve etj., dhjetëra fotografi të natyrave të ndryshme. Shkroi studimin historik: *"Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër)"* në revistën *"Studime Historike" (Nr. 12); Viti i LXV(XLVIII), f. 26-56; Tirane 2009"* të shoqëruara me 27 fotografi, 6 skica dhe mbi 57 autor të huaj e vendas të cituar.

Dhe ja njëri nga përfundimet e studimit historik:*"…kalaja e Koxhaxhikut është dhe ruan pjesë të sistemit të dikurshëm fortifikues, të ndërtuar me mure gurësh të lidhura me llaç gëlqeror, që mund të shihen nga kushdo që ka dëshirë të merret me studimin e kësaj kalaje." (Po aty f. 48)*

Arkeologu Adem Bunguri i kryen studimet e tija sipas parimit te babait të historisë, Herodotit, i cili thoshte: *"E dëgjova, e shikova, e shkrova."* Kjo ndodhi edhe me zbulimin e gushtit të vitit 2018, i ndihmuar nga banorët vendas të Bulqizës, ai ngjitet në lartësinë 1000

Kërkimet në arkivat e Venedikut dhe Stambollit, mbështetur në kërkime arkeologjike në terren, është rruga për të qartësuar momentet kryesore të origjinës, jetës e veprimtarisë së tij luftarake, politike, diplomatike e fetare

metra tek "Shkami i kullës së Skënderbeut" ku zbulon fortifikimin e një çisterne uji me gurë e gëlqere të shekullit të 15-të e të tjera elementë arkeologjik që dëshmonin për një fortifikim të legjendarit Gjergj Kastrioti në betejat e zhvilluara në Vajkal kundër Ballaban Pashës (Në Prill-Gusht 1465).

A nuk është detyrë e Institutit të Kërkimeve Arkeologjike të kryejnë kërkime të tilla edhe tek Kulla e Gjonit, Pusi i Gjonit, Kisha e Gjonit etj. në Kastriot të Dibrës për të vërtetuar studimet historike të deritanishme të origjinës së Kastriotëve dhe kjo mund dhe duhet të arrihet nga *"…… bashkëpunimi midis studiuesve të historisë dhe atyre të arkeologjisë, veçanërisht kur është fjala për momentet të karakterit arekologjiko - historik." (A. Bunguri po aty f. 49).*

Gjergjit, komandantit të madh, i jemi borxhlinj edhe se data dhe vendlindja, ende nuk janë përcaktuar, edhe pse shkruhet nga ndonjëri apo tjetri studiues më 6 Maji 1405, ndërsa vendlindja në Sinën të Dibrës, po kështu është e pa dokumentuar të gjetura në arkivat turke, venciane apo napolitane, etj. Ndërkohë kur çelësi i gjetjes së saj është zbuluar, por, kanë munguar kërkimet në arkivat turke, përkushtimi, serioziteti dhe nënvleftësimi nga historianët e studimeve mesjetare apo të epokës së Kastriotëve. Dhe ja po hedhim pak dritë mbi të vërtetën: *"Në një orë mësimi kur u përmend emri i Skënderbeut, nxanësit e kombësive të ndryshme e pyetën mësuesin, se ku kishte lind Skënderbeu. Ai u përgjigj me një fjali të shkurtër: Skënderbeu ka lindur ne Çelias (Toponim në Kastriot të Dibrës së poshtme. S.M.)"* Kujton Sul Brunga nga Gjurë Lura, i shkolluar në Stamboll ne vitin 1906. (Shkëputur nga libri i H. Ndreu, "Kastriotët dhe Skënderbeu në trojet arbërore." f. 26; Tiranë 1996)

Kanë kaluar mëse 113 vjet dhe akoma nuk është vërtetuar vendlindja. Edhe pse historianët shqiptar kanë cituar ato pak historian e udhëtar turq, si: Osman Evlija Çelebi, Kronisti Ibn Kemalit, Enveriut, Hoxha Saded, Sollakzadesë e Mynexhimbashit, Nedim Ahmet, Neshriu, Aliu, Haxhi Kallfa, Kronikat anonime osmane, H. Inalcik etj. Studiesi Mit'hat Frashëri në artikullin në revistën "Diturija" të vitit 1928,*"Burime të historisë shqiptare" shkruan: "….në godinën e parë (Pranë Bab-i-Alise S.M) mund te jenë 350 000 akte, gjashtëdhjetë e sa mijë prej të cilëve lidhen me kohën para motit 1225, nëpallatin Enderun-it (Top-Kapi) pandehet se janë 600 000 akte; gjithë kadastrat e para qenkan kataloguar dhe ruajtur mirë, por, të dytat në një gjëndje të keqe, të kalbura, të grisura, shumë dokumente të moçme janë bërë si brum dhe si thengjillë, duke u kalbur karta e ngjitur mellani."*

Po te ngjitemi në piramidën e kohës do të kemi një tjetër vështirësi *"Në shekullin e 15-të janë ndonjë 40 Iskanderbenj dhe ju duhet te gjeni fillimisht se cili prej këtyre është Iskenderbeu juaj."* shkruan Prof. dr. Sh. Sinani në nje vizite pune në arkivat Osmane. Ndërsa e kundërta paraqitet në vendet perëndimore ku nga 300 libra mbi Skënderbeun 92 janë botuar nga historian- shkrues arbëresh e italian, dhe më tej:

⟶

←"Qindra, për te mos thënë mijëra dokumente të tjere të një rëndësie të dorës së parë erdhën nga Arkivi Sekret i Vatikanit, nga arkivat e Romës, të Napolit, të Venecias, të Firences, nga biblioteka Laurenziana dhe Muzeu Correr, nga biblioteka Grotferrata-s, nga bibliotekat kroate, hungareze, austriake." (Prof. Dr. Shaban Sinani "Gjergj Kastrioti si protoganist i rilindjes europiane." në "Skënderbeu nga Barleti tek O. Schmitt." f. 305; Tiranë 2009.

Shtrohet pyetja sa studime historike monografi, dokumente të mbledhura nga autor shqiptar apo turq janë shkruar në Turqi ku heroi ynë kombëtar kaloi fëmijrin, shkollimin dhe si komndant ushtarak?? E kundërta ngja në Itali, ku vetëm albanologu i shquar Zef Valentini, për marrëdhëniet e Venedikut me Shqipërinë dhe Kastriotët ka shkruar 24 volume me dokumente venedikase që gjenden tashmë në bibliotekën e Firences, Itali.

Dhe se fundi, a nuk është historiani shqiptar me banim ne Firence Ilia Karanxha që ka zbuluar se autori i vërtet i themeleve të albonoligjise shqiptare dhe të jetës së Gjergj Kastriotit nuk është i ashtuquajturi Marin Barleti, por, Marin Beçikemi? Ky historian me këmbëngulje, sakrifica e kërkime në mëse njëmbëdhjetë vjeçare në te gjitha arkivat e bibliotekat italiane të përmendura më sipër. Me të cilat ai kërkon të bëje një revolucion në historiografinë kastriotiane, duke shkruar tre libra studimor një seri artikujsh me mbi 1000 faqe, duke trajtuar:"….. *një argumet jo të thjeshtë aq më tepër që në këtë çështje mplekset historia kastriotiane, gjithë historiografia e shkrojtur mbi Skënderbeun, mplekset biografia e hamendësuar e Barletit dhe ajo e dokumentuar e Beçikemit, mpleksen aspekte filologjike, ambienti venecian për periudhën kur kanë ndodhur ngjarjet…" (FB. Ilia Karanxha 20.09.2018)*

Duke futur borxh historianet shqiptar mëse një shekull të mashtruar keqas nga histori shkruesi italian Apostol Zeno, historiografia shqiptare, me Akademinë e Shkencave në krye ende nuk janë të përgatitur të përballojnë zbardhjen e së vërtetës, e cila është një sfidë e përgatitur me mençuri, me një arsyetim te hekurt, fakte të gjalla e kokëforte nga dokumente e shkrues të historisë së mesjetës nga intelektuali I. Kalanxha. Kështu që, edhe pse bëjnë konferenca e simpoziume deri me rastin e 550 vjetorit të ndarjes nga jeta të Gjergj Kastriotit, fatkeqësisht nuk kanë arritur as të shpien Kastriotët e Gjergjin e tyre në mjedisin historik natyral te jetës se vrullshme të tij, luftave e gjenologjive të familjes se Kastriotëve në të dy kontinentet.

Përse vallë historiografia shqiptare, politikanë e studiues të fushave të etnografisë, kulturës, artit, arkitekturës përdorin emrin Skënderbe, kur dihet se ai me këtë emër u pagëzua nga Sulltani, për motive turqizimi e islamizimit të tij ku: "*Morfologjikisht "**Skënderbej"** është një kompozitë që përmban një emër të përveçëm turk: **"Iskënder**", shqip "Skënder" dhe një titull te fituar për merita lufte (turq. **"bey"** sot në kuptimin Zotni) (Po aty, f. 312; Prof. dr. Sh. Sinani);* dhe me tej: "*…..pra emri **Skënder**. Lidhet ne mënyrë* të drejtpërdrejt me variantin oriental ***Iskënder*** të emrit të ***Aleksandrit të Madh**." (Dr. Dritan Egro, "Skënd.ident.i ndrysh apo titul. Turk.-osm." në:"Skënderbeu dhe evropa." f.119-120, Tiranë 2006).* Por ky emër nuk ishte e vërteta e prejardhjes të një familjeje të krishtere epiriote ose shqiptare apo dhe e vetë Gjergjit lindur dhe fëmijëruar në fshatin Kastriot të Dibrës se vogël në Shqipëri. Qëllimi i tyre më i largët, ishte varrosja e këtij kombi, asgjësimi fizik, kulturor, etnografike prandaj për t'a kthyer në mjedisin historiko-natyral duhet të shkruhet e të thirret ***Gjergj Kastrioti***, ndryshe ne mbetemi në preherin rrënqethës, drithërues të sundimit të sulltanëve, të kulturës, të fesë e vendimeve të tyre në më shumë se gjashtë shekuj.

T'iu mbyllim shtigjet sulmeve e dyshimeve duke i paguar borxhet kalorësit triumfator e legjendar kundër turqëve, Gjergj Kastriotit, për të qartësuar momentet kryesore të origjinës, jetës e veprimtarisë së tij luftarake, politike, diplomatike e fetare, nëpërmjet kërkimeve në arshivat turke dhe të tjera, të shoqëruara me kërkimeve arkeologjike për qartësim e bindshmëri të fakteve, si binom i domosdoshëm e shkencor për historiografinë kastriotiane.

Përkujtohet rikthimi i Skënderbeut nga Nishi në Dibër

Nga **Azis KETA**

Më 25 nëntor 2018, në Sinë të Dibrës, nën kujdesin e shoqatave "Çidhna dhe Kastriotët" dhe "Unioni i krijuesve dibranë" u bënë dy aktivitete në kuadër të Vitit të Skënderbeut: Imitimi i kthimit të Skënderbeut nga Nishi në Sinë të Çidhnës (1443) dhe sesioni shkencor në Qendrën Kulturore Peshkopi, ku u trajtuan 7 kumtesa në fusha të caktuara.

Nderuan me pjesëmarrje dhe kumtesa në sesionin shkencor: Profesor Paskal Milo, Prof.as. dr. Bernard Zotaj, Drejtor i Muzeut të Ushtrisë Dr. Asllan Zemani, Dr.Zyber Gjoni dhe disa studiues dibranë: Ali Hoxha, Haki Përnezha dhe Azis Keta.

Duhet përgëzuar biznesmeni nga Bulqiza Eduart Keta, i cili me një gatishmëri shembullore vendosi të kontribuonte për këtë aktivitet. Falënderim në emër të nismëtarëve bëhet dhe për Qendrën Kulturore Peshkopi, gjimnazet në Kastriot dhe Peshkopi, shkollën e Mesme Arras, 9 vjeçare në Sinë, Word Vision, Zyber Gjonin, Enver Kaloshin, Abas Kacën, Rauf Ymeraj, Haki Përnezhën dhe Ymer Tafën.

Imitimi i kthimit të Skënderbeut nga Nishi me 300 kalorës e këmbësorë u improvizua me dhjetëra kuaj të mbledhur që nga Kalisi deri në rrethinat e Çidhnës.

Nxënës të gjimnazeve të Dibrës improvizonin këmbësorët. Të gjithë, kalorësit dhe këmbësorët ishin të veshur me kostume kombëtare dhe të pajisur me mjete imitimi luftimi, ku veçoheshin 30 shpata dhe disa mjete të tjera luftimi: heshta, shigjeta, topuz etj.

Të gjitha këto mjete luftimi ishin përshtatur sa më afër origjinaleve.

Afrimi dhe pritja ishte organizuar në formë spektakli, ku binte në sy një regji e kujdesshme dhe koreografi profesioniste e Rufat Ymeraj, sidomos tek vallet, sa epike të burrave aq dhe qytetare të vashave.

Pati dhe disa solistë që plotësonin këndshëm pjesë të spektaklit, ku kishte dhe përshëndetje prej të ftuarve, Këshillit Bashkiak, Bashkisë dhe organizatorëve.

VIZITA NE MUZE

Befasia e të gjithëve ishte Muzeu. Nuk ishte ai i vëzhgimit mediatik i para disa viteve. Ishte i rikonstruktuar si godinë dhe i pasuruar në përmbajtje.

Një shi i hollë që dukej sikur dhe qielli po vajtonte, nuk e ndërpreu aktivitetin brenda dhe jashtë muzeut. Bukuria shtohej tek imitimi i kalorësve rreth muzeut, garda, roja kufitare si dhe truproja e nderit në hyrje të muzeut. Vizita në Muze, dëshira për të bërë foto para çdo stende dhe objekti me të ftuarit, e hijeshuan aktivitetin. Secili mori një kujtim të veçantë, si nishan historik nga ky aktivitet mbresëlënës.

Një grup vajzash me veshjen tradicionale të Çidhnës, krijonte idenë e dasmës së Skënderbeut në hyrje të muzeut.

Improvizimi i një gare me kuaj, edhe se nuk mundi të ndiqej nga të gjithë për kufizimet që krijojë koha me shi, ngjalli jo pak interes tek të pasionuarit e kësaj veprimtarie.

Katër burra, me një talent të lindur, shoqëruar me profesionalizëm nga orkestra dhe të trajnuar nga një koreograf profesionist, ngjallën tjetër emocion, që ndoshta ishte ndër pikat kulmore të spektaklit. Solistët dhe disa djem me çifteli, plotësonin programin me një regji të menduar hollë ku bënin përshtypje mesazhet e përcjella me elokuencë nga një vajzë simpatike, Lorana Alia, që luajti dhe rolin e moderatores.

MIQ NGA BREGU I JONIT DHE LABERIA

-Sa bukur! Bravo Dibra, - përsërisnin dy miqtë nga Labëria, Bernardi dhe Asllani!

-Pse na preve në besë?- do i ankohej Nardi shokut të tij dibran. E dinit se edhe unë dhe Asllani, i kemi në gardërobat tona kostumet e Labërisë? I ruajmë ato si t'i kishim kostume të dhëndërisë. Ah, ta kishim ditur, të ishim veshur me to! Sepse Sina sot, është e gjithë Shqipërisë! Sepse Labëri e Malësi, kanë qenë bashkë në histori.



Kur befas miqtë nga Labëria u ndeshën në rrugën që kthente për Sinë me kalorësinë dhe këmbësorinë dibrane që "vinte nga Nishi", të gjithë në kolonë e të organizuar aq mirë, bënin çudi: "Kush e krijojë këtë disiplinë kolone edhe në këtë rrugë fshati edhe se shiu po binte curril?"

Por porosia e organizatorëve kishte qenë: Kthimin e Skënderbeut në Sinë, nuk duhet ta shohë vetëm Sina, por çdo fshat ku do kalojë kjo kolonë, ndaj rregulli do ishte maksimal gjatë gjithë marshimit në qendrat e banuara. Po nuk u bë kjo, aktiviteti do quhet i dështuar. Sepse kjo veprimtari, do të ishte pjesë e kujtesës historike jo vetëm e atyre që ishin në Sinë, por e gjithë fshatrave të Dibrës, sepse aktiviteti ishte i tyre dhe për ta.

Kur shoferi ynë mbeti i bllokuar nga autokolona e gjatë e "kalorësisë dhe këmbësorisë" që imitonin kthimin nga Nishi dhe ne duhej të shpejtonim, t'i parakalonim për të kapur orarin e takimit në Sinë, pati propozim për të parakaluar. Por miqtë nga Labëria kundërshtuan prerë: "Në asnjë mënyrë jo! Këta e kanë gdhirë duke udhëtuar dhe neve të shkërmoqim këtë kolonë kaq të organizuar? Kurrë!"

" -Jo, përsëriti Asllani dhe Ymer KETA, që vinte dhe ai posaçërisht nga Lezha. Ne jemi "ushtarë" para këtyre burrave – do qortonte Nardi, sepse ne në makinë, ata në këmbë dhe në kuaj. Ata po sfidojnë kohën mes shiut dhe shihni: asnjë çadër! Kurse ne jemi për bukuri."

Shihni me ç'farë rregullsie të habitshme ruajnë distancat. Bravo rinia! Ju lumtë kalorësve! Sa e bukur ideja dhe realizimi!

KRYEBEFASIA NE HYRJE TE MUZEUT

Truproja e nderit, e rreshtuar në dy rreshta para muzeut, me shpatat dhe heshtat në pozicionin ceremonial "Për nder Armë!" pritën Paskal Milon- historian e ish Ministër i Jashtëm dhe ish-deputet i Dibrës. Bernard Zoton dhe Asllan Zemanin, historianë. Personalitetet lokale: kryetari i Këshillit Bashkiak të Dibrës Hajri Laçi, sekretarja e Përgjithshme e Bashkisë, përfaqësues nga Komiteti i Veteranëve të Dibrës etj. Të gjithë të ftuarit dhe çdo i pranishëm që dëshironte të vizitonte muzeun, parakaluan para truprojës së nderit.

Të gjithë të barabartë dhe të gjithë u ndjenë të vlerësuar.

Emocionet dhe përkujdesja për miqtë fillonte nga më plaku në këtë veprimtari, Ali Hoxha. Ai i takonte të gjithë, diku me shtrëngim dore e diku me një buzëqeshje të ëmbël që ja hijeshonte thinjat që i ishin shtuar në arkiva duke studiuar për Skënderbeun.

Më të rinjtë, Daci dhe Përnezha përkujdeseshin për gjithçka, që mos dilte asgjë jashtë regjisë që e kishin përgatitur bashkërisht, me aq profesionalizëm dhe të realizuar me aq kulturë.

Dy djem me një çifteli në dorë, bënin prova "m'çeftas", sepse ende ndjenin se duhej të bënin diçka më mirë.

Mikpritja dibrane që e pret mikun tek porta, u pa dhe në Sinë më 25 nëntor 2018, por me një risi krejt të përveçme:

Mikpritja ishte me roje nderi!

Dëshira për të bërë foto me Profesor Paskalin, Bernardin, Asllanin dhe përqafimi i ngrohtë me krijuesit dibran, ishin pasqyrë e shpirtit të

Bernard Zotaj, në kumtesën e përbashkët me Asllan Zemanin, theksoi se "Skënderbeu ende kërkon studime të thelluara, sidomos për parimet e artit ushtarak, strategjinë dhe taktikën, ku ai hodhi themelet. Kontributet e Skënderbeut në fushën e artit ushtarak janë universale, por ende jo të gjitha të zbërthyera në gjerësi dhe thellësi, në gjithë kompleksitetin e tyre dhe seriozitetin që meritojnë.

pastër. I mikpritjes dibrane për mikun. Fotot e shumta që bëheshin në këtë ditë të shënuar, vlerësoheshin si "nishane historike dhe certifikatë pjesëmarrje". Secili ndjehej mirë që ishte pjesë.

SESIONI SHKENCOR NE QENDREN KULTURORE PESHKOPI

Sesionin, natyrshëm e drejtoi profesor Milo që kishte dhe referatin kryesor. Rolin e moderatorit e kryente Fatos Daci.

Elokuenca e profesor Milos dhe marrëdhënia që ai krijojë me auditorin, ku referoj temën: "Dimensioni Europian i Skënderbeut", bëri që të ndiqej me shumë vëmendje. Milo dhe referuesit e tjerë, shfrytëzuan këtë takim edhe për diskutime të lira. Kumtesat jua dorëzuan organizatorëve.

Prania e mediave edhe në sesionin shkencor dhe regjistrimi i plotë i çdo diskutimi, ndoshta do plotësojnë edhe më shumë kumtesat e secilit.

Paskal Milo, informoj se "Dimensioni Europian i Skënderbeut" ishte referuar edhe në Londër dhe ishte pritur mjaft mirë sepse edhe Londra e njeh dhe e pranon dimensionin evropian të Skënderbeut.

- Dibra, vijoi Milo - ka kontribute të qenësishme që lidhen me Historinë e Skënderbeut dhe jo vetëm. Unë do i bashkohem lëvizjestheksoj ai, që të sensibilizoj institucionet që puna e nisur në Sinë dhe në Dibër të përmirësohet. Që Muzeu të pasurohet dhe rruga deri në hyrje të muzeut të asfaltohet. Që t'i paraprimë turizmit elitar të nesërm. Sepse Skënderbeu na faktorizoj ndërkombëtarisht qysh kur vendosi marrëdhënie diplomatike me gjithë faktorin ndërkombëtar.

Profesor Milo citoj vlerësime të personaliteteve për kontributet e Skënderbeut si burrë shteti dhe komandant i Përgjithshëm i ushtrisë së Lidhjes Lezhës dhe evidencoi veprat që ishin shkruar dhe vazhdojnë të shkruhen për Skënderbeun.

Bernard Zotaj, në kumtesën e përbashkët me Asllan Zemanin, theksoi se "Skënderbeu ende kërkon studime të thelluara, sidomos për parimet e artit ushtarak, strategjinë dhe taktikën, ku ai hodhi themelet. Sepse kontributet e Skënderbeut në fushën e Artit Ushtarak janë universale, por ende jo të gjitha të zbërthyera në gjerësi dhe thellësi, në gjithë kompleksitetin e tyre dhe seriozitetin që meritojnë.

(vijon në faqen 14)

Rruga e Arbërit nr. 151

Prioritetet e buxhetit 2019 në Dibër:
bujqësia dhe zhvillimi rural, shëndetësia, arsimi, turizmi...

buxheti

Ja ku po punohet në Rrugën e Arbrit

Nga **ALMIRA ZEBI XHEMBULLA**

Viti i Skenderbeut erdhi me këmbë te mbare per Dibren e Skenderbeut në nder të të cilit u rikonstruktua edhe Muzeu në Sinë.

Këtë vit Dibra u vizitua disa herë nga Kryeministri. Ministrat organizuan dëgjesa në cdo njësi të qeverisjes lokale. Disa nga problematikat kryesore të dala nga këto takime janë të reflektuara në projekt buxhetin e 2019.

Një vit më parë me zërin qe më tradhtonte pak se foltorja e parlamentit ka peshë te rëndë , por patjetër edhe prej ndjeshmërisë maksimale që ka cështja e Rrugës se Arbrit fola për rrugën, rendësinë ekonomike dhe përpjekjet e shumta te bëra në vite për ndërtimin e kësaj rruge.

E prita me shumë gëzim ashtu si cdo dibran lidhjen e kontratës me kompaninë. Ishte nje lajm i madh e i shumëpritur, por për ne Dibranët që i kishim inaguruar nja dy –tri herë fillimet e punimeve te rruges ngjante akoma e pabesueshme edhe pse cdo gje ishte e qarte dhe konkrete dhe projekti për herë të parë ishte hartuar per të gjithë rrugën.

Të dashur bashkëqytetarë sot kam kënaqësinë të ndaj me ju këtë informacion:

Aktualisht në këtë rrugë po punohet për ndërtimin e trasesë të rrugës në të gjithe gjatësinë e saj, me përjashtim të 4 km ne Fshatin Shkallë.

Nga 6 tunele qe ka projekti i Ndërtimit të Rrugës së Arbërit, deri më sot janë hapur 2 prej tyre, është në përfundim tuneli i tretë dhe po punohet per hapjen e tunelit të Murrizit. Gjatësia e tuneleve të hapur është 1.55km, nga rreth 8km gjithsej që ka projekti.

Gjithashtu është përfunduar hapja e tunelit nr.5 me gjatësi 500m, tunelit nr. 6, që është 360 m i gjatë, si dhe brenda javës pritet të përfundoj hapja e tunelit nr.4 me gjatësi 370m.

Ndërkohë tek tuneli i Murrizit deri më sot në të dy tubat e tij janë hapur 360 m tunel.

Një punë kolosale është kryer për ndërtimin e katër urave kryesore. Kështu është përfunduar struktura e Urës U3 mbi Lumin Zalli i Bulqizës me gjatësi 150m, si dhe është ne përfundim ndërtimi i strukturës së Urës U4 mbi Drinin e Zi, e cila ka një gjatësi prej 270m.

Një punë tepër voluminoze dhe e vështirë po kryhet për ndërtimin e Urës së Vashës me gjatësi 280m dhe lartësi 152m mbi nivelin e Lumit Mat. Ketu po kryen punimet për ndërtimin e themeleve, për të mundësuar që brenda këtij viti të fillojë montimi i strukturës së çeliktë të urës.

Së shpejti do të fillojë puna edhe në Urën e Fshatit Fshat, që është e ngjashme me atë të Vashës.

Faleminderit qeverisë, Kryeministrit dhe punë të mbarë kompanisë Gjoka e me krahë të lehta punëtorëve e inxhinjerëve që po punojnë intesivisht!

Fillimi i punimeve per rehabilitimin e rreth 19 km te segementit te rrugës Burrel-Klos ishte nje domosdoshmeri per Qarkun e Dibres. Ky aks per shume kohe ka qene nje tmerr I shofereve dhe udhetareve. Ishte kosto e madhe dhe burim aksidentesh. Shpresoj qe koha e keqe mos te pengoj punen e nisur.

Meqë jemi te investimet në infrastrukture dua të përmend perfundimin e rrugës së Ulzës, rrugës Kastriot-Arras, Unazës së madhe në Peshkopi e disa rrugë të tjera rurale.

Duke kaluar te një tjetër prioritet që është Bujqësia dhe Zhvillimi Rural dua të theksoj qe përvec investimeve ne kanalet vaditës jam shumë e kenaqur qe kete vit u lidhen 5 kontrata mes AZHBR's dhe agropërpunues dhe sipermarrës ne agroturizem. Po vazhdohet intesivisht mbeshtetja per etiketimin dhe certifikimin e produkteve qe do te bejne te mundur shtimin e aksesit ne treg dhe rritjen e vleres se produktit.

Ju kërkoj strukturave dhe ofruesve te sherbimeve te asistojne dhe te mbeshtesin fermeret potencial te aplikojne ne skemat e IPARD-it.

Heqja e TVSH per inputet bujqësore është një lajm shumë i mirë për fermerët sepse do të ndikojë direkt në uljen e kostos së prodhimit.

Shëndetësia. Sa i takon sektorit te shendetesise dua ta falenderoj ministren per angazhimin dhe mbeshtjen qe i ka dhene ketij qarku. U rikonstruktuan dhe u pajisen me aparatura disa qendra shendetesore. Spitali rajonal u pajis me mamografi. Ne bashkepunim me kompanine "Doni Fruits" qe gjej rastin ta falenderoj u be rikonstruksioni Urgjences ne spitalin rajonal te Dibres. U lidhen kontrata te reja me mjek specialist, dhe pritet qe me mbarimin e specializanteve te rinj te plotesohen edhe disa boshlleqe te tjera. Patronazhimi qe mbuloi maternitetin e Burrelit e zgjidhi me se mire situaten kritike qe ishte aty, nderkohe ne kete projekt buxhet eshte parashikuar edhe rikonstruksioni I ketij materniteti. Gjithashtu jane parashikuar edhe rikonstruksioni I qendrave te tjera shendetesore. Mbeten akoma disa qendra qe kane nevoje per rikonstruksion po besoj deri ne fund te mandatit qeveria do te mund te rikonstruktoj ato me prioritaret.Sigurisht nevoja per mjeke te pergjithshem dhe specialist vazhdon të jetë e madhe, por me politikat nxitese dhe mbeshtese kam besim qe sherbimet kryesore do te mbulohen.

Meqenenese jemi te investimet: Ne projekt buxhet eshte parashikuar rikonstruksioni I rrjetit kryesor të ujësjellësit dhe shperndarjes per qytetin e ri Bulqize dhe fshatin Vajkal (ky investim parashikohet te behet ne 2020) Nderkohë shtimi i prodhimit të Kromit dhe mundësia e perpunimit dhe pasurimit në fabriken e Ferrokromit Burrel është një zhvillim shume pozitiv dhe uroj te reflektohet e ndjehet edhe tek qytetaret e Bulqizes.

Ne fushen e arsimit eshte parashikuar ndertimi I nje shkolle te re ne Bashkine Diber. Gjithashtu eshte parashikuar rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare te Qytetit te ri Bulqizë.

Në transfertën e vitit 2019, njësive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor.

Nderkohe jam e lutur ndaj Njesive te vetëqeverisjes vendore te mendojne seriozisht per menaxhimin si duhet te ketij fondi.

Por Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të shtuar investimet në këtë sektor.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ne bashkepunim me eksperte po punon per pergatitjen e nje pakete per politikat ne pyje me qelllim qe te arrihet nje menaxhim me i mire qe te adresoj problematikat kryesore ne sektor. Po bëhet një punë e mirë në drejtim të shtimit të produkteve turistike ne të gjithë zonën dhe numri i turistëve është rritur.

Në transfertën e 2019, njësive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin.

Rrugët rurale. Në transfertën e vitit 2019, njësive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki.


Do te kerkoja nga Bashkitë të kenë prioritet rrugët e fshatrave turistike:

Rabdishti, Radomira, Zerqani (ka po te përmirësohet) Bushkashi, Guri i bardhë. Ky investim eshte prioritar për të siguruar një zhvillim real të turizmit në këto zona.

Te gjitha investimet, nderhyrjet, rritja e pagave, çeku i bebeve, librat falas e politikat e tjera mbeshtetese do te aplikohen si në gjithë Shqipërinë.

**** Fjalë e mbajtur në Kuvendin e Shqipërisë më 22 nëntor 2018.***

FOTOFAKT: / KUR NISMËTARËT VËZHGOJNË PUNËN QË PO KRYHET NË RRUGËN E ARBRIT





Hysen Uka duke vëzhguar punimet te Ura e Vashës, Klos.

Nga 6 tunele qe ka projekti i Ndërtimit të Rrugës së Arbërit, deri më sot janë hapur 2 prej tyre, është në përfundim tuneli i tretë dhe po punohet per hapjen e tunelit të Murrizit. Gjatësia e tuneleve të hapur është 1.55km, nga rreth 8km gjithsej që ka projekti.

Një punë kolosale është kryer për ndërtimin e katër urave kryesore. Kështu është përfunduar struktura e Urës mbi Lumin Zalli i Bulqizës me gjatësi 150m, si dhe është ne përfundim ndërtimi i strukturës së Urës mbi Drinin e Zi, e cila ka një gjatësi prej 270m.

Një punë tepër voluminoze dhe e vështirë po kryhet për ndërtimin e Urës së Vashës me gjatësi 280m dhe lartësi 152m mbi nivelin e Lumit Mat. Ketu po kryen punimet për ndërtimin e themeleve, për të mundësuar që brenda këtij viti të fillojë montimi i strukturës së çeliktë të urës.

artefakt

Fjalë e mbajtur në ceremoninë simbolike të vigjiljes së festave të nëntorit, në Vitin Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut, që u mbajt më 27 nëntor sallë COD në Kryeministri.

Artefakti i jashtëzakonshëm, harta që provon vërtetësinë dhe influencën e figurës së Skënderbeut në Europën e shekullit XV

***Nga* Edi RAMA**

Dokumenti i shkurtër u ndal në morinë e eventeve dhe momenteve të këtij viti, por janë me dhjetëra, në mos me qindra evente e momente kushtuar Heroit tonë Kombëtar, ndërmarrë dhe krijuar nga individë, apo bashkësi të ndryshme.

Gjej rastin t'i falenderoj përzemërsisht, apo më saktë t'u shpreh të gjithëve respektin për përfshirjen e tyre të organizuar, ose spontane, në ushqimin e flakës së kujtesës përgjatë të gjithë Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut.

E mes kësaj morie spikat një gjest unik, një shfaqje rrezatuese e talentit krijues dhe mishërim simbolik i këtij viti të shënjuar nga ylli i dritës. Dua ta veçoj këtë gjest dhe përpara se të them fjalët e rastit për këtë ceremoni simbolike të vigjiljes së festave të nëntorit të Vitit të Skënderbeut dhe njëkohësisht të përmbylljes së këtij Viti, të tërheq vëmendjen tuaj mbi shfaqjen në fjalë.

Kjo përkrenare që shihni në krahun tim të djathtë na ka shoqëruar gjatë këtij viti, qysh prej përkujtimit gjithaq të veçantë të 550-vjetorit të kalimit n'amshim të Gjergj Kastriotit.

Kjo përkrenare, ky objekt këtu, shëmbëlltyrë e krenarisë së kombit dhe sublimim simbolik i vijimësisë historike të shtetit shqiptar është dhe një krenari e artizanatit më të rafinuar shqiptar.

Unë i jam thellësisht mirënjohës autorit duarartë të saj, argjendarit të famshëm, Pirros (Ruci), i cili na ka njoftuar se, këtë përkrenare, kurorë të mbarë shqiptarisë, ia dhuron Kryeministrisë.

Duke e njohur, jo vetëm unë, por të gjithë historinë e dhuratave dhe të dedikimeve që i janë bërë në vijimësi kësaj godine, apo godinave të tjera të shtetit dhe që nuk dihet ku kanë përfunduar, dëshiroj që ta qetësoj paraprakisht argjendarin e famshëm, autorin e kësaj përkrenareje, lidhur me faktin se nuk ka shans që edhe përkrenarja të humbasë, siç kanë humbur shumë dhurata, apo kontribute simbolike në të shkuarën, sepse ne kemi iniciuar një traditë normale, të mësuar nga vende, të cilave u kemi zili hiret e mirësjelljes me veten dhe të gjitha dhuratat inventarizohen. Asnjë dhuratë që vjen dhe më dorëzohet mua nuk është e imja, i takon kësaj godine, i takon memories së kësaj godine dhe jemi duke ndërtuar në katin më poshtë, Muzeun e historikut të kësaj godine – kjo godinë ka një histori të vetën – dhe bashkë me historikun, edhe Muzeun e të gjitha dhuratave.


Përkrenarja, ndryshe nga dhuratat e tjera, nuk do të shkojë poshtë, por do ngjitet lart dhe do t'i përkasë inventarit të atij Muzeu.

"Nuk mund të qëndroja në turpin e një shpirti mosmirënjohës, në atë turp që harron atdhenë dhe i mohon diçka të drejtë që kërkonte prej meje, prej meje që kisha qenë një gjymtyrë, një pjesë me rëndësi e atij dheu, për ta përjetësuar me një përmendore letrare. Puna e gjykatësit do të jetë që të çmojë sa zjarr dashurie ka pasur kush, për hir të atdheut, dhe jo sa vlerë…"

Me këto fjalë, të cilat historiani i shquar Aleks Buda i përkufizon si një "porosi shoqërore" të çdo kohe, çelen në parathënien e tyre kryeveprat e humanizmit shqiptar dhe atij europian, Historia e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Princ i Epirit dhe Rrethimi i Shkodrës nga meshtari shkodran, Marin Barleti.

Thjeshtësisht dhe më përulësisht, përditësimi i këtyre "porosive" që prekin shekujt prej 500 vjetësh e tëhu ishte çka e shpuri edhe qeverinë tonë dhe të gjithë ne, sëbashku me të tjerët, në çeljen e siparit të një Annum Gratiae, të një Viti Mbarëkombëtar kushtuar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, ndërkohë që i aviteshim jubileut të 550-të të kalimit të tij në amshim.

Mirë që e gjithë kjo periudhë, ndryshe nga çfarë u parapa me frikëra, apo paragjykime nga ata që edhe miq të mirë ndërkombëtarë e komentuan këtë iniciativë, nuk u karakterizua nga asnjë fishekzjarr nacionalizmi, apo nga asnjë zhurmë daulleje për këngët e vjetra dhe të dala kohe të mendësisë nacionaliste.



"Matësi ma i mirë, ma i sigurtë për të gjykuar," – shkruante 70 vjet më parë Aleks Buda për Skënderbeun, – "asht konstatimi nëse nji figurë, nji lëvizje, nji ide vepron akoma, ngjall fuqi të reja për të përmbysur situata të kalbura, sepse këtë mund ta bajë vetëm nji ide e madhe përparimtare që ndihmon procesin historik të ecë përpara, pse shpreh aspiratat e thella e të fshehta të një mase të madhe njerëzish. Figurë e madhe asht çdo iniciator që parashef dhe fillon të realizojë, që kontribuon për mprojtjen e asaj që akoma s'asht, por që po pregatitet, që duhet dhe që do të vijë".

Pikërisht për këtë arsye, Vitin Mbarëkombëtar, e pamë si një vit ardhmërie.

"Serioziteti në gjërat e mëdha", – thotë një shprehje e njohur, – "fillon nga besnikëria dhe frytet e dhëna kundrejt gjërave, në dukje të vogla".

Ky vit ishte një pretekst, ose më mirë të themi një shtysë për motivim, një ogur i mirë për të vepruar për gjëra të vogla, të vogla në të gjithë madhështinë e kujtesës për Gjergj Kastriot Skënderbeun, në një vit me 6 datat e tij madhore që shërbeu, besojmë, për të ushqyer me fisnikëri, edhe me modestinë e fisnikërisë, një kujtesë kaq vetëdijësuese për identitetin tonë kombëtar dhe europian, por dhe për të përmirësuar këtu apo atje, sjellje dhe qasje të vetë shtetit.

E kam fjalën tek mangësi apo boshllëqe të krijuara në të shkuarën, në ndërkohë që, nëpërmjet ringritjes së një institucioni arkivor, me godina të reja mirëmbajtjeje, me salla leximi dinjitoz, si dhe projektit në punë e sipër për Bibliotekën e re Kombëtare në mjedise krejtësisht të reja, nëpërmjet dedikimit për muaj të tërë ndaj ringjalljes dhe stimulimit të kërkimeve albanologjike të kurorëzuara me një konferencë madhore ndërkombëtare kushtuar Skënderbeut dhe jehonës së tij, gjë që s'ishte realizuar ndonjëherë më parë, rimarrjes aty ku ishin lënë, si skelete pajetë të programeve të mëdha infrastrukturore, duke përfshirë këtu simbolikisht dhe rrugën emërbekuar të Arbrit, përmirësimit të kushteve jetike dhe profesionale të ushtrisë sonë të mjeshtërizuar, jo vetëm përmes rritjes së buxhetit, sepse kjo do të kishte ndodhur pavarësisht Vitit të Skënderbeut, por edhe përmes një përkujdesjeje të veçantë për të gjithë ceremonialin dhe besoj që nesër, në Ditën e Pavarësisë së këtij viti kaq të shënjuar, të gjithë do të pajtoheni me mua, se sa shumë i kishte munguar seriozitetit dhe solemnitetit të ushtrisë shqiptare dhe të shtetit ajo që do shihni të shpaloset në të gjithë paraqitjen e re të ceremonialit shtetëror, me uniforma, pajisje, mjete dhe instrumente të truprojës së nderit dhe orkestrës frymore, që do të përurohen pikërisht me rastin e 575-vjetorit të Lidhjes së Lezhës.

Përmes itinerareve muzeale, dy intereare muzeale, YIlit të Mëngjesit dhe Urtësisa e Pashuar, që sollën për publikun e interesuar artefakte, tablo, vëllime nga më të rrallat mbi jetën, veprën dhe epokën e Heroit tonë Kombëtar, për të cilat sytë e sa e sa studiuesve, që nuk janë më, patën qarë për t'i parë së paku një herë në jetë.

U përpoqëm, siç e thashë, me përkushtim, sqimë dhe modesti që të sillnim çka më parë ishte teori, ishte dëshirë, ishte objekt trillimesh dhe spekulimesh në mënyrë që ecurinë e muajve të këtij viti ta ndriçonim me një vijë qirinjsh të kujtesës për figurën e dokumentuar, por shpeshherë edhe të hamendësuar, apo fatkeqësisht ndonjëherë edhe të shpërfytyruar të Heroit tonë kombëtar.

Sot ceremonialisht mbyllet Viti Mbarëkombëtar i Skënderbeut, por, siç e thashë edhe më sipër, shumë prej gjërave janë në proces dhe për shembull, Samiti i Diasporës që përkon me 575 vjetorin e Lidhjes së Lezhës vitin e ardhshëm do të na mbajë edhe pak më shumë në frymën e veprës së pashoqe të Heroit Kombëtar, edhe sepse aty do të promovohen çka të apasionuarit dhe studiuesit kërkojnë tashmë prej dekadash, 10 vëllimet e dokumenteve për Skënderbeun, përpunuar deri ditën e fundit të jetës nga i ndjeri Kristo Frashëri dhe teza e doktoraturës e të pakrahasueshmit Eqrem Çabej.

Përveç të tjerash, Samiti do të jetë momenti i volitshëm për të falenderuar posaçërisht të gjithë ata që kontribuuan për suksesin e parë të nismës mbarëkombëtare që preku Shqipërinë, Kosovën, shqiptarët kudo ku janë.

Diçka më shumë sot, duke kujtuar se gjatë vitit të Skënderbeut, në janar, me qindra arbëreshë, nën drejtimin e dy kokave të shqiponjës arbëreshe, nëse mund t'i quajmë kështu dhe besoj mund t'i quajmë kështu, Mandala dhe Altimari erdhën këtu në tokën e të parëve dhe përmes një itinerari të ngjashëm, Roma dhe Napoli sjellin sot në Tiranë, falë një përpjekjeje të lëvdueshme të Artan Shkrelit dhe një mbështetjeje, që meriton të gjithë mirënjohjen tonë, të ambasadorit, një objekt të jashtëzakonshëm mrekullimi për të gjithë ata që kanë kuriozitet, kanë lidhje, kane pasion për historinë.

Roma, sepse artefakti që prej sot e për dy javë do t'i tregohet, ekspozohet publikut këtu në këtë godinë, ruhet si më i vjetri i llojit të tij, në Bibliotekën qendrore të qytetit të përjetshëm, prej ku ka ardhur në Tiranë.

Napoli, sepse këtu e desh edhe angazhimi i një napoletani të mirë si ambasadori italian, që bashkë me Shkrelin konkretizuan diçka që ishte vërtetë e vështirë në momentin e parë për ta imagjinuar se mund të konkretizohej dhe faktikisht bënë simbolikisht atë që, dikur, Skënderbeu në Mbretërinë e Napolit pati bërë një marrëveshje. Sot nuk është mbreti i Napolit, por një napoletan që përfaqëson Republikën italiane dhe që solli një copëz domethënëse të Skënderbeut dhe e ka sjellë me një ushtri, nuk është ushtria e mbretit të Napolit, e cila e priste andej Skënderbeun që të shkonte me ushtarët e vet, por është ushtria e Guardia di Finanza që ka ardhur nën udhëheqjen e ambasadorit, e shoqëruar me ambasadorët, apo lajmëtarët e Institutit Italian të Kulturës.

Tani protokolli na e ndalon që ta ftoj ambasadorin të mbajë një fjalë në mbyllje të një ngjarjeje mbarëkombëtare, por nuk na ndalon, përkundrazi, na e kërkon që botërisht t'i shprehim të gjithë mirënjohjen tonë të thellë për këtë gjest, që të gjithë ata që sot janë këtu e do ta shikojnë nga afër artefaktin dhe të gjithë ata të tjerë që do ta shohin gjatë dy javëve do ta mbanë mend gjatë. Shumë faleminderit!

> ***"Ne, bir i dashur, kemi patur gjithmonë mendim shumë të mirë për fisnikërinë tënde. Emri yt i lumtur është përhapur në të gjithë popujt për të gjitha këto punë të mira që ti ke kryer, për këto fitore të shkëlqyera që ti ke korrur. Qofsh pasqyrë e shembull për të gjithë princat e krishterë dhe për mbarë kombet dhe emri yt do të kurorëzohet prej famës së amëshuar!"***

Thuhet, thonë, nuk e di sa gjysmë legjendë dhe sa është e vërtetë, që Roma dhe Napoli u ndanë me borxhe me Skënderbeun. Borxhe që ne nuk i kërkuam kurrë ndaj Italisë mike dhe sot besoj që mund ta konsiderojmë këtë kontribut të Romës e të Napolit si një larje borxhi edhe për gjithë shërbimet që u kreu Gjergj Kastrioti.

E them këtë duke patur parasysh fjalët e urta të Imzot Nolit, historiografit të merituar të tij. Noli thoshte: "Nëse ne vërtetojmë dokumentarisht, saktësinë e të paktën tri fushatave perandorake të sulltanëve osmanë kundër Krujës dhe dështimin e turpshëm të tyre para mureve të kalasë, atëherë", – thekson imzot Noli, – "kemi vërtetuar se veprimtaria e Skënderbeut nuk është legjendë, por histori e vërtetë."

E pra, unë nuk jam historian. Larg qoftë të jem i tillë! Aq më tepër këto ditë, kur historianët po merren me mua, a thua se ua kam unë fajin që e kanë shkruar me pathos historinë kur u ishte e ndaluar gjakftohtësia, por artefakti që do të shikoni, përkatësisht një hartë në një lëkurë viçi ende të palindur të vitit 1455, është më shumë se një dokument që vërteton të jashtëzakonshmen në veprën e Skënderbeut në të gjallë të tij.

Jemi më 1455, dy vjet pas rënies së Konstandinopojës, tek, siç thuhet në shprehjen e dedikuar në katedrën e Shën Pjetrit, mbretëron lavdiplotë, "Gloriosamente regnante", Papa Nikolla V.

Jemi në vitin e disfatës më të rëndë e ndoshta të vetme të Arbërve nën muret e Beratit dhe ja ku, pikërisht në këtë lëkurë vici të palindur të 1455, një nga hartografët më të shquar të kohës së tij shkruan me sanguin tejpërtej në territorin shqiptar, mes emrave Albania dhe Macedonia, të vetmin emër vetjak të një kryezoti europian: Skandrebeco!

Ky emër që mishërohet me aq hijeshi në bustin e bronztë që Pirro e ka dhënë përkohësisht, se do e marrin mbrapa, në mjediset ku ndodhemi, i qëndron hartës si shëmbëlltyrë. Këtë emër, për të cilin Papa Piu II, i madhi humanist Enea Silvio Pikolòmini, thoshte tekstualisht "Do të mposhtë shekujt!"

Nëse Skënderbeu do të kishte qenë një mit pas vdekjes, një konspiracion humanistësh, apo një kaçak gjakatar në vend të atij për të cilin ne e njohim, pra, një luftëtar të kërkuar e të vlerësuar në të gjallë të tij dhe kryezot i trojeve të lira shqiptare, ky emër nuk do të ishte shkruar e ndoshta harta nuk kishte as pse të ekzistonte.

Në mbyllje, duke iu referuar asaj çka e shoh si transkriptim në letër të kodit-amanet të këtij artefakti, fjalët e Papës Kaliksti III, adresuar Skënderbeut në vitet 1450-1457, vitet e konceptimit dhe përpunimit të hartës, më lejoni të citoj:

"Ne, bir i dashur, kemi patur gjithmonë mendim shumë të mirë për fisnikërinë tënde. Emri yt i lumtur është përhapur në të gjithë popujt për të gjitha këto punë të mira që ti ke kryer, për këto fitore të shkëlqyera që ti ke korrur. Qofsh pasqyrë e shembull për të gjithë princat e krishterë dhe për mbarë kombet dhe emri yt do të kurorëzohet prej famës së amëshuar!"

Roma locuta, causa finita! (Pas fjalës së Romës, çështja quhet e mbyllur!) – thuhej dikur.

Rruga e Arbërit nr. 151


Më 2 mars 1444, në Katedralen e Shën Kollit në qytetin e Lezhës, u themelua Kuvendi i Lezhës, i cili ishte i pari kuvend kombëtar i princërve dhe i fisnikëve shqiptarë të shek. XV.

Kuvendi i Lezhës

Nga **Rezehana HYSA**

"Lirinë mund ta kishit fituar me trimërinë tuaj dhe me një tjetër çlirimtar se Arbërisë nuk i mungojnë burrat. . Lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta këtu në mesin tuaj. Armën nuk ua ngjesha unë, por ju gjeta të armatosur. Lirinë e kishit kudo, në kraharor, në ballë, në shpatë dhe në ushta"

(Skënderbeu, Krujë 1443)



Gjergj Kastriot-Skënderbeu ishte përfaqësuesi më konsekuent dhe me i shquar i elitës drejtuese shqiptare, i cili udhëhoqi me vendosmëri frontin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osman. Nën udhëheqjen e tij lufta e shqiptarëve u ngrit në një shkallë më të lartë dhe më të organizuar , e cila shënoi një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të Shqipërisë. Krahas mbrojtjes së vendit ai i kushtoi kujdes edhe viseve të tjera të pushtuara shqiptare e cila ndikoi në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve me banorët e këtyre viseve dhe në forcimin e bashkimit të të gjithë popullit shqiptar. Për ti bashkuar forcat shqiptare bashkë me princër të tjerë Skënderbeu më 2 mars 1444 në Katedralen e Shën Kollit në qytetin e Lezhës themeluan Kuvendin e Lezhës, e cila ishte i pari kuvend kombëtar i princërve dhe i fisnikëve shqiptar të shek. XV. Në këtë Kuvend morën pjesë Skënderbeu, Gjergj Arianiti, Andrea Topia bashkë me dy djemtë e tij, Gjergj Stres-Balsha, Nikollë e Pal Dukagjini, Teodor Muzaku i riu dhe disa pjestarë të tjerë të kësaj familjeje, Lekë Zaharia, Pjetër Spani bashkë me 4 djemtë e tij, Lekë Dushmani, Stefan Gojçini etj. Para mbajtjes së Kuvendit, ai zhvilloi paraprakisht me ta takime vetanake, si rrjedhojë e të cilave u vendos që të mbahej në Lezhë një kuvend i fisnikëve shqiptarë. U zgjodh Lezha si vend për mbajtjen e Kuvendit sepse kishte një pozicion gjeografik të favorshëm për mbajtjen e saj. Ajo ndodhej në afërsi me zotërimet e pjesëmarrësve kryesorë të Kuvendit, ishte e veçuar nga zotërimet e tjera të Venedikut dhe kishte lidhje të ngushta ekonomike me viset e çliruara shqiptare, veçanërisht me ato të Kastriotëve. Fjalën hyrëse dhe hapjen e Kuvendit e mbajti Skënderbeu, i cili u ndal në domosdoshmërinë dhe rëndësinë e bashkimit politik të shqiptarëve, ndërsa pjesëmarrësit të tjerë diskutuan format e bashkëpunimit dhe rrugët për realizimin e bashkimit politik të tyre. Kështu ata institucionalizuan Kuvendin si forumin politik më të lartë vendimmarrës të fisnikëve shqiptarë duke lënë mënjanë divergjencat të deri atëhershme ekonomike dhe politike të vendit duke nxjerrë mësim nga përvojat e kaluara.

Kryetar i Lidhjes u zgjodh Gjergj Kastriot Skënderbeut ndërsa Institucioni më i lartë vendimmarrës u bë Kuvendi i anëtarëve të Besëlidhjes, i cili do të mblidhej herë pas here për të diskutuar çështje të rëndësishme. Kuvendi vendosi që bashkimi të bëhej në formën e një besëlidhjeje të një aleance ushtarake nëpërmjet drejtuesve të principatës e të krerëve të tjerë të vendit që njihet me emrin Lidhja shqiptare e Lezhës. Në Kuvendin e Lezhës u vendos që të formohej një ushtri e përbashkët bërthamën e së cilës e formuan luftëtarët që i mobilizonte vetë Skënderbeu. Ushtria shqiptare përbëhej nga trupat e përhershëm dhe nga luftëtarë që mobilizoheshin vetëm gjatë kohës së luftës. Trupat e përhershëm ishin ndarë në dy pjesë kryesore. Njëra përbëhej prej 2000-3000 kalorës të armatosur lehtë të cilët i stërviste Skënderbeu dhe shërbenin si gardë personale e tij dhe pjesa tjetër ruante kështjellat e vendit dhe brezin kufitar në viset lindore. Në rast mobilizimi të përgjithshëm, forcat ushtarake shqiptare arrinin nga 20. 000-30. 000 luftëtarë duke formuar një ushtri të madhe për kohën. Me Lidhjen e Lezhës secili princ ruante autonominë e vet politike ndërsa Skënderbeu si kryetar i saj nuk kishte të drejtë të ndërhynte në zotërimet e sundimtarëve të tjerë, por caktimi i një udhëheqësi politik e ushtarak unik ishte një hap që ndihmonte për kapërcimin e përçarjes feudale. Pas Kuvendit të Lezhës, Skënderbeu organizoi një ushtri prej 8. 000 kalorës dhe 7. 000 këmbësor ku një të tretën e bënte garda e tij.

Kuvendi gjithashtu vendosi që të krijohej një arkë e përbashkët e cila do të administrohej nga Skënderbeu. Të ardhurat e saj do të vinin nga kuotat që do të jepnin anëtarët e Lidhjes. Krerët e vegjël që nuk jepnin dot para u ngarkuan të dërgonin më tepër ushtarë. Në këtë pikë Pal Dukagjini propozoi të caktohej edhe numri i ushtarëve që do ti jepte çdo kapedan, por pas shumë bisedimesh kjo çështje mbeti në pëlqimin e çdo kryezoti. Të ardhurat e përmotme të Skënderbeut ishin sipas Barletit 200. 000 dukata të arta nga pagesat e kapidanëve aleatë, nga të ardhurat e principatës së Krujës dhe nga kriporet e Shën Kollit të Gurrit afër Durrësit. Ushtria e ligës ishte afër 18. 000, gjysma kalorësi e gjysma këmbësi. Tri të katërtat ishin nga principata e atërore e Skënderbeut, krutjanë, matjanë, mirditas dhe dibranë. Pas përfundimit të Kuvendit të Lezhës, Skënderbeu i shoqëruar prej nipërve dhe Pal Dukagjinit u kthye në Krujë. Në Kuvendin e Lezhës qëndrimi i Venedikasve ishte tipik. Ata dërguan vëzhgonjës në Kuvend, për të dëgjuar dhe për të raportuar, por nuk morën kurrfarë zotimi, por i lejuan Skënderbeut ta mbante mbledhjen e tij në tokën venedikase(Republika e Venedikut në këtë kohë kishte nën zotërimin e saj shumë qytete të Shqipërisë).

Në Lidhjen e Lezhës u bë i pari bashkim politik në shkallë mbarëshqiptare që njihet në historinë e Shqipërisë. Skënderbeu duke qenë komandant i përgjithshëm, nën udhëheqjen e tij ushtria që ai udhëhoqi u bë tejet e organizuar në mbrojtjen e vendit. Tokat shqiptare për me se 25 vjet mundën tu bënin ballë vërshimeve të njëpasnjëshme dhe betejave masive, bllokadave dhe rrethimeve që organizoi Murati i II-të dhe i biri i Mehmetit të II-të të ashtuquajtur"pushtues të botës", ku një pjesë e tokave shqiptare u përfshinë në një shtet të vetëm. Shteti i Skënderbeut kah vitet '60 arriti të shtrihej nga jugu në lumenjtë Devoll e Seman, deri në malësinë e Dukagjinit në veri, nga brigjet e Adriatikut në perëndim deri në Luginën e Drinit të zi në lindje. Por ky shtet nuk përfshinte të gjithë viset shqiptare. Forma e organizimit të shtetit të tij ishte e tipit të "monarkisë feudale" ndërsa ai mbante emrin "zot i Shqipërisë". Si monark nxirrte dekrete për mobilizimin e përgjithshëm të popullsisë, për madhësinë e taksave, të doganave etj. Pranë tij vepronin disa këshilla si këshilli i princërve, këshilli i lartë, këshilli i luftës etj. të cilët i thërriste dhe këshillonte Skënderbeu për probleme të rëndësishme. Skënderbeu kishte të drejtë të konfiskimit të pronave, të drejtën për të gjykuar krimet e rënda si tradhti, spiunazh etj. Shteti i Skënderbeut kishte të gjithë tiparet e shtetit të asaj kohe, edhe pse ishte në luftra të vazhdueshme ai kishte simbolet e veta, flamurin, stemën, vulat, kishte arkën me të ardhurat nga doganat dhe taksat, kishte aparatin administrativ dhe padyshim ushtrinë.

Pushteti i tij ishte i trashëgueshëm. Kështu që gjatë ekspeditave në Itali, pushtetin ai ia la së shoqes kurse kur vdiq pushteti i kaloi të birit Gjon. Me vendimet e Kuvendit të Lezhës u bë një hap i madh dhe vendimtar drejt bashkimit politik të vendit dhe krijimit të një pushteti qendror të përfaqësuar nga Gjergj Kastriot - Skënderbeu, të cilin ai e fuqizoi gjithnjë e më shumë për të bashkuar sa me organikisht shqiptaret e viseve të lira shqiptare. Konsolidimi i Lidhjes së Lezhës në sajë edhe të mbështetjes së fuqishme të popullit liridashës shqiptar i dha Skënderbeut si udhëheqës i saj mundësinë që tu bënte ballë dhe me sukses situatave të vështira të një lufte të gjatë e cila u zhvillua menjëherë në dy fronte gjegjësisht kundër osmanëve dhe Venedikut.


Në Lidhjen e Lezhës u bë i pari bashkim politik në shkallë mbarëshqiptare që njihet në historinë e Shqipërisë. Skënderbeu duke qenë komandant i përgjithshëm, nën udhëheqjen e tij ushtria që ai udhëhoqi u bë tejet e organizuar në mbrojtjen e vendit. Tokat shqiptare për me se 25 vjet mundën tu bënin ballë vërshimeve të njëpasnjëshme dhe betejave masive, bllokadave dhe rrethimeve që organizoi Murati i II-të dhe i biri i Mehmetit të II-të të ashtuquajtur"-pushtues të botës"...

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Dibra, për sakrificat sublime në kohën e Skënderbeut, meriton titullin e lartë NDERI I KOMBIT. A do t'i jepet? Ja disa fakte historike të njohura botërisht...

Skënderbeu *dhe martirizimi i pashoq* **i Dibrës**

...Dëmet që treva dibrane pësoi gjatë fushatave osmane qenë të mëdha. Por sakrificat e pallogaritshme njerëzore dhe materiale ajo i pësoi në vitet 1466-1467, gjatë rrethimit të dytë dhe të tretë të Krujës. Gjatë rrethimit të dytë, në pamundësi për të shtënë në dorë kalanë e Krujës sulltan Mehmeti II shpresoi se do ta thyente rezistencën e Skënderbeut duke asgjësuar bazën njerëzore dhe ekonomike të rezistencës shqiptare. Madje inatin që i shkaktoi sulltanit për të dytën herë Kruja heroike ai e shkarkoi në trevën dibrane...Në korrik të vitit 1466, sulltani marshoi drejt krahinës së Dibrës dhe viseve të tjera të shtetit të Skënderbeut. Kudo ushtritë osmane kryen mizori, plaçkitje, rrënime e djegie, të cilat e detyruan një pjesë të popullsisë të kërkonte strehim në skutat malore...”



Mund të vazhdoj të citoj Kristo Frashërin në “Historia e Dibrës», Kristo Frashërin në “Skënderbeu”, Marin Barletin në “Historia e Skënderbeut...”, Biemin, Volaterranos, dokumentet evropianë, osmanë etj. në të cilët do të na dalë e njëjta tablo, një heroizëm i pashoq i një populli të vogël dhe një sakrificë e pashoqe e po të njëjtit popull që u gri dhe u zhbi nga shpata dhe mërija e perandorisë më të egër të kohës, madje më e egra e të gjitha kohërave.

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Gjergji i Gjon Dibranit (po përdor llagapin e Volaterranus (1434-1516)) njeriut që ka qenë pranë Kastriotëve po aq sa edhe humanisti i madh Marin Barleti) – Gjergj Kastrioti-Skënderbeu është dibran, me rrënjë në Sinë të Dibrës, nuk është as sllav e as “feudal grek i helenizuar mesjetar”...

Kam në dorë veprën “Historia e Dibrës” të historianit të madh të kohës sonë Kristo Frashëri, një rrëfim historik që nuk është thjesht “dibran”, por kombëtar, veçanërisht kur ai lidhet me origjinën e kryetrimit arbër, me 18 nga 25 betejat fitimtare të tij në krye të arbërve në truallin e Dibrës, me trimërinë arbërore por edhe me dhimbjen dhe tragjedinë e trevave ku u zhvilluan betejat dhe ku shpata e pushtuesit otoman preu me qëllim zhbihjejeqafa pleqsh e plakash, burrash e grash, fëmijë në djep...

Betejat e mëdha të kryetrimit shqiptar na qëllon që ti lexojmë në qetësinë e të ndjekurit të një filmikalorësiak, të gjëmimit të tambureve dhe vringëllimit të shpatave pa e vrarë mendjen se çfarë dhimbje sillnin ato, çfarë peshe të jashtëzakonshme mbante mbi shpatulla një popull i vogël në numër dhe një vend në një hapësirë të ngushtë gjeografike.

Tek lexoja Kristo Frashërin (vazhdoj ta lexoj e ta rilexoj, ta nënvizoj e të shkëpus pjesë nga “Historia e Dibrës së tij”) ndjeva trimërinë e pashoqe, dhimbjen e plagëve, kohën në dejet e gjakut tim.

Populli im, të parët e mi, kanë hequr atë që nuk e ka hequr popull tjetër në Evropë, është vgjerë dhe shkrirë si qiriu. Por, për këtë, më mirë t'ia lë penën disa fragmenteve nga dhimbja e madhe përcjellë nga historiani Kristo Frashëri, tashmë dibran po aqsa edhe përmetar.

“Në epopenë skënderbegiane treva dibrane luajti një rol të rëndësishëm nga pikëpamja gjeografike dhe njerëzore. – thekson Ai. Nga pikëpamja gjeografike trevës dibrane, e cila ndodhej në kufijtë lindorë të Shqipërisë së çliruar, i takoi të luante rolin e ledhit për ta mbrojtur vendin nga ushtritë osmane meqenëse në shumë raste ato i turreshin Shqipërisë nga gryka e Radikës ose nga Gryka e Drinit të Zi. Ledhin mbrojtës në këtë sektor e përbënin luftëtarët dibranë me në krye Mojsi Golemin ose siç quhej ndryshe Mojsiu i Dibrës. Gjithashtu nga pikëpamje njerëzore kontributi që dha treva dibrane në mbrojtjen e Shqipërisë së çliruar ka qenë shumë i madh. Sakrificat njerëzore, me të cilat treva dibrane përballoi luftërat mbrojtëse kanë qenë të jashtëzakonshme. Sikurse do të shohim më tej, më 1467 popullsia e trevës ka qenë thellësisht e dhjetuar. Fshatrat e saj qenë rrudhur në shumë pak shtëpi. Dëmet e mëdha që treva dibrane pësoi në ekonomi mund të kuptohen po të kemi parasysh numrin e madh të betejave që janë zhvilluar në këtë trevë dhe taktikën e djegieve, plaçkitjeve, rrëmbimeve që ndiqnin ushtritë osmane, sa herë vërsuleshin kundër Shqipërisë së Çliruar. Veç kësaj, treva dibrane u bë disa herë fushë betejash të përgjakshme. Madje emrat e vendeve dibrane të këtyre betejave si: Torvioll, Sfetigrad, Oranik, Çidhën, Meçad, Vajkal historianët, duke filluar që nga Barleti, i popullarizuan në mbarë Evropën.”

Për historianin Frashëri...”Nuk është rastësi që beteja e parë shqiptare-turke, nga e cila varej në njëfarë shkalle fati i mëtejshëm i Shqipërisë së çliruar, u zhvillua në fushën e Torviollit-një fushë e rrethuar me pyje, në Dibrën e Poshtme, ndoshta në fushën e sotme të Peshkopisë. Ka mundësiqë Skënderbeu ta ketë zgjedhur vetë vendin e betejës (madje këtë e pohon vetë Barleti), mbasi ai e njihte mirë terrenin, njohje kjo që i dha atij mundësinë ta fuste ushtrinë turke të Ali Pashës në kurth. Këtu nuk është vendi për të trajtuar betejat e Skënderbeut, mbasi ata i takojnë historisë së Shqipërisë dhe si të tilla janë trajtuar nëmonografinë kushtuar jetës dhe veprës së Skënderbeut.

Megjithatë këtu nuk është pa vend të vihet në dukje një nga momentet më dramatike për shqiptarët e epopesë skënderbegiane, ku shkëlqen besnikëriae pafund e popullsisë së Shqipërisë së çliruar, përfshirë edhe banorët dibranë, ndaj Heroit. Është fjala për betejën e Ujëbardhës e cila u zhvillua në verën e vitit 1457. Atë vit një ushtri e madhe osmane (sipas burimeve të kohës me 80.000 ushtarë), nën komandën e Isak bej Evrenozit, të cilën e shoqëronte tradhtari Hamza Kastrioti, marshoi kundër Shqipërisë së çliruar. Pasi përshkoi grykën e Radikës armata osmane hyri në trevën dibrane. Këtë na e thotë guvernatori venedikas i Durrësit NarkDiedo. Në raportin që ai i dërgonte senatit të Republikës më 31 korrik 1457 njoftonte se: “Me anën e kësaj letre plot nderim lajmëroj të ndriturin Këthjelltësi tuaj për arritjen e ushtrisë së Turkut, në një vend të quajtur Dibër, vend i të madhërishmit Skënderbej”.

Në Dibër ushtria turke ndeshi një rezistencë të vogël, jo se ushtria shqiptare u thye, por se Skënderbeu u shtir sikur u thye dhe u tërhoq... “...Gjatë kësaj kohe ushtria osmane, pasi kaluan përmes Dibrës e Matit duke kryer plaçkitjet, djegiet dhe mizoritë e tyre të zakonshme dolën në grykën e lumit Mat...”

“...Popullsia dibrane i qëndroi besnike Skënderbeut edhe në vitet e vështira të mëvonshme. Dëmet që treva dibrane pësoi gjatë fushatave të mëvonshme osmane qenë të mëdha. Por sakrificat e pallogaritshme njerëzore dhe materiale ajo i pësoi në vitet 1466-1467, gjatë rrethimit të dytë dhe të tretë të Krujës. Gjatë rrethimit të dytë, në pamundësi për të shtënë në dorë kalanë e Krujës sulltan Mehmeti II shpresoi se do ta thyente rezistencën e Skënderbeut duke asgjësuar bazën njerëzore dhe ekonomike të rezistencës shqiptare. Madje inatin që i shkaktoi sulltanit për të dytën herë Kruja heroike ai e shkarkoi në trevën dibrane... Në korrik të vitit 1466, sulltani marshoi drejt krahinës së Dibrës dhe viseve të tjera të shtetit të Skënderbeut. Kudo ushtritë osmane kryen mizori, plaçkitje, rrënime e djegie, të cilat e detyruan një pjesë të popullsisë të kërkonte strehim në skutat malore...” Fatihu... “Gjatë kthimit të tij kaloi nëpër Dibër dhe në viset e Skënderbeut, në Çidhën ku kreu një masakër të përbindshme-masakroi rreth 8000 shqiptarë (sipas Barletit). G. Biemi thotë: u masakruan 30 mijë burra, gra e fëmijë, midis të cilëve 8 mijë luftëtarë...”

Shqipëria e çliruar, siç e emërton në të gjitha rastet historiani Frashëri, për një çerek shekulli u rrudh deri në palcë në njerëz dhe pësoi shkatërrimin më të madh ekonomik në historinë e saj. Historiani, bazuar në “defterin emëror të hartuar nga administrata osmane (mars 1467) për viset e Dibrës së Epërme, të Dibrës së Poshtme, Gollobordës, Rekës e për vise të tjera” thekson se “mbarë treva dibrane kishte 171 fshatra, nga të cilët 153 ishin me banorë, me gjithsej 1331 familje, kurse 18 fshatra ishin krejtësisht të braktisura. Po të kemi parasysh se në shekullin XV familjet kishin karakter patriarkal, pra çdo familje kishte mesatarisht tetë anëtarë për familje (Pashko Vasa njoftonte më 1879 se në Lurë, e cila bën pjesë në malësinë dibrane, kishte dëgjuar për një familje me 225 anëtarë), si rrjedhim, treva dibrane kishte në kohën e regjistrimit 10.648 banorë. Në se marrim në konsideratë se në fillim të epopesë skënderbegiane fshatrat e trevës dibrane kishin secila 40 familje, me siguri me karakter patriarkal dhe në se pranojmë të njëjtën mesatare prej tetë anëtarësh për çdo familje del se treva dibrane kishte në fillim të viteve ’40- të 54.720 banorë. “

Mund të vazhdoj të citoj Kristo Frashërin në “Historia e Dibrës”, Kristo Frashërin në “Skënderbeu”, Marin Barletin në “Historia e Skënderbeut...”, Biemin, Volaterranos, dokumentet evropianë, osmanë etj. në të cilët do të na dalë e njëjta tablo, një heroizëm i pashoq i një populli të vogël dhe një sakrificë e pashoqe e po të njëjtit popull që u gri dhe u zhbi nga shpata dhe mërija e perandorisë më të egër të kohës, madje më e egra e të gjitha kohërave.

Kjo, pikërisht kjo, e zbehtë nga shumë studiues, një trevë që u dogj e u përvëlua sa asnjë trevë tjetër në hapësirën gjeografike shqiptare...

Mbase, për sakrificat e jashtëzakonshme, është koha që Dibra të shpallet “Nder i Kombit”

Bëj pajtimin tënd me PayPal
përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Rruga e Arbërit nr. 151

portret

Çdo dibran, kudo që ndodhet, ta ngrejë më lart emrin e Dibrës dhe të dibranëve, përmes veprave me vlerë, që në thelb të kenë bujarinë dhe humanizmin, dijen dhe shkencën. Ne kemi vlera. T'i ruajmë pra ato, të mos i humbasim. Vetëm kështu mund ta nderojmë Dibrën.

Liman Hoxha

jo vetëm sukses, por edhe vlerë për të tjerët

Nga **Shaqir SKARRA**

Çdo njoh që herët, qysh në kohën kur jetoja në fshat e me Liman Hoxhën na ndante thjeshtë një përrua, një përrua i urtë dhe i dobishëm për fshatarët në verë, por në dimër egërsohej e merrte përpara drurë e shkëmbinj, të cilat përfundonin në lumin Drini i Zi.

Limani atëherë ishte djalë i ri, plot ëndrra për jetën nga më të ndryshmet. Në fillim kërkonte të arsimohej, por edhe pse me nota të mira nuk ishte kaq e lehtë. E drejta e studimit vinte me planifikim e një në familje e kishte të arsimuar. Fshati i lindjes ishte i vogël e ambiciet për të ishin të mëdha, nuk mund ti realizonte të gjitha këtu, ndaj familjarisht e së bashku me vëllezërit lëvizi drejt Tiranës qysh në vitin 1989. Kjo ishte një lëvizje e kujdesshme, por e mirë menduar.

Pas viteve nëntëdhjetë telat me gjemba u këputën e kloni nuk ekzistonte më. Askush nuk e pengonte Liman Hoxhën të çante dete e oqeane, të ecte nëpër botë, të punonte edhe si emigrant.

Rruga ishte çelur e Limani u bashkua me karvanin e madh të emigrantëve që kërkonin jetesën ndryshe. Punoi shumë, fitoi mirë dhe përsëri u kthye pranë familjes, pranë prindërve e vëllezërve.

Priste me ditë e net të tëra tani që u kthye nga migrimi për ëndrrën e kahershme , dëshirën por dhe amanetin e babait të tij Vexhiut ta bënte realitet. Dhe në fakt Limani si njeri kurajoz, i vendosur dhe me guxim e iniciativë bëri atë që askush nuk pretendonte ta realizonte në ato vite.

Mundin, djersën dhe sakrificën derdhur vite me radhë udhëve të botës filloi ta investoi në fushën e arsimit. Kjo ishte një sipërmarrje e vështirë ku risku i humbjes ishte i pranishëm kudo megjithatë Liman Hoxha nuk tërhiqej lehtë nga ato që kërkonte të realizonte.

Kishin kaluar vite të tëra që atëherë kur etja e dibranëve për t'u arsimuar u kurorëzua me sukses falë hapjes së shkollës së Kastriotit më 1924, shkollë kjo në ato vite me konvikt, ndaj dhe u quajt Internati i Kastriotit. Nga bangat e kësaj shkolle dolën shumë personalitete të shquara të kombit shqiptar në fusha të ndryshme si në politikë, shkenca, arsim, inxhinieri, mjekësi, art, ushtri e plot degë të tjera. Limani kishte dijeni për të mirat dhe dobitë që solli kjo shkollë në Kastriot në ato vite. Kishte takuar e biseduar shpesh herë me ish nxënës të asaj shkolle, me mësues që kishin dalë nga bangot e asaj shkolle. Por më kryesore kishte në shtëpi Vexhiun, babain e tij i cili e kishte përfunduar me nota të mira shkollën e Kastriotit dhe kishte qenë në një bangë me aktoren e njohur Besa Imami. Ndaj kur ishin bashkë djemtë shpesh herë u thoshte" kush ndërton një shkollë ka ndërtuar një xhami" pasi Vexhiu kishte edhe mjaft kulturë fetare dhe ishte një besimtar i devotshëm.



E nisi Liman Hoxha rrugëtimin e shkollës jo publike "Sarina 2002" me 53 nxënës gjithsej e me ambiente të pakta afro 240 metra katror. Sivjet janë regjistruar shtatëqind nxënës. Janë diplomuar mbi njëmijë veta ku dikush është bërë kuadro e dikush punon e drejton në sektor të ndryshëm të ekonomisë. Janë gjithsej 3000 metra katror por edhe 3000 metra të tjera presin të ndërtohen aty ku do të hapet shkolla profesionale.

Megjithatë Limani në fillim kur sapo u kthye nga emigrimi do të merrej me tregti por kjo punë e shikonte se nuk i përshtatej shumë.

Një natë tek ishin mbledhur të gjithë vëllezërit së bashku u shprehu dëshirën dhe amanetin e babait: "Ne jemi një familje arsimdashëse. Kjo zonë ku banojmë ka nevojë për një shkollë, një shkollë të mirë që të bëjë emër si shkolla e Kastriotit dikur.

Limani pasi mori edhe miratimin e vëllezërve, me dokumentacionin e nevojshëm me vete një mëngjes u drejtua tek Ministria e Arsimit, ku vetë titullari e priti me dashamirësi dhe i premtoi gjithë mbështetjen e dikasterit.

Hapja e shkollës jo publike "Sarina 2002" u bë realitet pasi kishte vdekur Vexhi Hoxha, por amanetin e tij Limani e çoj në vend.

Po kush është në fakt Liman Hoxha, ky njeri vital që çdo gjë e nisi në fillim me pak por gjithmonë duke ëndërruar për shumë?.

Ka lindur në fshatin Blliçe më 1966, në një familje me dije dhe kulturë, nga e cila ka përfituar shumë dhe Limani. Në vitin 1989 mbaron Shkollën e Mesme "Myslim Shyri" në Fushë-Çidhën dhe po në këtë vit shpërngulen familjarisht për në Tiranë.

Në vitin 1989-1990 mbaron kursin e Ushqimit në Tiranë. Më 1990-1993 punon në Gardën e Republikës së Shqipërisë. Pas kësaj kohe është marrë me tregti, duke qenë mjaft i suksesshëm. Në vitin 1999 emigron në Angli për t'u kthyer në atdhe në vitin 2001 dhe në vitin 2002 hapi dyert shkolla jo publike "Sarina 2002".Përfundon Universitetin Bujqësor të Tiranës, dega ekonomi-financë. Është i martuar dhe ka dy vajza dhe një djalë, Sarën, Rominën dhe Samelin. Janë pra bashkimi i germave të fëmijëve të tij, që është emërtuar shkolla"Sarina", një emër tashmë që ka krijuar identitetin e saj. Ndërtimi i një vepre të tillë nuk erdhi fare rastësisht. Ende në shtëpinë e tij vazhdojnë të qëndrojnë librat që lexonte në ato vite Vexhiu, një bibliotekë e vogël por me libra të rrallë si fetarë ashtu edhe histori, letërsi e shkencor.

Edukatën, dijen dhe kulturën që kishte përfituar në Internatin e Kastriotit Vexhi Hoxha, bëri të mundur që ndjenjën për arsim e dije ta kultivonte edhe tek djemtë e tij, të cilët vite më vonë të gjithë u diplomuan në degë të ndryshme.

Limani në fillim e nisi me një kopësht, pastaj hapi shkollën jo publike "Sarina 2002", me një emër tepër njerëzor, duke bashkuar germat e fëmijëve të tij dhe tashmë ka hapur dhe shkollën e mesme të përgjithshme, të profilizuar.

E ardhmja do të flasë krejt ndryshe. Limani tashmë ka ambicie në fushën e arsimit. Megjithëse investimi në arsim është një biznes human, elitar, Limani është i bindur se duke investuar bindshëm në arsim, bëhet më i dobishëm për Dibrën dhe dibranët.

"Do të hap dhe një Universitet, shkollë profesionale dy vjeçare ku fëmijët sapo të mbarojnë maturën ato që duan të zgjedhin mund të vazhdojnë shkollën profesionale brenda kësaj shkolle. Unë djalë Dibre jam dhe do ta hap në metropolin shqiptar. Kjo do të bëhet realitet shumë shpejt". Dhe Liman Hoxha si njeri me vullnet dhe kurajo nuk ka dështuar asnjëherë.

U deshën të kalonin plot 78 vite që nga ajo datë e shënuar kur hodhi bazat e para arsimi shqip në Kastriot e Liman Hoxha, një pinjoll i një familje të mirë, të njohur, atdhetare, patriotike e arsimdashëse do të përsëriste të njëjtën gjë, por tashmë jo në Kastriot, as në fshatin e tij të lindjes në Blliçe por pikërisht në kryeqytetin shqiptar, ku ka edhe një komunitet të madh dibranësh. Madje, ky 40-vjeçar atëherë nga fshati Blliçe, jo shumë larg fshatit Kastriot, ku u ndërtua Internati, ishte i pari biznesmen nga trevat tona, që hapi një shkollë të tillë në Tiranë.

E nisi Liman Hoxha rrugëtimin e shkollës jo publike "Sarina 2002" me 53 nxënës gjithsej e me ambiente të pakta afro 240 metra katror. Në fillim ishin gjithsej gjashtë mësues, ku drejtoreshë ishte Rudina Maksuti e nëndrejtor Mentor Hoxha.

Sot është një realitet krejt ndryshe: Kanë kaluar dhjetë matura nga shkolla "Sarina" . Sivjet janë regjistruar shtatëqind nxënës nga 53 që ishin në vitin e parë kur u themelua shkolla. Janë diplomuar mbi njëmijë veta ku dikush është bërë kuadro e dikush punon e drejton në sektor të ndryshëm të ekonomisë. Nuk janë më 240 metra katror mjedise mësimi, studimi e kënde lojërash por janë gjithsej 3000 metra katror por edhe 3000 metra të tjera presin të ndërtohen godina shkolle aty ku do të hapet shkolla profesionale. Nuk janë më 6 mësues por janë 45 mësues, të gjithë të kualifikuar që e zotërojnë mirë lëndën e tyre dhe askush nuk mund të futet mësues në shkollën "Sarina" pa përfunduar provimin e shtetit . Janë mbi 45 të tjerë punonjës ndihmës si shofer furgoni, meremetues, roje, sanitare, kuzhiniere etj.. Nga viti në vit mesatarja e notës në shkollën "Sarina" ka ardhur në rritje, kjo falë mësimdhënies së kualifikuar por edhe disiplinës në shkollë.

"Nuk pretendoj se këto rezultate i kam arritur vetëm, thotë Limani.

Jo! E gjitha kjo është bërë në saj të punës së madhe dhe vërtet kualifikuese të kolektivit mësimdhënës, të cilët jo vetëm që më kanë qëndruar pranë, por kanë bërë të pamundurën që shkolla jonë të kishte vërtet rezultate. Dhe rezultatet në shkollën tonë kanë qenë nga viti në vit në rritje". Limani zakonisht flet pak, por sot foli më shumë, foli për shokët, mësuesit e më pak për vete.

Në shkollën e mesme, për çdo klasë, nga e dyta deri në të tretën, ka nga tri paralele, kurse në klasat e para ka katër paralele, çka tregon se interesi për të ndjekur këtë shkollë vjen vazhdimisht duke u rritur. Shkolla jonë asnjëherë nuk ka pasur nevojë për reklama, por të interesuarit e kanë kërkuar dhe e kanë gjetur vetë "Sarinën". Duke parë këtë dinamikë të rritjes së numrit të nxënësve nga viti në vit, ne pretendojmë se së shpejti do të bëhemi një ndër shkollat më të mëdha në të gjithë Qarkun e Tiranës.

E megjithatë, Limani si administrator i kësaj shkolle ende ka ambicie, ende kërkon nga vetja, ende premton për më shumë, se i tillë është Liman Hoxha, njeri kurajoz dhe me guxim e iniciativë të madhe.

Karakteri i njeriut formohet e forcohet në përpjekje për të arritur gjithmonë më të mirën, duke u kacafytur shpesh me të keqen e cila ka për detyrë "të zërë rrugën", të të mundojë e të të lodhë shumë që ti në fakt të dorëzohesh shpejt. Në fakt krejt ndryshe ndodhi me Limanin, nuk ishte i tillë, nuk dorëzohej përballë vështirësive sado të mëdha të ishin ata.

Liman Hoxha u njoh mirë me jetën, me uljet e ngritjet e saj, me të fshehta dhe labirintet e



cyan magenta yelloë black





SARINA 2002

Më shumë se një zgjidhje...

Liman Hoxha është krenar për veprat e mëdha të dibranëve. Duke qenë se është shumë i pasionuar pas historisë së Shqipërisë dhe veçanërisht pas historisë së popullit të Dibrës, ai ndjehet tepër i lumtur për ata që kanë lënë paraardhësit e tij, por ai dëshiron që brezat e nesërm të krenohen me veprat që do të lëmë ne sot. Ndaj, mesazhi i tij është: "Çdo dibran, kudo që ndodhet ta ngrejë më lart emrin e Dibrës dhe të dibranëve, përmes veprave me vlerë që në thelb të kenë bujarinë dhe humanizmin, dijen dhe shkencën. Mjaft dibranë kanë bërë emër edhe jashtë trojeve tona. Ne kemi vlera. T'i ruajmë pra ato, të mos i humbasim. Vetëm kështu mund ta nderojmë Dibrën".

biznesit duke e filluar atë nga hiçi për të arritur më vonë shumë në formimin e tij, do t'i falnin "mëvetësinë" për të ndërmarrë më pas veprime që në fund të fundit do të ishin si një shtrëngatë për t'i dhënë vetë jetës drejtimin e duhur. Limani ka punuar dhe vazhdon gjithmonë me ekip, me kolektivin e mësuesve ku edhe ai mëson nga ata por dhe vetë mësuesit mësojnë nga Limani. "Askush s'është më i zgjuar se të gjithë së bashku" Limani e di mirë këtë dhe puna në ekip e ka ndihmuar të arrijë aty ku është ngjitur sot.

Gjërat më të bukura apo ato që të dëshpërojnë në jetë nuk mund të dëgjohen, të shihen ,as të preken. Ato vetëm mund të ndjehen. Liman Hoxha në kujtimet e tij mbajtur ndër vite hedh dritë jo vetëm për vete por edhe për familjen, për të afërmit, për fisin por edhe për të gjithë atë brez të sakrifikuar i cili nuk ka lënë shteg për të bërë qortimin më pak të rëndësishëm, për tu kërkuar llogari për ndonjë mangësi, qoftë edhe formale, në drejtim të ndonjë detyrimi që nuk e ka kryer dot si duhet. Përkundrazi ai dhe brezi i tij përjetuan kohëra shumë të vështira por që në fund të fundit ato që deshën të mbesin njerëz përsëri njerëz mbetën.

Karakter në gjëra të vogla apo mëdha do të thotë të marrësh përsipër ato gjëra që ti ndjehesh i zoti ti bësh. Shkolla "Sarina 2002", me administrator Liman Hoxhën, është një shkollë me të gjitha parametrat e kohës. Për vitin shkollor 2018-2019 janë ulur në bangat e kësaj shkolle afro shtatëqind nxënës duke filluar që nga kopshti, para shkollorët e deri në vitin e tretë të gjimnazit. Në saj të punës së madhe vetëmohuese të administratorit Liman Hoxha këtu nuk mungon asgjë duke filluar që nga uniforma, transporti i nxënësve, ushqimi e mësimdhënia, e cila në saj të mësuesve të kualifikuar është në nivele të larta që edhe mjaft shkolla të tjera qoftë publike, qoftë jo publike do ta kishin zili. Që kur e ngriti për herë të parë shkollën "Sarina" Liman Hoxha ndoqi parimin:"Merr më të mirën nga më të mirët" dhe në këtë drejtim nuk gaboi.

Liman Hoxha sot është edhe vetë koshient se edhe pse kishte ambicie nuk do ta besonte se do të ngjitej shkolla e tij kaq lart por ai kurrë nuk u dorëzua përballë vështirësive që hasi gjatë periudhës pesëmbëdhjetë vjeçare. Të investosh në fushën e dijes dhe arsimit është një biznes elitar dhe këtë e di mirë Limani por Limani nuk u dorëzua përballë humbjeve në vitet e para, përkundrazi i jepte forca vetes për të arritur aty ku vërtet është sot. Qëllimi i tij në jetë ka qenë gjithmonë që të investonte për të ardhmen dhe jo për të sotmen, të linte diçka të mirë dhe bukur dhe e ka realizuar plotësisht këtë ëndërr të kahershme.

Në atë që po mundohem të shkruaj dëshiroj të nxjerr në dritë jetën e një njeriu me kontribut të gjatë në fushën e dijes dhe arsimit, në të mirë të vendit, të zhvillimit dhe të emancipimit të shoqërisë, të dibranit Liman Hoxha. Nuk besoj se do të arrij ti them të gjitha, pasi e gjithë jeta dhe puna e tij është shumë, është një jetë njeriu pasi ai vërtet ka bërë shumë sa që edhe ato "kovat me dhe" që ngriti malin e tij sot e kemi tepër të vështirë që ti a numërojmë.

Je i virtytshëm kur ndërmarrjen e guximshme e bën vetiu e jo kur ta kërkojnë të tjerët. Në jetën me plot ngjarje të lakmueshme të Liman Hoxhës, gjen njeriun e bindur për të kryer veprime të guximshme, pa e ditur se ai ato i bën nën trysninë e ndërgjegjes së pastër dhe të njeriut idealist.



Jeta ka provuar se ai që shpërfill mundimin, vuajtjet, përgjithësisht sakrificën për të arritur diçka të virtytshme, në fund ndjehet i lumtur dhe i plotësuar në shpirt e në ndërgjegje. Liman Hoxha i ngjan pa dyshim i ngjan, është "binjak" me çdo njeri që i ngjit shkallët e karrierës me urtësi, duke e konsideruar pozicionin apo një detyrë të lartë qoftë partie, qoftë administrative si një premtim të mundimit për të arritur deri aty.

Falë guximit dhe iniciativës së Limanit e nisi udhën e saj shkolla jo publike "Sarina 2002", e nisi në një kohë kur në një kohë shumë veta e kishin kaluar hendekun e thepisur të biznesit dhe po arrinin majat, kurse shkolla "Sarina" ishte ende një foshnjë e sapo lindur, pa tendera e dallavere të kësaj natyre por Limani si administrator i saj i vetëm nuk i njihte mirë labirintet e biznesit, të fshehtat e tij, humbjet dhe fitimet por ai e pranoi riskun si do që ti vinte dhe filloi të investojë në fushën e dijes dhe arsimit, biznes ky elitar. Limani nuk kërkonte të mbushte xhepat me para të pa merituara por kërkonte të mbushte mendjet e brezit që po rritej, dhe këtu nuk kishte humbur, por në fakt kishte fituar.

Shkolla "Sarina 2002" ishte e para shkollë që hapej në një zone periferike të Tiranës por që shumë shpejt do të krijonte identitetin e saj dhe do të turreshin edhe nga qendra e nga të gjitha anët për të mbushur klasat e kësaj shkolle të sapo hapur në Tiranë.

Çfarë ishte ajo magji që bëri për Liman Hoxhën për të komanduar, për të drejtuar, për tu dhënë mend të tjerëve, të rinjve e të rejave , arsimtarëve. Por në fakt ai e kishte një magji. Madje shumë të sigurt për ta quajtur investim të së ardhmes, të jetës së tij si njeri me ambicie e që një ditë të mos skuqej nga turpi i qortimit të njeriut me sedër të pastër qelibar.

"Magjia" e Liman Hoxhës është intelekti i tij, është fakti që padijen e konsideron mjerim dhe që si mbështetje të pazëvendësueshme ka kështillimin për gjithçka e me gjithë këndë. Këshillim të cilin ua "lyp" njerëzve me përvojë, kuadrove të rrahur me vaj e me uthull në shkollën e punës dhe jetës, kolektivit mësimdhënës.. Nga kjo pikëpamje , ai nuk tregohet qibar, në mos ndjehet edhe i përulur për të mësuar e përfituar nga kushdo që shfaq ide e praktika të dobishme.

Çdo gjë e mbush enën ku hidhet diçka, ishte bindja e tij e pa tundur, përveç dijes që hap vend tjetër për tjetër dije. Ai këtë sentencë e ka dhe e konsideron të parën, pa të cilën nuk mund të ndërmerrte veprime që kërkonin mposhtje "turpin" kur ishte fjala për të ngritur nivelin arsimor, për tu bërë i zoti i vetes. Dhe "turpi" që mund të bënte ky djalë i ri me pretendime për jetën ishte vijimi i shkollës me vullnet dhe sakrifica të mëdha të cilën e përfundoi me rezultate të larta.

Lakmia e njeriut për pushtet, apo për çdo gjë tjetër kthehet në të kundërtën e saj, të "mbyt" përpara se ky "zjarr" të të fashitet. Liman Hoxha për shkak të karakterit të tij dhe sedrës për të qenë kokë ulur e gjithmonë shembullor për detyrën e ngarkuar, nuk u duk qoftë edhe njëherë të vetme lakmitar e karrierist për të kapur poste që ai e gjykonte se nuk i meritonte dhe ofertat nuk i mungonin por ai brenda për brenda oborrit të shkollës nuk i pa bindjen politike dhe partiake të askujt, as të tij por zgjodhi dhe punoi me njerëz profesionist me qëllim që arsimi të arrinte vërtet majat, të arrinte atë që kishte lënë pa realizuar dikur shkolla e Kastritotit.

Kur njeriu e di se sa e gjatë është udha, dhe kur e çmon se jeta është e vështirë për të dalë faqebardhë në krye të saj, duhet të jetë përherë i përgatitur. Përvoja njerëzore ka çimentuar dhe dhënë prova se punët e vogla janë më me vlerë se punët e mëdha. Kur gjykojmë rreth aftësive drejtuese e organizuese të Liman Hoxhës , të mençurisë së tij, për zgjidhjen e problemeve të shumta që i dalin vazhdimisht përpara, të shumta e të komplikuara, me urtësinë që e karakterizonte ai dinte që ti zgjidhte të gjitha e t'ju jepte udhë. E vetmja mënyrë për të bërë punë të dobishme, ndoshta jo të mëdha, por që të jenë të mirë pritura nga njerëzit, është që ta duash atë që bën dhe të lodhesh e të sakrifikosh për të arritur gjithçka. Limani i bëri dhe vazhdon ti bëjë të gjitha punët me shpirt dhe zemër. Ai u tregua kaq i aftë sa investoi që të ishte jo vetëm një sukses, por të qëndronte gjithmonë edhe një vlerë për të gjithë.

Është sot një fjalë goje të thuash "ai ka qenë i guximshëm dhe i vendosur qysh kur ka qenë i vogël", por kur "lexon" e gjykon jetën e një personi si të Liman Hoxhës, njeriu qëndron për një çast dhe i thotë vetes: ky paska qenë i vendosur për të mbetur nga fillimi deri në fund të jetës së tij njeri i përunjur ndaj të vërtetës dhe i mirësisë njerëzore. Të gjithë ata që e njohin dhe që e kanë njohur Liman Hoxhën, flasin me plot respekt për të. Por ajo që ajo që zotëron tërë qenien e tij është guximi dhe iniciativa 'e çmendur' për të ndërmarrë iniciativa të mëdha, që për shumë njerëz dukeshin ëndrra të parealizuara .

E me gjithë këto rezultate të larta dhe arritje në kaq vite që ka hapur dhe është administrator i shkollës jo publike "Sarina 2002" edhe Limani ka dy pengje që ende i rëndojnë në shpirt. Babai i tij i mirë, Vexhiu vdiq në vitin 2000, po kështu edhe vëllai i tij, Ramazani, intelektuali i kompletuar dhe kuadri më i vlerësuar në të gjithë Dibrën vdiq në vitin 2001 nga një aksident. Të dy nuk mundën ta shikonin shkollën "Sarina" si nisi dhe ku ka arritur. Dhe ndodh shpesh në biseda të ndryshme me miq e shokë kur bisedon, Limanin ende e tradhtojnë sytë, por sido qoftë ai është i bindur se gjithmonë do të punojë me përkushtim të madh që shkolla "Sarina 2002" të mbetet elitë ndër të gjitha shkollat e Qarkut të Tiranës.

Liman Hoxha është krenar për veprat e mëdha të dibranëve. Duke qenë se është shumë i pasionuar pas historisë së Shqipërisë dhe veçanërisht pas historisë së popullit të Dibrës, ai ndjehet tepër i lumtur për ata që kanë lënë paraardhësit e tij, por ai dëshiron që brezat e nesërm të krenohen me veprat që do të lëmë ne sot. Ndaj, mesazhi i tij është: "Çdo dibran, kudo që ndodhet, ta ngrejë më lart emrin e Dibrës dhe të dibranëve, përmes veprave me vlerë, që në thelb të kenë bujarinë dhe humanizmin, dijen dhe shkencën. Mjaft dibranë kanë bërë emër edhe jashtë trojeve tona. Ne kemi vlera. T'i ruajmë pra ato, të mos i humbasim. Vetëm kështu mund ta nderojmë Dibrën".

Rruga e Arbërit nr. 151

Çdo vit zjarret dëmtojnë miliona hektarë të lëndës drusore me vlerë, produkte të tjera pyjore, shkatërrojnë shërbimet mjedisore dhe turistike të siguruara nga ekosistemet pyjore.

Zjarret në pyje, *si të bashkëveprojmë për t'i parandaluar*

Nga **Osman XHILI**

Njerëzit dhe pyjet kanë qenë e janë aleatë të përhershëm, ndoshta që nga koha e krijimit të botës, si një binom i pandashëm. Në këtë rrugëtim të gjatë e të përbashkët, ka qenë dhe mbetet detyrë e njerëzimit të shtojë kujdesin për ruajtjen dhe menaxhimin e pyjeve. Mbjellja e fidanëve të rinj, mosprerja pa kriter dhe parandalimi i zjarreve në pyje, do të ishin tre pikat më të forta për të mbajtur dhe forcuar këtë aleancë të lashtë sa vetë jeta.

Çdo vit zjarret dëmtojnë miliona hektarë të lëndës drusore me vlerë, produkte të tjera pyjore , shkatërrojnë shërbimet mjedisore dhe turistike të siguruara nga ekosistemet pyjore. Humbja e jetëve njerëzore, shtëpive, ndërtesave të tjera, rrugëve, tokës së fermës dhe pemëve frutore, si dhe habitateve, përbejnë vërtet një dëm kolosal dhe vështirësisht të riparueshëm. Kur gjithë kësaj fature fatkeqësish dhe me një kosto shumë të lartë i shtohet erozioni masiv i tokës, si dhe emetimi i gazit karbonik në ajër, pasojat bëhen të pallogaritshme dhe situatat dalin krejt jashtë kontrollit. Zjarret nuk njohin as kufinj mes shteteve mes bashkive, as mes pronës shtetërore dhe asaj private.

Sa për të zgjuar pak kujtesën do të hidhemi vetëm dy tre muaj pas në kohë, në rajonin e Atikës së Athinës, në Greqinë fqinje, ku një zjarr masiv mori njëqind jetë njerëzore, pa hyrë në llogari të tjera. Normalisht dhe vendi ynë e qarku i Dibrës janë prekur hera herës nga zjarre që kanë bërë dëme të shumta. Bekim Qosja, përgjegjës i qarkut të Dibrës për Zonat e Mbrojtura , tregon se më problematikë kanë qenë zjarret e periudhës 2007 - 2012, në zonën e Selishtës, Lurës, Prat, apo diku tjetër. Vitin e kaluar zjarret kanë qenë më të pakta, më të dukshme në Sllatinë dhe Kërçisht, por akoma më pak ka pasur këtë vit, një ogur i mirë për të gjithë ne, merremi apo jo direkt me pyjet.

Po cilat janë masat mbrojtëse kundër zjarreve të pyjeve? Durim Kaba, inxhinieri i



pasionuar i pyjeve thotë se hapi i parë dhe vendimtar në menaxhimin e zjarreve të pyjeve, është identifikimi i atyre parametrave që mundësojnë vlerësimin e rritjes së propabilitetit të zjarrit. Të gjitha masat e marra në parandalimin dhe luftimin e zjarreve, sipas kohës që janë ndërmarrë dhe synimit të tyre ndahen në: masa parandaluese, përgatitore dhe lokalizimit e shuarjes.

Masat parandaluese janë të gjitha ata masa që merren vazhdimisht, gjatë tërë vitit dhe ju drejtohen totalisht njerëzve. Qëllimi i tyre final është të parandalojnë shfaqjen e zjarreve dhe kjo bazuar në një nga postulatet e mjekësisë, që thotë më mirë ta parandalosh sëmundjen, se sa ta mjekosh atë.

Po ti shohim për nga karakteri dhe aplikimi i tyre, do të mund ti gruponim në: masa ligjore, masa edukative dhe masa informative – propagandistike.

Masat ligjore shihen si shumë të rëndësishme. Shteti shqiptar i adreson këto çeshtje në Kushtetutë, me ligje dhe akte nënligjore. Meqë pyjet janë një thesar kombëtar, të gjithë qytetarët janë përgjegjës për parandalimin e zjarreve. Si ligje mjaft të rëndësishëm mund të përmendim: "Për emergjencat civile", "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", " Për pyjet dhe shërbimin pyjor", apo " Për vetëqeverisjen vendore".

Masat edukative janë ato që përfshijnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e njerëzve, në të gjitha grupmoshat. Ato mund të jenë në formë leksionesh të ndryshme, media elektronike dhe e shkruar, apo në formë broshurash e librash të ilustruara me fotografi.

Masat informative – propaganduese, mund të zbatohen dhe kombinohen dhe me grupin e dytë, që përmendëm më sipër. Ky grup masash konsiston në:

- Vendosjen e shenjave në vendet e dukshme, që kanë të bëjnë me ndalimin e ndezjes së zjarrit.
- Organizimi i takimeve dhe bisedave informative me grupe të ndryshme njerëzish të tillë si, barinj, fermerë, biznese, turistë, apo kategori të tjera.

Për të pasur një ndikim sa më të fuqishëm duhet të synojmë njerëzit e duhur, të përcjellim mesazhin e duhur, të gjejmë kohën e duhur për mesazhin dhe të përdorim mjetin e duhur për këtë qëllim.

Metodat për të shuar një zjarr janë të shumta, si ajo me anë të dheut, me anë të ujit, me substanca kimike, me eksploziv, por gjithsesi më klasikja dhe më e përdorshme është ajo me anë të ujit.

Padyshim të gjitha këto masa që përmendëm nuk mund të jetësohen e të vihen në zbatim nëse nuk ka një përfshirje masive të komunitetit dhe fuqizim të rolit të bashkive, si organe të qeverisjes vendore. Bashkitë përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme shtetërore, për administrimin e pyjeve dhe kullotave.

Ka kohë që bashkia e Dibrës është përpjekur ta vendosë këtë problem në shina të sigurta. Në drejtorinë e bujqësisë që funksionon pranë këtij institucioni, është krijuar një sektor që menaxhon pyjet bashkiakë. Përgjegjësi i këtij sektori, inxhinier Vullnet Tafa, tregon se në shumë njësi administrative, janë vënë punonjës specialistë për të vëzhguar, koordinuar dhe sensibilizuar problemet e sektorit pyjor. Ata, si sektor dhe si bashki, janë të hapur për bashkëpunime dhe projekte shtetërore, apo me organizata të huaja. Vetëm nëse bëhen bashkë të gjithë faktorët njerëzorë dhe vlerësohen të gjitha hallkat e zinxhirit në mbrojtjen nga zjarret në pyje, jeta jonë do të jetë më e qetë, më e sigurtë, me më shumë oksigjen në mushkëritë tona dhe me më shumë sipërfaqe të gjelbërta.

Përkujtohet rikthimi i Skënderbeut nga Nishi në Dibër

vijon nga faqja 7

"Skënderbeu, - ritheksoj Zoto - hodhi parimet e mobilizimit dhe të zbulimit strategjik. Ai na dha modelin e llojeve të ndryshme të luftimit që ju kanë rezistuar edhe kohëve moderne. Sepse Skënderbeu vuri emrin e tij në themelet e Artit Ushtarak, ndaj dhe u vlerësua në shkallë botërore, sidomos për veçorinë se "zbatoi strategji dhe taktika të avancuara të kohës në kushtet konkrete të gjendjes dhe të mjedisit të vendit tonë. Kjo arsye, Skënderbeu ishte dhe mbetet ndër personalitetet më larta si burrë shteti dhe Komandant i Përgjithshëm i kombit shqiptarë në çerek shekullin e luftërave që zhvillojë".

Aziz Keta, mbasi vlerësoi veprat e shumë studiueseve dibranë që ishin të pranishëm në këtë sesion, kërkoj mirëkuptimin e tyre kur ishte fjala për histori që lidhen me Skënderbeun. Sepse nuk duhej të ngatërronim dimensionin kombëtar dhe europian të Skënderbeut me dëshirat folklorike për ta pas Skënderbeun, jo vetëm me vendlindje në Dibër të Poshtme, por edhe me lokalizim betejash.

Tendenca e disa krijueseve dibranë për ta lokalizuar Skënderbeun edhe me beteja mundësisht në "katundin tim" ose sa më afër " katundit tim" më duket e tepruar dhe shumë e dëmshme.

Pse kjo nuk duhet të ndodhë?

Sepse e rrudhim Skënderbeun nga hero Kombëtar dhe europian që ishte, në hero provincial. Por nuk është vetëm kjo. Duke e prurë Skënderbeun me çdo kusht edhe me beteja në Dibër të Poshtme dhe përjashtojmë mundësinë e lokalizimit të betejave edhe në Maqedoninë shqiptare ku ka burime historike, ose, i heqim Skënderbeut Prizrenin si qendër administrative, ju vijmë në ndihmë pa dashje të huajve që mohojnë Skënderbeun, jo vetëm si kombësi por edhe me beteja në territore të Shqipërisë së vërtetë.

Në aspektin logjistik, nuk duhet të banal-



izojmë sikur Skënderbeu paska luftuar vetëm me gurë që i rrokulliste nga mali dhe me shpatë e topuz. As mos të mohojmë ndihmën e faktorit ndërkombëtar, që mund të mos ishte aq sa duhej, por as nuk mungojë. Sepse ka burime pa fund edhe në botimet e fundit, që të huajt erdhën në ndihmë të Skënderbeut me flori, burime njerëzore, me topa e armë të tjera, me specialist për ndërtim kështjellash, me ushqime dhe veshje, deri dhe mbështetja me flotë, sepse lufta e Skënderbeut, ishte dhe mbrojtje për ta.

Përsërisim: Ishte faktori i brendshëm përcaktues edhe në burime logjistike që përballuam luftën 25 vjeçare, por as faktori jashtëm nuk ishte për t'u mohuar. Nëse e mohojmë këtë faktor, vështirë të na besoj kush, që Skënderbeu rezistoj 25 vjet vetëm me shpatë e heshtë dhe vetëm me forcat e veta.

Se po të kishim vetëm shpatën, do kishim nevojë vetëm për farka dhe jo për punishte baruti. Dhe nëse nuk do kishim armë zjarri, nuk do kishim nevojë as për hendeqe dhe as për luftë nga lart poshtë në dy betejat e Vajkalit në prill dhe gusht të vitit 1465.

Cila ishte mrekullia logjistike e Skënderbeut?

Ishte Lidhja e Lezhës, ku kontributi me flori dhe me burime njerëzore i Lidhjes, ishte tej çdo parashikimi.

Sepse qysh në fillimet e saj, ishin 200.000 dukatë në arkën e Lidhjes si kontribute të princave.

Ishin këto burime që krijuan mundësinë që Skënderebu, të ishte ndër të parët në Europë, që krijojë ushtrinë me pagesë, rojen kufitare dhe Gardën.

Skënderbeu, arriti këtë bashkim kapitalesh në interes të luftës, sepse ai, i pari e kthej ekonominë e principatës së tij në dobi të mbrojtjes kolektive të gjithë principatave shqiptare.

Ishin kështjellat, kriporet, dogana, rrugët që ai kontrollonte dhe vilte taksa, që u vunë në dispozicion të Lidhjes.

Dhe u bë aq i besueshëm sepse, tre të katërtat e burimeve njerëzore, materiale dhe në valutë që ishin shpenzuar para se të vinim tek Lidhja e Lezhës, ishin siguruar nga Principata e tij, që përfshinte këta kufij administrativë: Krujë, Dibër, Mat dhe Mirditë.

Ky shembull personal i Skënderbeut dha efekte të jashëzakonshme. Nxiti çdo princ për të tejkaluar parashikimet në kontribute ekomomike që ofrojë në dobi të Lidhjes. Sepse Skënderbeu kishte krijuar bindjen edhe tek princat e tjerë:

Pa bashkim ekonomik të kontributeve financiare dhe të burimeve njerëzore, do të ishim të humbur të gjithë.


Shumë interesante ishin të rejat që ofruan në kumtesat e tyre Dr. Zyber Gjoni dhe studiuesit e pasionuar dibranë Ali Hoxha dhe Haki Përnezha.

Kryqëzimi i burimeve historike që ata ofruan, shoqëruar me toponomastikën dhe onomastikën e zonës Çidhnës, që ata e njihnin aq mirë, ishin nga befasitë dhe u dëgjuan me shumë interes.

Analiza kritike që bëri Ali Hoxha ndaj disa autorëve dhe në debate televizive, që i japin Skënderbeut më shumë kontribute fetare se atdhetare, u prit mirë nga pjesëmarrësit.

Kumtesat dhe diskutimet e studiueseve dibranë ndihmuan për të kristalizuar mendime të përbashkëta për çështje të diskutueshme rreth të vërtetave historike që kërkojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe përfaqësuesja e Bashkisë, diskutuan dhe premtuan mbështetje në aktivitetet e ardhshme dhe falënderuan pjesëmarrësit dhe organizatorët.





Rruzhdi Lata ishte një misionar. Ai nuk ishte vetëm Myftiu i Dibrës, por ishte Myftiu i shqiptarëve. Me dashurinë për Zotin ai u shërbeu njerëzve, dibranëve e shqiptarëve, kudo ku ishte dhe kudo ku e kërkuan.

Rruzhdi Lata do të mbahet mend si një ndër të vetmit që e ushqeu dhe e forcoi lidhjen me Tiranën. Angazhimi i tij për lobimin për ndërtimin e Rrugës së Arbërit ishte i fuqishëm, sa në Tiranë aq edhe në Shkup.

Rruzhdi Lata e donte Dibrën pa kufij

E donte Shqipërinë e Kosovën. I donte shqiptarët pa dallim.

Nga **MUSA RIÇKU**

Rruzhdi Latën e kam njohur në vitin 1992. Ishte kohë që ai jetonte mes Prishtinës e Dibrës. Ai jepte ligjërata në Universitetin e Prishtinës në fakultetin e Orientalistikës, por jo në mjedise auditoresh, por në një shtëpi private. Pashë në sytë e tij dhe ndjeva në fjalën e tij se Dibrën e kishte në zemër.

Ajo që na afroi e na miqësoi ishte besimi.Pas atij takimi, shumë shpejt u kthyer në Dibër dhe prej atëherë jemi takuar vazhdimisht. Ndarja e tij nga kjo botë ishte e parakohshme, bash në kohën kur puna dhe angazhimi i tij fetar, politik e shtetar po jeptë frytet e veta. Tashmë këto arritje do t'i shohë nga Xhehneti.

Në vitin 2008, babai im, Hazizi, u takua në Tiranë me Myftiun e Dibrës. Ndenjën gjatë dhe biseduan. Kur shkuam në shtëpi, më tha: "Sot kam njohur besimtarin që, kur fliste, ishte i lidhur direkt me Zotin".

Rruzhdi Lata, ashtu siç ishte i lidhur me Zotin, ishte i lidhur edhe me njerëzit. Dinte të komunikonte me to, pavarësisht moshës, arsimit, gjendjes ekonomike apo shkallës së besimit. Ai e gjente çelësin e komunikimit me të gjithë. I shtruar, i qetë, pa të bërtitura e pa bujë. Ai i bënte vend vetes me fjalën e shtruar, me mençurinë dhe dashurinë e tij për Fenë dhe Atdhenë.

Rruzhdi Lata ishte një atdhetar. Ai bënte propagandë për lirinë dhe bashkimin e shqiptarëve. Ai punoi dhe iu përkushtua çështjes kombëtare. Ai përkrahu luftën çlirimtare të Kosovës dhe atë në Maqedoni. Angazhimi i tij në radhët e BDI ishte një përkushtim në anën e drejtë tëçështjes shqiptare, e sidomos të të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Rruzhdi Lata, kur fliste për çështjen shqiptare citonte themeluesit e Rilindjes Kombëtare: Abdylin, Samiun, Naimin, Pashko Vasën e Asdrenin e deri te themeluesit e pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemailin e Dom Nikollë Kaçorrin, Haxhi Vehbi Dibrën, Haki Sharofin, Fuat Dibrën e plot të tjerë. Ai besonte se një besimtar i mirë ishte një atdhetar i mirë.

Dëgjoja shpesh në debate televizive sulmet që i bëheshin heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit nga besimtarë islamë, edhe ndonjë imam, por kur bisedoje me Rruzhdiun dhe e dëgjoje të fliste me pasion dhe dashuri për Skënderbeun dhe çështjen shqiptare, kuptoje se gjithçka që kishe dëgjuar ishte një humbje kohë. Rruzhdi Lata ishte kudo në Dibër ku organizohej një veprimtari me karakter historik: në Çidhën e Peshkopi, në Koxhaxhik e Valikardhë, në Tirane e Nju York. Dhe kudo që shkonte fliste shkurt dhe qartë.

Rruzhdi Lata ishte një misionar. Ai nuk ishte vetëm Myftiu i Dibrës, por ishte Myftiu i shqiptarëve. Me dashurinë për Zotin ai u shërbeu njerëzve, dibranëve e shqiptarëve, kudo ku ishte dhe kudo ku e kërkuan.

Rruzhdi Lata ishte një shërbëtor. Ai pranoi t'i shërbente Dibrës në qeverisjen vendore. Ai "rrezikoi" profilin e tij prej imami duke u angazhuar politikisht, por ia doli që të ketë sukses. Dibra ka pësuar shumë ndryshime. Janë ndërtuar shkolla e janë hapur rrugë. Janë thithur më shumë investime dhe ia ka arritur të angazhojë grupe interesi që të punojnë për Dibrën e ta zhvillojnë Dibrën.

Rruzhdi Lata ishte një i ditur. Ai njihte pesë gjuhë të huaja. Lexonte vazhdimisht. Zyra e tij në Myftini ka qenë një bibliotekë e madhe, rrethuar ngado me libra. Dhe kur flisje me Rruzhdiun flisje me shumë njerëz të ditur, sepse Ai nuk citonte vetëm ajete Kuranore, por edhe njerëz të ditur, që me dijet dhe veprimtarinë e tyre kishin ndryshuar botën.

Rruzhdi Lata do të mbahet mend si një ndër të vetmit që e ushqeu dhe e forcoi lidhjen me Tiranën. Angazhimi i tij për lobimin për ndërtimin e Rrugës së Arbërit ishte i fuqishëm, sa në Tiranë aq edhe në Shkup. Ai merrte pjesë nëçdo veprimtari që shoqatat dibrane organizonin në Tiranë, si në Kuvendin për Rrugën e Arbrit, veprimtaritë për 100-vjetorin e pavarësisë e plot të tjera. Ai besonte se lidhjet me Tiranën, pse jo edhe një binjakëzim i Dibrës me Tiranën do të ishte i afërt dhe me Rrugën e Arbrit do të ishte i pashmangshëm.

Rruzhdi Lata e donte Dibrën pa kufi. E donte Shqipërinë e Kosovën. I donte shqiptarët pa dallim. Ai ishte një Atdhetar i madh. Ishte një figurë e madhe shqiptare për lirinë dhe bashkimin e tyre. Ai ishte një paqedashës. Ai ishte një besimtar i devotshëm për fe e Atdhe.

Ai tashmë po shijon Xhehnetin, ndërsa ne do ta ndjejmë mungesën e tij. Por dashurinë e tij do ta ndjejmë përherë mes nesh.

Jetëshkrim

MR.RUZHDI LATA

I lindur më 06.05.1953, në Dibër. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë. Pas përfundimit të shkollës së mesme vazhdon studimet ne fakulltetin Filologjik-dega Gjuhë orientale në Universitetin e Prishtinës. Shkallën e tretë të studimeve e kreu në Universitetin e Prishtinës dhe morri titullin Magjistër i shkencave të filologjisë.

Karriera: Prej vitit 1980 ka punuar në Bashkësinë Islame dhe në të njejtën kohë ka ligjëruar në Universitetin e Prishtinës në katedrën e Orientalistikës deri në vitin 1991 kur sërbët me dhunë e larguan nga fakulleti. Punën në Prishtinë e vazhdoi edhe dy vjet në shtëpi private ku fakulleti mbante mësim. Pas vitit 1993 përsëri paralelisht dy vjet punoi në Bashkësinë Islame në Maqedoni dhe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup deri në vitin 1995. Pas vitit 1995 punoi vetëm në Bashkësinë Islame deri në vitin 2009, pas vitit 2009 gjer në vitin 2013 punoi në Bashkësin Islame dhe ligjerues në katedrën e Orientalistikës në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Në vitin 2013 u votua dhe u zgjodh kryetar i Komunë së Dibrës.

Gjuhët: shqip, maqedonisht, sërbokroatisht, turqisht dhe arabisht.

Gjatë karierës është marrë me përkthime nga arabishtja, vepra e dhjetë e Sahihil-Buhariut, nga turqishtja, romani i Sami Frashërit "Dashuria e Talatit me Fitneten", publikim i disa artikujve në katër vazhdime për Haxhi Vehbi Dibrën, Haki Sharofin, Fuat Dibrën etj.

Pjesmarrës në disa simpoziume ndërkombëtare dhe konferenca shkencore me temë "Kontributi i Ulemave dibranë në lëvizjen kombëtare", "Kontributi i Ulemave të Rekës", "Pjesmarrja e hoxhallarëve në Lidhjen shqiptare të Prizrenit dhe në Shpalljen e Pavarësisë" etj.

Përkrahës i lëvizjeve demokratike në Dibër dhe më gjërë, kontribut të veçantë ka dhënë për themelimin e partive politike shqiptare në Dibër pas vitit 1990. Njihet edhe si aktivist për pajtimin e popullatës në raste konfliktesh të të gjitha niveleve dhe ka të regjistruar mbi 150 pajtime. Njihet edhe si organizator për ndihmesë materiale për nevojën e kosovarëve, për pritjen dhe sistemimin e bashkëatdhetarëve nga Kosova në Dibër, për Lëvizjen kombëtare shqiptare në Maqedoni, për nevojat e qytetarëve të Peshkopisë në krizën e vitit 1997 etj.

Për punën e bërë me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë dekorohet Qytetar Nderi nga Këshilli Bashkiak i Peshkopisë.

Rruga e Arbërit nr. 151
histori

Historia e ngritjes së Muzeut **"Vend-origjina e Kastriotëve"** në Sinë

Nga **Besnik KËBEJ**

(vijon nga numri i kaluar)

Gurë të gdhendur dha dhe Ibrahim Basha, gurë nga të shtëpisë së tij. Të gjithë banorët e Çidhnës u vunë në punë për të siguruar gurë të gdhendur dhe ia arritën qëllimit. Në shënimet e mia nuk janë të gjithë emrat e specialistëve, por kam të shënuar se fasadën (faqen e parë) e filluan dhe e mbaruan Ramiz Loka, Hasan Leshi dhe Hasan Cerri.

Muaji nëntor atë vit mbajti shumë i ftohtë, sa dalta e hekurit ngjitej për dore, megjithatë puna vazhdonte pa ndërprerje nga mëngjesi deri në mbremje.

Kur vinin vizitorë nga larg, u shërbehej me kafe, të cilën dikush nga punëtorët e merrte të shtëpia e Besnik Kaloshit dhe vizitorët e pinin pa e ditur se ku bëhej kafeja. Kënaqësia ishte e madhe, që po bëhej një muzeum për Skënderbeun.

Brigada e bashkuar nga Peshkopia, nga Arrasi dhe Çidhna e dorëzuan objektin të lyer Brenda e jashtë dhe gati për të vënë pajisjet . Më 19 nëntor realizuan premtimin e Shahin Kamberit, që i pati dhënë kryetarit të Komitetit Ekzekutiv, Skënder Dema. Me mbarimin e ndërtimit të Muzeut, më 20 nëntor 1982, mbaron faza e katërt dhe nis faza tjetër.

Etapa e pestë
Kur dhe pse Muzeu u përurua në vitin 1985

Megjithëse Muzeu përfundoi së ndërtuari në një kohë record, ne mësues e nxënës vazhdonim punën në në gjitha drejtimet. Veprat e artit, skulpturat dhe pikturat nuk mund të bëheshin me aksion. Kjo ishte një ndër arsyet kryesore që përurimi u shty. Nga shënimet e mia shkëpus disa fjalë: Në Peshkopi më 13.12.1982 u bë një session shkencor kushtuar luftërave kundër turqve dhe kundër pushtimeve serbe. Në këtë konferencë, veç të tjerëve, ishte Aleks Buda, kryetar i Akademisë së Shkencave të RPSSH dhe merrte pjesë dhe Sulejman Baholli.

Në orën 14.00 konferencën e hapi Avni Fida dhe fjalën e mori drejtori i Muzeut të rrethit, Hysen Lala, i cili foli për shumë ngjarje, duke theksuar se Dibra është e zbetë në paraqitjen e vlerave historike në tekste, megjithëse ka historitë lavdishme.

Shefi i Arsimit dhe Kulturës të rrethit, Beqir Shehu, mbajti kumtesën: "Reformat e Tanzimatit të vitit 1839 dhe disa dukuri në viset e Dibrës". Këto reforma sollën ndryshime në disa drejtime, tha autori, si më 1909 më 25 korrik u zhvillua Kongresi i Dibrës e më 1910 u hap klubi "Bashkimi" etj. Materialin e përgatitur nga Kristo Frashëri e lexoi Viron Koka. Pastaj mbajtën trajtesa autorë dibranë, shumica e tyre drejtorë shkollash, rreth 28 vetë. Fjala e Aleks Budës u prit me interes. Ai theksoi lavdëroi punën e lektorëve dibranë, duke thëksuar se duhej thelluar më shumë mbi gjenocidin serb në këto anë.

Në këtë sesion shkencor isha dhe unë, bashkë me Sefedin Priftin. Pas mbarimit të aktivitetit, Sefedini takoi z.Buda dhe e ftoi për kafe. Ai pakashumë i tha se 'jam nga Sina dhe shokët më kanë porositë që të pi një kafe me Ju dhe për t'u falenderuar si Akademi e Shkencave dhe Ju si kryetar i saj për nderin që i bëtë Sinës dhe gjithë Dibrës, me ngritjes së Muzeut të Kastriotëve'.

Shkuam bashkë në hotel Turizmi dhe aty filloi biseda për të cilën interesoheshim, sidomos për Muzeun që mungonin materialet plotësuese dhe nuk ishte bërë inagurimi. E ftuam që kur të bëhej inagurimi të vinte e të festonim së bashku, por ai u përgjegj shkurt: "Unë nuk vi, më vjen keq por unë ato që kam shkruar për Kastriotët nuk i fshij. Ju kam lënë Stefanaqin dhe Kriston". Biseda mbaroi dhe u ngrit. Në këtë kohë, m'u kujtua debati që kishim bërë më Kristo Frashërin mbi origjinën e Skënderbeut. Pashë se historianët tanë janë kokëfortë në vetëkorrigjimin e mendimeve të tyre, edhe kur ka fakte të reja. Ky ishte takimi im i parë dhe i fundit me kryetarin e Akademisë Shqiptare të Shkencave. Më mbeti në kujtesë jo për mirë, pasi nuk tha asnjë fjalë jo për Dibrën, por as për Heroin tonë Kombëtar.



Foto © Bernard Zotaj

Unë dhe kolektivi i shkollës vazhduam detyrat që kishim në shkollë dhe krahas tyre punonim për gjetjen e materialeve të Muzeut. Tashmë kishim fituar një përvoje pune në gjurmimin e të dhënave, si toponimet, gojëdhënat e legjendat për Kastriotët, për luftërat kundër pushtuesve, duke u përqëndruar tek ato kundër turqve, por jo vetëm, duke grumbulluar e shënuar nga pleqtë të dhëna të ndryshme.

Unë fitova dhe një eksperiencë në intervistimin e njerëzve dhe plqeqve mendjehollë, që edhe pse pa shkollë, nuk i ngatërronin ngjarjet.

Disa nga të dhënat e këtyre njerëzve, (burra dhe gra), të vjela në vitet 1979 - 1988, po i paraqes më poshtë:

Në Sinë të Epërme mora të dhëna nga Rustem Pashnjari, vjeç 61; Halil Pashnjari 72 vjeç, Sanie Pashnjari 63 vjeç, Xhemal Pashnjari 72 vjeç, Haxhi Drizi 98 vjeç, Selim Kadriu 70 vjeç, Abaz Kadria 77 vjeç, Ymer Loka 66 vjeç, Kurt Kovaçi 93 vjeç etj.

Në Sinë të Poshtme: Tahir Zoku 78 vjeç, Shefki Prifti 42 vjeç, Sefedin Prifti 62 vjeç, Hide Elez Kaloshi 96 vjeçe, Islam Matrisi 80 vjeç, Elmaz Lika 78 vjeç.

Në fshatin Çidhën: Sadin Tola 80 vjeç, Selim Gjeçi 72 vjeç, Shaqir Tola 75 vjet, Osman Basha 77 vjet, Shaban Tërshalla 72 vjet.

Në Gur-Lurë: Liman Murati 63 vjeç; Në Arras Vesel Lusha 75 vjeç, Can Bajraktari 97 vjeç,; Në Brezhdan: Elez Tonuzi 71 veç; Në *Fushë-Alie:* Abaz Karoshi 75 vjeç, Dik Përnezha 71 vjeç; Në Blliçe: Ramadan Vesel Hoxha 72 vjeç, Xhemal Skepi 57 vjeç; Në Zall-Leshe Met Paci 78 vjeç, Hasan Leshi 70 vjeç; Në Mustafe: Qazim Xhika 50 vjeç; *Në Kodër-Leshe* Elez Rusi 103 vjeç.

Në zonën e Muhurit, fshati Vajmdhej: Llan Doda 99 vjeç, Ahmet Pira 81; Në Buloç: Selman Losha 77 vjeç; Në Hurdhë-Muhur: Xhil Çiku 76 vjeç, Hamit Balla 75 vjeç, Nezir Rama 80 vjeç; *Në fshatin Muhur*: Emin Mëziu 85 vjeç, Xhetan Prençi 71 vjeç, Tahir Mëziu 62 vjeç, Sami Hoxha 52 vjeç, Bajram Prençi 77, Islam Hoxha 75 vjeç, Islam Farruku 85 vjeç, Halit Laci 66 vjeç, Idriz Sina 58 vjeç; Në Rreth-Kale: Ibrahim Këbej 69 vjeç; *në Kishavec*: Haxhi Pira 78 vjeç e shumë të tjerë.

Më vjen keq që nuk po shkruaj emra të tjerë që kanë dhënë të dhëna për Skënderbeun e që nuk i kam shënuar. Po kështu, nuk kam shënuar bisedën me Selim Leshin e Kandrit.

Nga materialet e mbledhuara po shënoj tri legjenda, të treguara nga banorët e këtyre anëve:

1. Haxhi Hysen Drizi nga Sina e Epërme, në vitin 1982, kur ishte 98 vjeç: *"Sot i thonë Kepi i Skënderbeut, sepse ka pasë gjurmë kali. Kur Skënderbeu u zu ngushtë të Kepi i Qytetit matana Setës, ai mori vajzën e djalin dhe fluturoi nga Kepi i Qytetit për të dalë në Kepin Harlec. Por kur fluturoi, djali u tremb dhe ra në Setë. Gjurmët e kalit kanë qënë në atë kep, por kur kanë nxjerrë gur sinjanët, kanë prishë gjurmët e kalit. Skënderbeu mbeti pa djalë, kurse gjak femëror ka lënë. Po të kishte lënë djalë, do të kishte ruajtë lidhjet me Sinën, se prej Sine të Poshtme ishte babai i tij".*

2. Halil Hysen Pashnjari, vjeç 72 në vitin 1982, tregonte: *"Tre gjurmë të kalit Skënderbeut janë edhe sot në Hurdha të Mshela. Ka fjarue me kalë Skënderbeu nga Maja Shkurt e ka ra në Rrasën Dujs. Prandaj Skënderbeu ishte shumë i zoti për luftë, se ai kishte ene kalin si fluturonte".*

3. Sadin Tola 80 vjeç tregonte: "*Skënderbeu në Sheh të Thatë ka pasë ndërtue një kala, që ne i thona kalaja e Skënderbeut. Në një luftë ai dërgou fëmijët, gratë dhe pleqtë në këtë vend shumë strategjik. Kjo kala goditet vetëm në një vend. Kur ngjitesh nga rruga Sinë e Epërme në Pllaj, has në një vend që quhet Hurdha e Verës . Aty ndodhet vendi që quhet Rrafshaja e Topit. Turqve ua treguan këtë vend dhe ata me top goditën dhe e shembën kalanë dhe vranë fëmijë, gra e pleq. Skënderbeu i nami ata që treguan vendin, se nga ku merrej kalaja. (Dhe më poshtë vazhdon: Te Kepi i Qytetit është vendi ku mateshin djemtë për të shkue në luftë e vajzat për t'u bërë nuse".*

(Shënim: Tri intervistat janë bërë në vitin 1982, nga unë autori)

Ishin këto disa nga ato legjenda që mblodhën në atë periudhë. Duke i lënë gojëdhënat, kthehemi në punën e bërë asokohe, 1982-1985. Skënder Dema u zëvendësua nga dibrani Rakip Danqe. Ky jo që nuk u interesua për Muzeun, por dërgoi një urdhër më shkrim që në objektin e muzeut të futeshin material tjera dhe muzeu të kthehej në kopësht për parashkollorët.

Unë shkova në Komitetin Ekzekutiv, ku më priti sekretari Avni Fida, të cilit i tregova urdhërin e dhënë. Pas pak diskutimesh, unë i thashë prerë: Objekti është nisur për muze dhe muze do jetë. Unë do marr materialet që janë te 'muzeu' i sektorit dhe do i fus në objektin e ri. Kopësht nuk e bëj! Dhe dola.

Të nesërmen me mësues e disa nxënës, morëm ata material që ishin në objektin e sektorit dhe i futëm në ndërtesën e re të Muzeut. Përurimi i Muzeut të ri u vonua, pas duheshin disa vepra arti; duhej përgatitur mirë një session shkencor për periudhën skënderbegiane dhe origjinën e tij dibrane. Ky session u planifikua dhe u organizua nga përgjegjësi i Seksionit të Arsimit dhe Kulturës Ramiz Lela, më 1 nëntor 1985.

Nga shënimet e mia, pa përsëritur të tjerët po nxjerr këto material: Marrin pjesë në sezion Haxhi Lleshi, Jashar Mezenxhiu, Tefta Cami etj. Referauan: Selami Pulaha, Haziz Ndreu, Luan Malltezi, Malo Hrshova, Ali Hoxha dhe drejtori i Institutit të Historisë Prof. Stefanaq Pollo. Falenderoi për punën e bërë nga studiuesit Jashar Mezenxhiu.

* * *

Më poshtë po jap kujtime për atë periudhë nga ***Ramiz Lela,*** *ish përgjegjës i Seksionit të Arsimit dhe Kulturës, (me kërkesën time), i cili shkruan:* **Nga përurimi i Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Çidhnës,**

2 Nëntor 1985.

Në fshatin Sinë të Çidhnës, në Dibër, në një lëndinë të bukur, me pamje ballore nga Dibra, në një lartësi të konsiderueshme, si një ballkon pranë shtëpive të fisit të njohur e me tradita të Kaloshëve, ndodhet Muzeu i Kastriotëve.

Ky muze i vogël, me një ndërtesë njëkatëshe, me gurë të gdhendur nga mjeshtërit e Sinës, u përurua më 2 nëntor 1985, për të dëshmuar një fakt të madh historik për atë kohë dhe për brezat që do vijnë se *origjina e Kastriotëve është Sina,* është Çidhna e Dibrës.

Unë në atë kohë isha në detyrën e përgjegjësit të seksionit të Arsimit dhe Kulturës të rrethit Dibër, por edhe si nip i fshatit Sinë, në bashkëpunim me Aziz Ndreun, Besnik Këbejn, Shahin Kamberin dhe të tjerë, kam dhënë kontributin tim për këtë muze.

Sot, kur lexoj shënimet e mia për ato ditë, për punën për ngritjen e muzeut dhe organizimin e sesionit shkencor që u mbajt më 1 nëntor 1985, duket se vlerësoj historinë e kësaj krahine me vlera të mëdha. Nxitës dhe këmbëngulës për ngritjen e këtij muzeu u bë "Artisti i Merituar" Aziz Ndreu dhe Besnik Këbej. Aziz Ndreu kishte bashkëpunim me historianët e nderuar të vendit tonë, me profesorët Stefanaq Pollo dhe Kristo Frashëri. Këta profesorë të nderuar të historisë kishin mbështetur kërkesën dhe mendimin për ngritjen e një muzeu në Dibër, kushtuar Kastriotëve dhe Skënderbeut dhe se ky muze duhet të ishte në Sinë të Çidhnës, në Dibër.

Bashkë me Haziz Ndreun dhe Ali Hoxhën, Moisi Murra, Besnik Këbej e studiues të tjerë nga rrethi ynë, këmbëngulnin vazhdimisht për domosdoshmërinë e ngritjes së Muzeut të Katriotëve dhe dhanë një kontribut të madh për këtë problem. Duhet pranuar se kishim shumë vështërsi për fonde për ndërtimin e këtij objekti, duke patur parasysh se në atë kohë kishte rregulla shumë rigoroze për shpenzimin e çdo fondi që jepej.

Kisha biseduar me drejtuesit e rrethit, sidomos me kryetarin e Kom.Ekzekutiv të rrethit Dibër, Skënder Dema, një burrë i respektuar për punën e tij si drejtues për kohën e gjatë që punoi në Dibër dhe me sekretarin e Kom.Ekz. të rrethit, Avni Fida, të cilët ishin dakord, por meqë rrethi ynë në plan të parë kishte detyrat ekonomike, që nuk ecnin mirë, problem i muzeut mbeti si pas dore.

Megjithëkëto, Aziz Ndreu, miku im i respektuar, këmbëngulte që të ngrinin muzeun, se duhet të kemi një muze të tillë patjetër. Një ditë, muaji qershor 1982, Azizi më vjen në zyrë dhe pasi ndezi një cigare duhan, më tha: "Do vish të shkojmë në Tiranë, se kam lënë një takim me Stefanaq Pollon dhe Kristo Frashërin dhe do e ndajmë punën e muzeut një herë e mirë: Ose do e bëjmë, ose nuk do e bëjmë muzeun, a ta lëmë këtë punë!"

Vendosëm që të shkojmë në Tiranë. Kishim lënë takim një ditë qershori 1982 me profesorët dhe u takuam në ambientet e Pallatit të Kulturës. U përshëndetëm dhe diskutuam kryesisht për problemin e muzeut.

vijon në numrin e ardhshëm

cyan magenta yelloë black

50 vjetori i orkestrinës popullore të Matit - "Mjeshtër i Madh

Orkestrina e Matit njëra nga mrekullitë e trashëgimisë shpirtërore shqiptare



ORKESTRina 1966

Munir Shehu, ky personalitet i kulturës shqiptare, realizoi bashkëzanimin e pasurisë së instrumenteve tradicionalë të trevës së Matit dhe hodhi bazat e një risie shumë domethënëse, Orkestrinën, si një nga kolonat kryesore të ansambleve folklorike në shoqërimin e këngëve, valleve, por veçanërisht të melodive popullore në trevat gege.

Nga **Esat RUKA**

Trashëgimia Kulturore shqiptare, si pjesë e identitetit tonë kombëtar, përbën kontributin më të vyer, më origjinal e identifikues e shprehur magjishëm në këngët e vallet, veshjet e rapsoditë, baladat e ritet, lojrat popullore e krijimet gojore, ndërtimet e mënyrën e jetesës, gjuhën etj, Ajo është e vjetër sa vetë njerëzimi dhe përfshin shumë fusha studimore që nga arkeologjia, etnofolkloristika, etnografia, gjuhësia, historiografia, arkitektura, etj. Ruajtja, mbrojtja, arkivimi, qarkullimi dhe përcjellja në gjeneratat e reja përbën aspiratën kryesore për shtetin, shoqërinë dhe organizatat civile (OJQ) të mbështetura në politikat e zhvillimit dhe në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Viti 2018 përmban një kalendar të pasur me ngjarje kulmore në jetën e shqiptarëve. Ato janë të karakterit historik, politik dhe kulturor dhe ngërthejnë një periudhë mbi 550 vjeçare. Secila syresh meriton respektin, pasqyrimin dhe promovimin e saj në dimensione të plota e dinjitoze, si dëshmi e kolona të rëndësishme të progresit shoqëror.

Në korpusin etnomuzikor të kontributit njerëzor *instrumentet muzikorë*, përbëjnë një pasuri të madhe, të rëndësishme dhe shumë domethënëse. Organizimi i punës me 'to, krijimi i grupeve orkestrale në ansamblet e rretheve, u bë baza e shoqërimit të këngëve e valleve si edhe loja veças e në grup. Orkestrinat popullore të ngritura mbi traditën e lëvrimit të tyre përbënin njërën nga risitë e kohës. Në shumë zona të hapësirave gjithshqiptare kishte një përvojë të hershme në formacione të vogla orkestrale lëvizëse, që qarkullonin brenda dhe jashtë zonës. Por fillimi i daljes së tyre në skenë do të kërkonte një përgatitje serioze e shumë të kujdesshme nën drejtimin e mjeshtrave muziktarë me përvojë dhe aftësi profesionale.

* * *

Treva e Matit e ka ruajtur, zhvilluar e trashëguar kulturën e tij materiale dhe shpirtërore. Ai ka derdhur margaritarët e shpirtit të tij në këngët, vallet, meloditë e veglat muzikore popullore, në kostumet e bukura e të larmishme në përjetësimin e ngjarjeve të mëdha historike e figurave të shquara të nivelit lokal e kombëtar.

Është e njohur dhe e vlerësuar nga të gjitha instancat profesionale e opinioni artdashës mbarëkombëtar mrekullia e njërës nga këto formacione si është orkestrina popullore e Matit. Krijimi i këtij fenomeni artistik në fillimet e viteve '60 të shek XX, u mbështet në traditën shumë të hershme të orkestrinave shëtitëse të trevës së Matit. Ideatorët dhe drejtuesit e këtij formacioni shfrytëzuan me zgjuarsi dhe kompetencë profesionale pasurinë e instrumenteve, duke i radhitur llojet e tyre sipas klasifikimeve të muzikologjisë botërore në *kordofone, aerofone, idiofone dhe membranofone*.

Duke njohur dhe respektuar specifikat tonalo-modale të këtyre instrumenteve nga ana e mjeshtrave drejtues, u bë i mundur bashkëzanimi i tyre shumë logjik dhe organik në përputhje të plotë të mikrotoneve. Baza melodike e krijimit dhe tingëllimit të këtij formacioni muzikor u bënë instrumentet aerofonë dhe kordofonë por edhe teknika ekzekutuese e instrumentistëve virtuozë vendas si: Imer Nelaj, Ibrahim Minxhozi, Shaqir Hazizi, Hysen Koxherri, Sali Kurti etj,.

SI U KRIJUA ORKESTRINA POPULLORE E MATIT?

Fillimet e veta si formacion i reduktuar do ta kishte në vitin 1965 në një takim instrumentistësh. Në vitin 1966 në Festivalin Folklorik Kombëtar në qytetin e Elbasanit, hitet e kohës "Laçi-Bruçi dhe Uraka" dhe "Liqenit të Ulzës" me tekst e muzikë të kompozitorit Munir Shehu kënduar nga e mirënjohura Feride Kurti do të ndiznin sallat dhe sheshet. Munir Shehu, ky personalitet i kulturës shqiptare, realizoi bashkëzanimin

Përkujtimi i jubileut të 50 Vjetorit është edhe një homazh nderimi për shumë nga artistët themelues që kanë dhuruar emocione krijuese dhe kanë ndezur në shpirt krenarinë e identitetit të popullit që i përkasim

e pasurisë së instrumenteve tradicionalë të trevës së Matit dhe hodhi bazat e një risie shumë domethënëse, Orkestrinën, si një nga kolonat kryesore të ansambleve folklorike në shoqërimin e këngëve, valleve, por veçanërisht të melodive popullore në trevat gege.

Në Festivalin e Parë Kombëtar në Gjirokastër në vitin 1968 kjo orkestrinë, e organizuar dhe drejtuar nga Ai muziktar do të meritonte në mënyrë të padiskutueshme vendin e pare, Më pas do të tërhiqnin vëmendjen e publikut, studiuesve dhe Jurive profesioniste duke u vlerësuar vazhdimisht me çmime deri në "Medaljen e Artë", Urdhrin "N. Frashëri i Kl të Parë"...

Ky formacion folklorik muzikor, me karrierën e saj prestigjioze 50 vjeçare ka krijuar një përvojë të madhe skenike duke u shndërruar në një shkollë për shumë formacione simotra.

Për të konkluduar në vlerat e spikatura të një formacioni artistik së pari nisemi nga origjinaliteti i produktit muzikorë, aftësia e interpretimit, lënda me të cilën ushqehet, përbërja e instrumenteve dhe mbi të gjitha aftësia ekzekutuese e mjeshtrave në secilin instrument, por edhe cilësia e aftësia organologjike e instrumenteve si zeje prodhimi.

Formulimet melodike të luajtura kryesisht nga këto lloj orkestrash (përfshi edhe atë me disa lloj veglash popullore) parë në sferën emocionale të tyre, janë orientuar në **tre stile kryesore:**

a - në stilin logogjenik, që përfshin pjesë nga këngët vokale e rapsodike.

Në këtë stil ka luajtur **lauria.** Ky arketip shumë i vjetër dhe i rrallë transmeton një timbrikë të veçantë. Lauria, si instrument kordofon me hark me mesazhet e veta lirike ka dëshmuar shprehje origjinale të krijimtarisë anonime si dhe aftësi të pakundërshtueshme integrimi me modet muzikore të instrumenteve të tjerë tradicionale në Mat.

b- në stilin melogjenik, që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me meloditë tipike instrumentale, dhe këtu të shumtën është shfrytëzuar repertori i fyejve dhe çiftelisë.

c- në stilin patogjenik, repertor që lidhet me ndjenja të fuqishme, të përbëra nga copëza melodike, bazuar në atmosferën muzikore të këngëve të vajit, por të përshtatura dhe adoptuara me ndjenjë artistike.

Çfarë e dallon orkestrinën e Matit me simotrat e saj?.

Muzika me instrumente tradicionalë në Mat shprehet me të njëjtat instrumente si dhe në trevat e tjera të Shqipërisë së Veriut e Verilindjes. A mund të themi se gjithçka me



formacionet simotra është e njëjtë?. Sigurisht që Jo. Tingulli muzikor, si dukuri akustike – natyrore, duke e studiuar në një dimension më të gjerë e më kompleks, si nocion i tillë prezantues, i japin cilësi e atribute të dallueshme.

Një vesh muzikor i stërvitur e bën menjëherë dallimin midis instrumenteve nga disa elementë përbërës, si timbri (ngjyra), forca, ambitusi (lartësia) teknika e ekzekutimit etj. të cilat përbëjnë atë që quhet **stil i tingëllimit**. Kjo përbën një origjinalitet nacional të kulturës së një populli dhe një autenticitet të veçantë.

Etnomuziklogu gjerman **Fritz Bose** thotë se :"muzika, jo vetëm që ka funksion tjetër... në popuj të ndryshëm, por edhe tingëllon ndryshe. Dhe është pikërisht **stili i tingullit,** i studiuar në mënyrë të hollësishme që përcakton karakteristikat e veçanta të një muzike në një hapësirë të caktuar.

Ajo që e bën orkestrinën me vlera origjinale, vendase (anase) është që secili instrument gjatë lojës solo në përbërje të orkestrinës duhet të endet në repertorin e vet, duke ruajtur strukturën, shtrirjen, thyerjet ritmike, ngjyrimet, alternimet etj, duke krijuar një peizazh muzikor mbresëlënës e sugjestionues. Muzikaliteti interpretues, futja e dajres (perkusionit) në orkestrinë i dha dinamikë e impuls, qëndrueshmëri e strukturë më të qartë në krahasim me të gjitha orkestrinat simotra në shkallë vendi.

Janë të shumtë etnomuzikologët që janë shprehur profesionalisht e me dashuri për prurjet dhe origjinalitetin e muzikës së këtij formacioni orkestral. Puna e kujdesshme profesionale e muzikantëve Munir Shehu, Shefqet Doda, Naim Gjoshi, Shefqet Merra, Fatmir Leka, apo e gjurmuesve e mbledhësve të njohur të folklorit, Ymer Neli, Sabri Alia, etj dhe loja e saktë, virtuoze e pastër dhe e intonuar e të gjithë orkestrantëve, ka bërë që ky formacion i muzikës tradicionale të ketë stilin e vet të dallueshëm në nivel kombëtar.

A është i dallueshëm stili muzikor ?.

Aftësia teknike në përdorimin e gishtrinjëve (tre - katër gishtave të dorës së majtë), harmonizimi i të dyja duarve, përdorimi i dorës së djathtë në tremolo të dubluar, apo açakaturat e apoxhiaturat, shfrytëzimi i plotë i tastierës, pastërtia e tingullit, larmia ritmike, dhe siguria ekzekutuese janë kushte jo vetëm teknike ekzekutimi, por edhe aftësi interpretimi. Ashtu sikundër në aerofonet: mënyra dhe koha e të marrunit frymë dhe realizimi i plotë i frazës a fjalisë muzikore, kalimi në oktava, si dhe aftësia ritmike që duhet të udhëheqë dajreja në açelerimet e nevojshme, përdorimi i harkut e glisandot në lauri etj, janë disa veçori që **përcaktojnë stilin** e këtij fenomeni muzikor tradicional që tashme ka krijuar shkollën e mbiquajtur Orkestrina me instrumente popullorë e rrethit të Matit.

vijon në faqen 20

Rruga e Arbërit nr. 151

botime

Shënime rreth librit "Kalaja e Dodës - Vështrim enciklopedik" të autorëve Beqir Shehu dhe Ermira Shehu Toca

KALAJA E DODËS - VËSHTRIM ENCIKLOPEDIK

Nga prof. dr. **Hajri SHEHU**


(vijon nga numri i kaluar)

Dheu i Kalasë së Dodës na vjen në libër edhe me **emërvendet** (toponimet) e tij. Toponime shumë interesante: Pellazge në Shullan, Kepi i Fratit në Shkinak, Kroi i Dom Allit në Vasije, Kroi i Zanave në Ceren, Kama e Atit në Çajë, Luftaina në bjeshkët e Korabit, Vilzat në Fshat etj. Tek emërvendet (makrotoponimia dhe minitoponimia) mund të shohësh e të zbulosh topografi e histori, objekte kulti e objekte mbrojtjeje, ngjarje historike e emra historikë, mite e legjenda, fjalë të vjetra e fjalë të vjetruara, fjalë të hershme e fjalë më të reja, fjalë të mbarë gjuhës e fjalë krahinore, krishterizma e islamizma, kompozita e formime të tjera shqipe e edhe fjalë të huaja, që janë futur dhunshëm në vend të fjalës shqipe etj. Shih, p.sh.: *Ballëfushë, bukëmirë (Art Bukmira), cakë* (= kodër e vogël, çukë), *çapël, frashnajtë* dhe *vallnajtë* (= livadhe të rrethuara), *Kepi i Brushllës (brushtull* bimë barishtore me gjethe të gjera), *Kepi i Shpinaxhrit* (= Shpinagrit), *Kroi i Zanave, Skepsorra, Suka, Vanat, Zgjata* etj. Ato na vijnë sipas konfiguracionit, përcaktuar nga një mbiemër që tregon pozitën gjeografike, natyrën, përmasat, ngjyrën etj.; sipas emrit të një bime etj. që rritet vetiu a që kultivohet aty; sipas emrit të lëndës që mbizotëron në përbërjen e aksh vendi; sipas një ngjarjeje historike; sipas një objekti të ndërtuar aty, sidomos me emrin *kala, kishë, teqe* etj. Janë qindra toponime (p.sh., nga Vila, rreth 250; nga Fshati, rreth 250; nga Buzëmadhja, mbi 300; nga Shkinaku, mbi 450; etj.). Është një fjalor me emrat e vendeve. Por në këtë lëndë toponimike që na vjen si një adresar, me të gjitha ato vlerat historike, gjuhësore etj., duam të përveçojmë vetëm një gjë – vazhdimësinë tonë gjuhësore – gjeografike dhe historike, njësinë (unitetin) e gjuhës shqipe. Vetëm pak shembuj: *Ballëfushë* në Kala; e kanë edhe arbëreshët (dhe më tej: po i njëjti formim gjuhësor në zonën Lezhë-Shkodër: *Ballëdre* në Lezhë dhe *Balladrini* // më 1416 në anët e Shkodrës); *Gramë* në Kala, *Gramë* në Karaburun; *Shpinagër* në Kalis, *Shpinager (Shpirag)* në Berat[4]; *Qafë-Murra* e Dibrës / *Qafë-Murra* e Kalasë së Dodës; shih *Tejdrinia* / *Tejdrina* dhe formime analoge në gjuhën shqipe e edhe emra të këtillë topikë në viset e tjera shqiptare; shih prapashtesat fjalëformuese *–th* e *–z* tek *Elbth* e *Majëmalth* e *Lamëz* në Kala dhe më larg se Kalaja: *Greth, Lmuth, Theth, Arrëz, Lajthizë, Fierzë* e tek arvanitët – *Dardhëz, Fikëz, Shkretëz; Kullas* (në Kala) e kemi si *Liqenas; Nërlusna* është si *Nënshkodra;* E atëherë, etimologët e toponimistët kanë punë me toponimet e Kalasë për shumë gjetje e motivime gjuhësore. Ua ka vënë në tavolinë libri i Beqirit dhe i Ermirës. Edhe historianët e etnologët mund të kenë punë me emërvendet *Pellazge, Shitorth, Tejs, Shulla, Vilë* e *Rade.* Ndoshta, edhe arkeologët – me kishën e Tollomazit, Taben e Nizamëve, kalanë e Mlikës (Vilës), kalanë e Aravelit etj.

Kalaja e Dodës është një areal i spikatur jo vetëm natyror e gjeografik, por edhe **rrugor**. Dhe në libër na vjen edhe me këtë pamje madhore. Edhe me emërtime shumë thelbësore. Prandaj edhe ishte Kala, se zotëronte edhe rrugët.

Kalaja e Dodës na vjen në libër me tërë **historinë** e saj. Ajo nis me "Kalaja e Dodës në defterët kadastrorë osmanë (1571-1595)". Të dhëna për Kalanë e Dodës vijnë edhe nga fermani sulltanor i vitit 1585. Aty lexuesi mëson edhe për Vezirin e Madh, Sinan Pashë Topojanin dhe që për vdekjen e tij u njoftua edhe papa Klementi VIII. Kalaja e Dodës përmendet më 1539 si njësi administrative me emrin Nahija e Katundeve të Dibrës, pjesë e sanxhakut të Dukagjinit. Deri në vitin 1883 Kalaja e Dodës ka qenë **kryeqendra e nahijes së Lumës,** me atributet e kazasë.

Historia e kalasë bëhet nga ngjarje të mëdha: Beteja e 300 nuseve (që vjen edhe me një këngë popullore madhështore); Beteja e Lumës (1912) kundër pushtuesve serbë; Kryengritja e 22 shtatorit 1913: 3000 luftëtarë shqiptarë kundër 60 000 forcave serbe. Historia vijon: Kryengritja e vitit 1920 kundër pushtimit serb; Kujtimet për luftën kundër pushtimit serb nga njerëz që e kanë përjetuar. Pastaj: Mbretëria; Pushtimi fashist; Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare; Çlirimi i Shqipërisë; Zhvillimi ekonomik i krahinës deri më 1967; Zhvillimet politike dhe ekonomike pas viteve '90 të shekullit të kaluar.



Në libër kalojnë si në revistë personalitete e njerëz të thjeshtë, luftëtarë e dinjitarë, reizë e bajraktarë, pushtetarë e pasunarë, kuvendarë e përjetues ngjarjesh etj.: Mahmud Daci e Mustafë Lita, Qazim Lika e Bajram Gjana; Ibrahim Gjorgji – bajraktari i Radomirës e dëshmori i parë në luftën kundër serbëve e Sadik Gjoniku, nga Stërdoku, zëvendësshejhul islam në Stamboll e shumë të tjerë. Dhe këngë popullore historike: "Djemt e Lumës hiç s'kan dert, / Ka ni luft e bajn përvjet, / Për vatan s'tremen me vdek" Dhe: "Qazim Lika po vikat: / S'shkelet Luma pa u la n'gjak, / Ndash koft serb, ndash Karadak".

Pjesë e rëndësishme e jetës dhe e historisë së Kalasë së Dodës ka qenë **shkolla dhe shkollimi**. Në libër bëhet një përshkrim historik i mejtepeve, i luftës kundër analfabetizmit, i ngritjes së arsimit fillor e shtatëvjeçar, për të ardhur deri te shkollat e mesme në Ceren, Bushtricë, Fshat, Kalis. Bashkë me arsimin, edhe kultura është pjesë e jetës. Ajo është pasqyrim social-ekonomik e social-kulturor i një kohe të caktuar. E kanë drejtuar mësuesit dhe specialistë të kulturës. Këngët e vallet e Kalasë janë duartrokitur në festivalet e rrethit e më tej.

Një faqe e veçantë e librit është **jeta fetare** në Kala të Dodës. Ajo është një trajtesë e mirëfilltë shkencore si për një konferencë shkencore me këtë tematikë. Është një ndër ato faqe libri ku njeh Kalanë e Dodës e njerëzit e saj historikë e aktualë. Ja një shembull i këtyre njerëzve. Në libër shkruhet: Thuhet se dy djemtë e Teqesë së Shkurtit në Gjegje – Nebiu dhe Sula kanë marrë pjesë në luftën ruso-turke (1877-1878) dhe *shpatat e tyre janë ruajtur aty* (në teqe).

Libri është enciklopedik. Aty është edhe etnografia, edhe e folmja. Aty ka edhe kanun, edhe folklor. Shih, p.sh., konceptin etnografik *lisi i gjakut* (lidhja nga babai) dhe *lisin e tamblit* (lidhja nga nëna). Një lidhje tjetër që shpjegohet hollësisht në libër është organizimi dhe vetorganizimi i katundeve, siç u tha, me vetëqeverisjen e tyre.

Ngaqë e kemi afër Kalanë, kemi pasë menduar se e kemi njohur dhe e kemi ditur. Jo dhe aq. Besoj që nuk e njohim kalendarin popullor të Kalasë. Ndoshta, nuk njohim as tetë festat? Ja cilat kanë qenë: ♦ Kryet e motmotit (a Shëngjergji) – 6-8 maj; ♦ Të korrat – 23 qershor; ♦ Festa e maleve (e mesverës) – 7 gusht; ♦ Dita e vjeshtës – 21 shtator; ♦ Mesi i vitit (Shëmitri) – 5, 6 nëntor; ♦ Buzmi – 22 dhjetor; ♦ Mesdimni – 5 shkurt; ♦ Dita e verës – 22 mars. E tërë jeta dhe e tërë puna është bërë sipas këtij kalendari. Lexojeni në libër këtë pjesë se do të mrekullohemi me konceptin kohë e mot!

Një përshkrim i plotë etnografik, por edhe përmallues për ndonjë të moshuar e shumë informues për këta të brezit të sotëm është martesa: shkuesi e shkuesia, kthimi i bukës, përgatitja e pajës, lypja e nuses në muajin e gjatë, dasma me natën e farës, organizimi i dasmës, lojërat në oda, ardhja e dajave, kanaxhinjtë e arkat e nuses, marrja e nuses e ardhja e nuses, nata e kurës (gjerdekut) dhe këngët e asaj nate pak si të lirshme, lodrat (daullet) dhe pushka e dhëndrit, myzhdexhiu e përcjellja e dajave, daria (paja) dhe tregimi i pajës etj. Ditën e ekspozimit të pajës (është dita e dytë e dasmës) ka një konkurs të vërtetë bukurie. Tek oda e grave, bashkë me nusen e sapoardhur mbështeten për muri edhe nuse të tjera të atij viti. Janë nuse të vëllazërisë, të fisit, të mëhallës, por edhe të nipave të shtëpisë. Kur hyn, secila nuse përshëndet me temená grarinë e odës dhe zë vend te muri më këmbë. Ndërkohë, vajzat improvizojnë këngë për bukurinë e tyre.

Autorët kanë shpalosur edhe **krijimtarinë gojore popullore** të krahinës. Sigurisht. Sepse krijimtaria gojore popullore është *pasqyrim estetik i jetës së njeriut*. Shih këngët e motmotit dhe festat e motmotit.[5] Shih këngën "Oj Fusha e Korabit". A mund të trajtohet ajo si këngë kurbeti? Folkloristët e dinë. Ne mendojmë se është këngë shtegtimi, këngë jete dhe pune. Sepse deles i shkohet prapa. Dhe deles i kanë shkuar prapa edhe profetë. Është këngë për tufat e për shtegtarët. Sidoqë të mendohet, lexoni shkrimin e posaçëm të bashkautores Mira.

Shih baladën "Kajka e Rexhës". Djepi i saj, - thotë Jahe Delia, - është Radomira. Te kënga është jeta dhe vdekja, lumturia dhe vuajtja, dashuria dhe dhembja. Dhe stoicizmi. Dhëndri vritet ditën e martesës. Çfarë s'i ndodh njeriut! E tërë kënga është monologu vajtimtar (i nënës). Ajo mallkon kalin që e la pa djalë. Në odën e burrave ka heshtje. Për tragjiken. Nga tragjikja. Cila është etika e këngës? Lexuesi ka rastin jo vetëm ta lexojë këngën, por të shohë edhe komentin e zgjedhur për të.

Jemi te krijimtaria gojore dhe te jeta. Shih mjedisin tipik kaladodas te "Motra me nanë vllazën": Motra në dhé të huaj ka shkuar te kroi e po mbush enët. Dhe fjuturon një laskër e bie përmbi krue. Laskra e bardhë me bishtin e zi. Laskra sjell lajme. Po këndoi laskra diku te një pemë e jona, na vjen një lajm! Diku thuhet *pëllumbi*. Ne kemi laskrën.

Shih besën shqiptare te "Motra me nanë vllazën" (varianti arbëresh "Kostandini dhe Doruntina). Hiseni, ma i vogli vëlla, ngrihet nga varri për të sjellë motrën sipas besës së dhanëme (*Ani thkee kraiet ka çai mali zi, / Hiseni, ma i vogli, po vain me t'marr ti / Fjuturon si shqipe n'gjokin pullali).* Shih *gjokin*. Dhe gjoki është i Kalasë.

Le të shohim përrallat e episodet në përralla. Edhe këtu është jeta. E mira dhe e keqja. Lufta e përhershme kundër së keqes. Situatat e habitshme. Mrekullorja. Ngadhënjimi. Morali. Lexoni në libër përrallën *I vdekmi dhe i xhalli* se do të mrekulloheni edhe tani, në kohën e internetit. Krijimtaria gojore popullore – e kemi fjalën posaçërisht për poezinë popullore – është pasqyrim estetik edhe i **historisë** së popullit tonë. Autorët citojnë studiuesin francez, Hekar: «Po të duam ta rindërtojmë historinë e Shqipërisë, duhet të mbledhim me kujdes këngët e saj popullore». E vërtetë. Lexoni këngët historike e këngët e trimërisë së Lumës. Shihni këto dy palë vargjesh për të kujtuar ngjarjet e mëdha:

Çohet n'kam Kalisi e Qafa, / Me ni mij po vain Mustafa.

Dhe:

Kur vikati Petro Krali, / Prizrenin kush e kalli? / Qazim Lika e Bajraktari.

Një zë më vete në libër është **e folmja** e Kalasë së Dodës. Siç dihet, gjuha e përgjithshme, mbarëkombëtare ka variante krahinore. Variantet nuk e prishin njësinë (unitetin) e përgjithshme të gjuhës. Si ekziston kjo simbiozë e si zhvillohet më tej? Ka faktorë socialë. Ndërkohë, është vërtetuar shkencërisht që për arsye historike që dihen, për gjuhën e përbashkët letrare shqipe, variantet krahinore, domethënë, të folmet kanë edhe rol kontributor pasurues. Gjuha e njësuar letrare shqipe – me termin e sotëm – gjuha shqipe standarde – merr nga të folmet fjalë e shprehje që sjellin vlera pozitive për të. Dhe atëherë, të tilla fjalë e shprehje fitojnë të drejtën e qytetarisë, domethënë, fitojnë vlera letrare reale. Ky pasurim i gjuhës standarde me fjalë e shprehje nga të folmet popullore ka edhe gjeografi të caktuara. Për shembull, gjeografia e fjalëve që kanë të bëjnë me bjeshkët e me ujërat, e profesionalizmave që kanë të bëjnë me mbarështimin e deles, me përpunimin e leshit e të bulmetit, ose e etnografizmave që lidhen me veshjen, gatesat etj. mund të vijë nga e folmja e Kalasë. Të tilla ka edhe te libri i Beqirit dhe i Mirës. Shih: p.sh., te krijimtaria gojore e tek emërvendet. Fjalët e shprehjet popullore, të pasqyruara në këtë libër na bëjnë me dije edhe për disa veçori gjuhësore të leksikut të këtyre anëve, çka do të thotë se shërbejnë për kërkime të mëtejshme krahinore e dialektore.

Në fund, autorët vijnë me propozime për riorganizimin administrativ të Kalasë së Dodës. Dhe, sipas autorëve të librit, po të miratoheshin, do të ishin me shumë vlerë. Kurse shkrimi përmbyllës, *Kalaja e Dodës, një vend me burime të mëdha turistike* duket si një sintezë e si një përfundim i tërë asaj që është thënë më parë. Ai duket sikur thotë: Ja, kjo është Kalaja e Dodës. Vërtet, kjo është Kalaja e Dodës – me visore (peizazhe) e me histori, me kulturë e me qytetërim, me etnokulturë e me folklor, me djem e me cuca, me burra e me trima.

Kalaja e Dodës na ka ardhur edhe nga konsulli e albanologu austriak, Johan G. von Hahn, me librin e tij, me titull "Udhëtim në luginën e Drinit e të Vardarit". Na ka ardhur edhe nga syzet e konsullit rus, Jastrebov *(Staraja Serbia i Albania)*. Ata kanë qenë të huaj dhe librat e tyre janë udhëpërshkrime a siudhëpërshkrime. Sigurisht, edhe me njohje të pakta: sa u thoshin të tjerët a ç'mund të rroknin për momentin aty ku ndodheshin. Ndonjë - Jastrebovi, edhe me qëllime jo të mira. Kurse autorët tanë janë rrënjës. Me dije dhe formim për atë që shkruajnë. Dhe dashatarë të përzemërt të Kalasë së tyre. Dhe janë të sotëm. Kësisoj, libri i tyre i lë shumë prapa ata të parët.

Kalaja e Dodës na vjen edhe në libra e në shkrime të veçanta nga autorë të tjerë vendës a më tej se vendës: Fejzulla Gjabri, Hamid Noka, Hysë Hasa, Isa Halili, Ismen Brika, Jahe Delia, Mevlan Lushi, Metush Skeja, Muharrem Mezini, Nezir Jata, Shefqet Domi, Shefqet Hoxha, Xhavit Lashi, Xhemal Domi etj. Të gjithë këta kanë shkruar mirë e bukur. Në mënyra të ndryshme e me përfshirje e qasje të ndryshme. Libri i Beqir Shehut dhe i Mira Shehut është gjithëpërfshirës. Ai rreshton fakte e të dhëna deri tek administrimi i brendshëm i shtëpisë (shihni, p.sh., të drejtat dhe detyrat e zotit të shtëpisë dhe të zonjës së shtëpisë). Shih edhe benë e betimin. Ja dhe një fakt, në dukje i vogël, por jo i parëndësishëm: Në vitin 1950, në shtëpinë e Skënder Krroqit është hapur ambulanca e parë mjekësore për krahinën. Ja edhe një fakt tjetër – toponimi *Vorret e Vashave* në Radomirë. Aty varroseshin vajzat e pamartuara. Domethënia e toponimit është e spikatur. Janë ushtruar qitja, kalërimi dhe mundja në Kala. Ai që fitonte garën, merrte dashin. A do, ndërkohë lexuesi të dijë për Gurasenin? Le të lexojë citimin nga Ami Boué. Po kush e ka ndërtuar Kroin e Mirë? E keni në libër: Safet e Sami Sadiku (Lamallari), më 1938. Por në libër nuk ka vetëm fakte e të dhëna. Ka edhe shpjegime e komente shkencore - historike, folklorike, etnologjike, etnografike, toponomastike etj.

Në libër ka aq shumë tema. Por ato përbashkohen në një. Si ngjyrat te spektri i dritës. Si shtatë ngjyrat e ylberit. Dhe ky ylber është Dheu i Kalasë së Dodës. Brenda së përgjithshmes e përbashkueses, autorët kanë ditur të japin të veçantën e përdalluesen (p.sh., për Kalisin e Vilën).

Libri ka harta e fotografi. Këto janë një vlerë më vete. Citimet në raste të caktuara nga të tjerët e bëjnë librin shkencor dhe ia rrisin vërtetësinë dhe vlerën thënies së autorëve.

Libri do të ketë me siguri vendin e tij të merituar në fondin e botimeve të këtij lloji në Shqipëri e në viset e tjera shqiptare. Me siguri do t'i referohen për libra të tjerë në të ardhmen.

---

4 Shpinaxhri (Ne e kemi rindërtuar Shpinagri) në Kalis = mal që është si shpina e agrit: Kepi i Shpinaxhrit / Shullani i Shpinaxhrit / Udha e Shpinaxhrit. Edhe në Berat ka Shpiragu (rotacizmi n → r). Agër e shpjegon prof. Çabej me një fjalë të moçme të shqipes, gare, që e ka Buzuku = gomar, magar. Prej indoeuropianishtes. (Shih: Eqrem Çabej, Studime gjuhësore, Prishtinë, 1976, f. 30). Në të folmen e Ujemujës (qarku i Dibrës) gjallon kuptimi i figurshëm mbiemëror i fjalës agër "i trashë, gomar", për dikë, me theks tek ë dhe me rr: agërr.

5 Është interesante të veçojmë te ritet e festimit të Ditëverës patkimin e shpendrës (shpendra është taçja) dhe të folesë së milingonave përreth dy javë. Ditën e festës, secila vajzë merr shpendrën e vet. Çdo vajzë merr një kupë dhé nga foleja e mizave. I vënë tek dyert e shtëpisë dhe të ahurit. Më shumë se paganizëm, na duket kujdesi për bimët dhe gjallesat: i ushqyen rreth dy javë.

75-vjetori i vrasjes së Ismail Strazimirit dhe libri i tij me kujtime
"Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë"


Për një **Shqipëri** europiane, **jo otomane**

Ismail Strazimiri është një protagonist i rendit parësor në vendlindjen e tij në Dibër e në gjithë Shqipërinë për rolin që ka luajtur në rrjedhat e turbullta të historisë së lëvizjes kombëtare, prej shfaqjes së saj në formën e një ideologjie e përfytyrimi romantik deri në Luftën Antifashiste. Strazimiri ishte pjesëmarrës në Kongresin e Dibrës, që u mblodh vetëm pak kohë pas Kongresit të Manastirit, për të ridiskutuar çështjen e alfabetit, me qëllim që të përfitohej aq sa mund të përfitohej prej lëshimeve të qeverisë qendrore perandorake, por u shpreh në mënyrë të vendosur kundër rikthimit në përdorim të alfabeteve të gjuhëve orientale dhe pro alfabetit latin, megjithëse duke qenë në pakicë. Prania e pak njerëzve si Ismail Strazimiri në këtë kongres u shpëtoi erzin organizatorëve të tij dhe historisë së kulturës shqiptare, që u ndodh afër hapit të kthimit prapa.

Në gjithë rrëmetin e paimagjinueshëm të viteve '20 të shekullit të kaluar, Ismail Strazimiri nuk gabohet në hapat që hedh. Gati një shekull prej kohës që kanë ndodhur ato ngjarje; kur gjithsesi ekziston një përfytyrim konvergjent për rendin historik të kohës; pasi janë shkruar dhjetëra artikuj, studime e monografi për Ismail Qemalin; për Qeverinë e Vlorës dhe atë të Durrësit; për Esad pashën, rebelimin dumbabist të Shqipërisë së Mesme, Musa Qazimin dhe Haxhi Qamilin; për mbrojtjen e Shkodrës dhe luftën e Kolesianit; për dërgatën e Turhan pashës në Versajë dhe luftën e Vlorës; për atentatin në Paris dhe Kongresin e Lushnjes; është e lehtë të thuash se cili do të kishte qenë rreshtimi atdhetar më i denjë. Por të zgjidhje në atë kohë rreshtimin atdhetar më të paqortueshëm, kur referencat ishin krejt të paqendrueshme; kur për një javë faktori më pozitiv mund të ishte mbështetja tek aleati ballkanas i Gjermanisë, Bullgaria; kurse në javën pasuese një nismë e Aqif pashë Elbasanit, një veprim energjik i Ahmet Zogut apo një konflikt midis komandës ushtarake dhe asaj politike në shtabin e ushtrive franceze në jug të Shqipërisë (por kurrsesi jo i Esad pashës dhe njerëzve të tij në Dibër si Arif Hiqmeti) - kjo ishte e vështirë.

Ismail Strazimiri dëshmohet në gjithë këto rrjedha të turbullta atje ku i bëhej mirë atdheut të tij. Dhe kjo ndodhte vetëm në një grusht njerëzish idealistë, të cilët: nuk ishin pjesë e ndonjë projekti të të huajve për të sunduar në Shqipëri përmes duarve të zgjatura të tyre, domethënë vetë shqiptarëve; nuk kishin ndërtuar plane vetjake për të shtënë në dorë Shqipërinë

Libri i Ismail Strazimirit nuk është thjesht një libër kujtimesh. Në përmbajtjen e tij autori ka tejshkruar biseda shumë të rëndësishme me veprimtarë të kohës, vendës e të huaj, të zhvilluara nga ai vetë; letra të pritura e të dërguara; shenjime të rëndësishme për njohjen e procesit historik. Midis argumenteve themelorë ku shfaqet zbulimi i Ismail Strazimirit janë: përhapja e esadizmit nëpër Shqipëri;



apo pjesë të saj dhe për t'i kthyer në pashallëqe; e donin sinqerisht atdheun e tyre pa interes pragmatik. Ismail Strazimiri paraqitet në jetën e vendit të vet në kohën kur ai sa e kishte nisur historinë shtetërore, me vetëdijen e një rilindësi. Ai vetë është dëshmues i së vërtetës së pohuar, se ata që i kanë ndërtuar veprimet e tyre ashtu si do donin të vepronin rilindësit, si rregull nuk kanë gabuar.

Libri i kujtimeve të Ismail Strazimirit botuar nga shtëpia botuese "Naimi" me titullin "*Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë*" u mbarua prej tij në vitin 1931. Për shkak të vërtetësisë së thellë, herë-herë dhe denoncuese; për shkak të palavdisë së shtetit dhe të shtetarëve në dorë të të cilëve gjendej Shqipëria; për shkak të dëshirës për të mos i bërë të njohura botërisht ato që M. Šufflay i quante "*duševne bolezne*" të shqiptarëve; këto kujtime nuk u botuan asnjëherë shekullin e kaluar. Kjo ka dhe të mirën e vet, sepse kështu objektivisht ato kanë ruajtur vërtetësinë burimore, duke shpëtuar prej konformizmave të gjithëfarshëm që ka njohur historiografia shqiptare: të lartësimit të mbretit, të madhështimit të traditës revolucionare, pa përjashtuar dhe ndonjë konformizëm tjetër të kohëve më të reja.

Se në Shqipëri nuk ishte vetëm një Esad pashë; kishte dhjetëra pashallarë, Esadë të vegjël, në gjithë Shqipërinë e gjorë, që vatani u duhej vetëm për vete. Libri i Ismail Strazimirit është i mbushur me pashallarë, bejlerë, efendinj. Autori ua shkruan me shkronjë të madhe ofiqin (Ahmet Beu, Jusuf Beu, Esat Pasha), sepse kjo titulaturë kishte zëvendësuar mbiemrin e tyre. Kjo elitë kishte dhënë shenja të një rehatimi të dukshëm qysh në shekullin e 18-të, me letërsinë që krijohej me alfabete, gjedhe poetike, modele vjershërimi, kode estetikë dhe madje dhe me motive tipike orientale dhe osmane.

Gjithë kësaj elite të dështuar nga të gjitha pikëpamjet: morale, politike, intelektuale, Ismail Strazimiri gjen t'u vendosë përballë një atdhetar të formuar pa bajrak a pashallëk nën sundim, me një flamur të vetëm, flamurin e shpëtimit të Shqipërisë: Elez Isufin, që përbën figurën më të rëndësishme të gjithë librit të tij. Ai është modeli i njeriut shqiptar që ia kushton gjithçka të vetën vendit të tij dhe së fundmi i jep lamtumirën kësaj bote me një dëshpërim të thellë, që po t'i jepej mundësia t'ia niste nga e para

Ismail Strazimiri është një protagonist i rendit parësor në vendlindjen e tij në Dibër e në gjithë Shqipërinë për rolin që ka luajtur në rrjedhat e turbullta të historisë së lëvizjes kombëtare, prej shfaqjes së saj në formën e një ideologjie e përfytyrimi romantik deri në Luftën Antifashiste. Strazimiri ishte pjesëmarrës në Kongresin e Dibrës, që u mblodh vetëm pak kohë pas Kongresit të Manastirit, për të ridiskutuar çështjen e alfabetit, me qëllim që të përfitohej aq sa mund të përfitohej prej lëshimeve të qeverisë qendrore perandorake...

nuk do të bënte më aq për popullin dhe atdheun, sepse ishte e kotë. Megjithatë, Elez Isufi mbetet e vetmja dritë e panjollë në gjithë botën e ndërlikuar të karaktereve të shëmtuar të librit të Ismail Strazimirit. Në portretin e këtij atdhetari në një farë mënyre ai sheh dhe veten. Ndoshta, është një rastësi, por familja e Elez Isufit e kishte ruajtur mbiemrin e të parëve, një emër shenjtori, Ndreu.

E dyta gjë që sjell në kulturën historike shqiptare libri i Ismail Strazimirit është dëshmia se parësia shqiptare, nëse mund të kuptojmë me këtë klasën qeverisëse me pushtet politik të mbështetur mbi tagrin etnozakonor, që për fat të keq vijon edhe sot, përgjatë kohëve nuk dëshmohet gjithnjë njëlloj, ka anën e vet të errët e të ndritur: në një brez ka arritur të bëjë shumë për vendin e në një brez tjetër ka dështuar ose i ka bërë të zezën atdheut. Dhe kjo provohet me dëshmitë e shërbyera prej autorit për parinë dibrane, që i nënshtrohet të njëjtave ligjësi. Besoj se lexuesi do të më japë të drejtë se Strazimirët, të cilët, sipas disa mendimtarëve (duke përfshirë edhe Mehdi bej Frashërin), trashëgojnë mbiemrin e njërit prej prijësve Balshaj, nuk kanë pasur njolla të tilla në rrugën e heshtur të tyre, dhe ndoshta pikërisht heshtja, "*lartësia e përulur*", nëse do të përdornim një shprehje të Konicës për Gjeçovin, i shpëtoi prej fatit të të tjerëve.

Ismail Strazimiri i shkroi kujtimet e veta vetëm për një periudhë prej 12 vjetësh, një numër simpatik për shqiptarët dhe shumicën e popujve të botës: nga Shpallja e Pavarësisë deri te Revolucioni i Qershorit. Në këto 12 vjet ka mbrapshti sa për disa shekuj. Shqipëria u bë, por jo siç e deshën shqiptarët. Aq më pak siç e donte Ismail Strazimiri. U bë një Shqipëri që zyrtarisht thuhej se vërtitej në duart e Fuqive të Mëdha, por vërtetësisht rrotullohej sipas konkurrencës së parave të dhëna "*krenëve*" të saj nga Beogradi, Roma, Athina, Stambolli, Viena dhe kryeqendra të tjera të politikës botërore. Dhe pikërisht kjo është dhe dhimbja fisnike e Ismail Strazimirit: që Shqipëria u ndorua prej "*krenësh pa krye*", që e shisnin Jugun për "*dishir*" të Veriut e anasjelltas; që ia falnin dreqit të krishterët për një "*Shqipëri të bekueme muslimane*"; që i ndanin zotërimet e tyre prej Shkumbinit në Mat, prej Matit në Drin, prej Drinit në Valbonë a në Kir e kështu me radhë dhe në drejtimin jugor, ku Mihal Grameno e Mid'hat Frashëri bënin, në të njëjtën kohë, polemika vetjake në shtypin e huaj e vendës, njëri nga Bari dhe tjetri nga Sofja. Shqipëria e kujtimeve të Ismail Strazimirit është një republikë tribale, një shtet etnografik, ku për të kaluar nga një krahinë në tjetrën duhet "besa-besë" dhe asgjë tjetër! Është një Shqipëri që, sipas shprehjes së Fishtës, nëse vërtet do t'ia dilte të përligjte pavarësinë e vet, kjo do të ndodhte "*për inat të djallit dhe të shqiptarëve*", që bashkëpunonin kundër saj. Kjo është një pikëpyetje e madhe për historiografinë shqiptare: ndoshta jo tepria, por pamjaftueshmëria e ushtrimit të pushtetit qeverisës, i çoi shqiptarët tek një qeverisje e tillë etnografike-fisnore-politike, që ka simptoma të saj deri më sot.

Shqipëria e viteve 1912-1924, siç na e dëshmon me dhimbjen e një protagonisti autori i këtij libri, ishte në kuptimin e plotë të fjalës një shtet etnografik-tribal, ku ligjin e bënin krerët e fiseve; një shtet që nuk ishte as monarki as republikë; një shtet ku krahinat shpallnin pavarësinë prej atdheut dhe ruanin me ushtarë vullnetarë "kufijtë" e tyre, urat, shtigjet e kalimit.

Në shërbim të Qeverisë Kombëtare të Ismail Qemalit; mbështetës i princit europian Wied që kundërshtarët e paraqitnin si një katundar austriak dhe të dërguar të krishterimit; njohës dhe kundërveprues i drejtpërdrejtë dhe i ballëpërballtë ndaj politikave të Esad pashës dhe Ahmet Zogut, në krahun e revolucionarëve fanolistë në vitin 1924 dhe paralajmërues i rreptë i dështimit të tij; larg qeverisjes republikane dhe mbretnore të beut të Matit; Ismail Strazimirit, megjithatë, i kishte mbetur dhe një sfidë e fundme: pjesëmarrja në luftën antifashiste. Ai njihet si dëshmori më i moshuar i kësaj lëvizjeje në shkallë botërore: ishte 75 vjeç kur u vra në Sllovë prej ushtrive të huaja dhe bashkëpunëtorëve të tyre, duke pasur në krah si bashkëluftëtarë të dy djemtë.

Libri i Ismail Strazimirit nuk është thjesht një libër kujtimesh. Në përmbajtjen e tij autori ka tejshkruar biseda shumë të rëndësishme me veprimtarë të kohës, vendës e të huaj, të zhvilluara nga ai vetë; letra të pritura e të dërguara; shenjime të rëndësishme për njohjen e procesit historik; informata dhe të dhëna që nuk gjenden në shkrimet teknokratike historiografike.

Midis argumenteve themelorë ku shfaqet zbulimi i Ismail Strazimirit janë: përhapja e esadizmit nëpër Shqipëri; konflikti i anadollakëve me europeistët për qeverisjen e saj; vizitat e Esad pashës në Dibër dhe kthimi i tij nga Serbia po përmes Dibrës; vetëshpallja e Ahmet Zogut kryetar i Matit dhe Dibrës; grindjet e fabrikuara të tij për shenjat e flamurit kombëtar; gabimet e disa atdhetarëve me emër në viset veriore të Shqipërisë; lëvizja dibrane e marsit të vitit 1922 dhe rrethimi i qeverisë në Tiranë, megjithëse e pambështetur prej forcave të pritura sipas marrëveshjes nën komandën e Bajram Currit; ikja e Ahmet Zogut për në mbretërinë serbo-kroato-sllovene përmes fshatit Homesh të Dibrës... Ky libër do t'u vlejë lexuesve shqiptarë për të njohur historinë e lëvizjes atdhetare dhe të veprimit antikombëtar në dy dekadat e para të Shqipërisë shtetërore; do t'u vlejë historianëve jo vetëm për pasurinë informacionit, por edhe për gjykimin dhe vlerësimin e situatave dhe sidomos për shumë pikëpyetje që shtron.

Martin Nika

Rruga e Arbërit nr. 151

Kontributi i Karolina Farricit bëri që në sa e sa raste emri i saj të vlerësohej si një model pune, si një model sjelljeje qytetare, por dhe si një model femre e humanisteje, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë në nevojë.

Torinezja, Karolina Festa (Farrici) – Qytetare Nderi e Burrelit

Më 16 mars 1911 (njëqind e shtatë vite më parë), në familjen e çiftit Viçenzo e Roza Festa, në qytetin e Torinos në Itali, shpërtheu gëzimi dhe hareja, sepse ajo u shtua me një foshnjë të seksit femër, të cilën e pagëzuan me emrin e bukur, Karolina. Para saj në këtë familje kishin ardhur edhe katër fëmijë të tjerë, motrat Xhuzepina, Anxhelina e Xhina, si dhe vëllai i saj i vetëm, Xhovani, i cili mbante gradën doktor i Shkencave Ekonomike. Si fëmija i fundit, Karolina gëzoi tërë kujdesin familjar, duke u rritur dhe edukuar më së miri në profesionin e mësuesisë dhe si një "zogë e bukur", që me rritjen e saj, në moshë e në shtat do të bëhej nuse e birit të Matit, Hasan Farricit nga fshati Vinjall i rrethit të Matit, në Shqipëri. Ky djalosh, me fizik e bukuri të veçantë dhe me arsimim të lartë ushtarak të marrë në Itali, si inxhinier xhenier, e pikasi këtë "thëllënzë mali", me tërë hiret e saj femërore, karakteristike dhe edukatën e shëndoshë qytetare që ajo posedonte dhe demonstronte në familje, në rrugë dhe në mjedise të tjera të Torinos dhe jo vetëm, duke i dhënë besën njëri-tjetrit" ndërtuan familjen e re shqiptaro-italiane, të




cilën e trashëguan për tërë jetën e tyre. Hasani, bashkëshorti i ardhshëm i Karolinës – Torineze, përballoi pengesa dhe vështirësi serioze atje në Itali.

Edhe pse ai studionte në shkollën e lartë ushtarake atje në Itali, në fushën e inxhinierisë së xhenjos, pushtimi i vendit të tij nga fashizmi italian më 7 prill 1939, e indinjoi thellë dhe u bë një nga kundërshtarët e vendosur antifashist, ku pasojat për të do të ishin një rebelim i vërtetë. Kundërshtimi i betimit të tij, së bashku me shumë shokë studentë bashkëatdhetar, bënë që t'iu nënshtrohej vuajtjeve të shumta, deri në burgosje, të dënuar nga Gjykata Ushtarake e Romës, me akuzën e antifashistit të vendosur e të rrezikshëm. Nën vuajtje të tmerrshme fizike, morale, njerëzore dhe shpirttërore të thellë u gjend edhe e dashura e tij, Karolina, të cilës iu kërkua me këmbëngulje nga autoritetet italiane, divorci me Hasanin,vetëm e vetëm se ky ishte antifashist shqiptar, me rrezikshmëri të lartë, kundër pushtimit fashist italian në Shqipëri. Pas kryerjes së dënimeve të dhëna nga drejtësia italiane, Hasani dëbohet nga Italia për në Shqipëri. Por që nuk iu nda pas edhe Karolina me të cilën kishin ndërtuar familjen dhe kishin lidhur jetën bashkëshortore.

Që të dy erdhën në Shqipëri, duke lënë Torinon e Italisë, qytetin e ëndërrave të fëmijërisë e të rinisë, ku ishte lindur, rritur, arsimuar, e edukuar kjo vajzë besnike. Çifti Farrici, pasi kaluan së bashku muajin e parë në Vinjall, vetë Hasani do të sistemohej me punë në Ministrinë e Punëve Botore në Tiranë dhe pas çlirimit të vendit në fundin e vitit 1944 deri në vitin 1948 punoi si ushtarak, oficer xhenjoje në Ministrinë e Mbrojtjes. Por edhe për Hasanin do të përsëritej kërkesa që i ishte bërë Karolinës në Itali, të divorcohej me bashkëshorten e tij, Karolinën, sespe kjo ishte një shtetase e huaj dhe si e tillë duhet e do të kthehej në vendin e origjinës, në Itali. Si Hasani, ashtu dhe Karolina e kundërshtuan këtë masë ndëshkimore si një veprim antinjerëzor, aq më tepër se ato tashmë kishin edhe një femije, djalin e parë, Skënderin. Karolina edhe kushtin tjetër të rëndë, që iu kërkua nga autoritetet shqiptare, atë të ndryshimit të nënshtetësisë e të kombësisë italiane, e kundërshtoi me vendosmëri.

Në harkun kohor deri në vitin 1960, ku Hasani punonte në disa qytete si në Shkodër, Elbasan e Lushnjë, Karolina për disa kohë ka qëndruar e banuar me periudha të gjata në fshatin e bashkëshortit të saj, në Vinjall, ku tashmë ky fshat ishte bërë si një vendbanim i dytë i dashuruar prej saj, ku fitoi edhe dashurinë e respektin e grave e vajzave të këtij fshati.

Karolina ishte një lexuese pasionante libri dhe nëpërmjet profesionit që ajo zotëronte, si rrobaqepëse e nivelit të lartë, këtë profesion e bënte pjesë masive e bashkëpunëtoreve të saj në qytetin e Burrelit, për të cilin komuniteti



kishte shumë nevojë. Kontributi i saj për një kohë të gjatë në këtë profesion si rrobaqepëse, bëri që në sa e sa raste emri i saj të vlerësohej si një model pune, si një model sjelljeje qytetare, por dhe si një model femre e humanisteje, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë në nevojë që kishin për këtë lloj shërbimi, ku vetëm në Burrel shërbeu për 32 vjet pa ndërprerje. Në këtë qytet, ajo jetoi dhe edukoi mrekullisht tre fëmijë, Skënderin i cili mban titullin "Qytetar Nderi" i Burrelit, djalin tjetër Idealin, si dhe vajzën, Donika që jeton në Itali.

Pas vitit 1992, Karolina deri në vitin 2000 kur u nda nga jeta e saj dhe nga gjiri i familjes, e i shoqërisë së saj, banoi në qytetin e Torinos në Itali. Por nuk iu nda dhe qytetit të Burrelit dhe Shqipërisë, sepse Këshilli i Bashkisë së Matit, me vota unanime i dhanë zonjës Karolina Farrici (Festa) titullin e lartë "QYTETARE NDERI" e Bashkisë Mat, me motivacionin: "Vajzës së lindur në Torino të Italisë, që sakrifikoi çdo gjë për hir të dashurisë së vërtetë, lirisë, humanizmit dhe që krijoi në Mat, bashkë me Hasanin, që rrezatoi mirësi, edukatë dhe kulturë femërore duke lënë gjurmë respekti te të gjithë", titull i cili shpreh dashurinë dhe respektin për të, si dhe që do të rrezatojë ndër breza vlerat dhe kontributin e saj si një qytetare, si nënë, bashkëshorte, por që do të shërbejë edhe si një urë e fuqishme miqësie e mirëkuptimi të popullit të Matit me atë të Torinos në Itali dhe anasjelltas. Nderimi i saj me dhënien e këtij titulli të lartë do të mbetet një kujtim i bukur dhe i paharruar për të gjithë komunitetin e Matit për sot dhe përgjithmonë.

Renato TOTRAKU

Nëntor 2018

Orkestrina e Matit njëra nga mrekullitë e trashëgimisë shpirtërore shqiptare



Fatmira me këngën e kurbetit

vijon nga faqja 17

Tashmë ashtu si orkestrina me saze të Jugut të vendit, Fyejt e Gramshit, Kavajt e Gostivarit në muzikën me instrumente tradicionalë mund të themi se kemi stilin muzikor lokal dhe kombëtar.

Këto artistë përmes kompleksitetit të elementëve muzikorë: ritmit, shkallëve muzikore *(radhëve tonale),* shtrirjes *(ambitusit)* dhe funksionit të muzikës në jetën sociale etj.

Ndikimi i disa instrumentistëve të njohur që kanë lënë gjurmë të thella në popull për mjeshtërinë e lojës dhe pasurimin e arkivit muzikor, kanë krijuar një shkollë që në popull përdoren me shprehjet: *na merr melodinë e filan ustai" ose "lezetoje pak si (thuhet emri i më të mirit)..."* . ose edhe kur jepen këshilla : "mos e *përzijë" etj.* Këto elementë kanë krijuar stilin e tyre origjinal. Prandaj në Mat janë të njohura shprehje klasifikuese si « filanit i këndon çiftelia varur në mur » apo « me ahengjet e *Kurdarisë* kërcejë *lisdanët* ». Dy herë i është mundësuar shkuarja në Mat prof. Ramadan Sokoli dhe ai konkludoi me shprehjen se « Mati është bunar i folklorit ». Padyshim që këto konkluzione nuk duhen marrë si përkëdheli por si një apel për gjurmuesit e studiuesit, specialistët e punonjësit e kulturës.

Aftësia dhe profesionalizmi i d**rejtuesve të formacioneve orkestrale** kanë rëndësi themelore në përgatitjen dhe promovimin e këtyre vlerave, nga ku kushtëzohet ruajtja e tingëllimit origjinal dhe zhvillimi i stilit të dallueshëm të tyre.

Si konkluzion :

Së pari, është shfrytëzuar me seriozitet e profesionalizëm lënda muzikore tradicionale. Repertori i saj është plotësisht në shtratin melodik dhe tonal të trevës.

Së dyti: pjesët e lidhura në formë suitash dy e tre pjesësh janë realizuar në shembullin e një forme klasike me racionalitet dhe me pasuri ritmike komplementare.

Së treti: secilit instrument solistik i është lënë hapësira e nevojshme në lojën e tij pa e sforcuar dhe denatyruar duke shfrytëzuar me racionalitet timbrikat e laurisë, ritmet e daires etj.

Së katërti: Virtuoziteti dhe cilësia e tingëllimit është udhëhequr nga aftësitë e veçanta në ekzekutim të Ymer Nelit në fyell e kavall, Behar Nelit në bilbil, Qamil Beshkut në lauri dhe Xhevat Lishit e Isuf Gjokës në dajre, Enver Kurtit në lodër.

Së pesti: Me futjen në orkestrinë të çiftelive dhe bilbilit të temperuar është bërë kujdes në eliminimin e mospërputhjeve të sistemeve toniko-modale popullore me ato kromatike. Koordinimi dhe alternimi i tyre ka ndihmuar në tingëllimin dhe emocionin artistik të orkestrinës.

Së gjashti : Kjo trashëgimi ka memorizuar dhe pothuaj ka vënë gurin e parë të traditës në lojën me instrumente të grupeve vetëm me vajza. Pra dimensionin gjinor të traditës.

Së fundi: Ky formacion muzikorë meriton promovimin në mjedise e skena prestigjioze si një vlerë e rrallë e trashëgimisë shpirtërore kombëtare.

Në nderim të punës plot pasion e përkushtim të «Mjeshtrit të Madh» Imerr Nelaj- Artist i Merituar, një salle në mjediset e shtëpisë së kulturës në Burrel i është vënë emri i këtij Mjeshtri. Ajo sallë është menduar që së shpejti të kthehet në një kabinet folklori sipas një masterplani me ndihmën e ekspertëve dhe përvojës më të mirë kombëtare.

Destinacioni artistik i Orkestrinës, prania e gjithkohshme në skenë dhe në vështrimin e specialistëve e ka bërë atë të vetëdijshme për rolin e saj, ka thadruar tek instrumentistët shpirtin e garës si dhe ka bërë të mundur thithjen e përvojës më të mirë kombëtare. Orkestrinat simotra kanë shprehur gjithnjë admirim për paraqitjen, repertorin, ritmet e larmishme, por kanë listuar me shumë respekt edhe emra të mirënjohur të saj, madje duke i patur edhe si model të tyre. Nuk e teprojmë kur themi se ka patur prej tyre që nuk mund të imitoheshin si Ibrahim Minxhozi, Shaqir Hazizi në çifteli apo Qamil Beshku në lauri e Xhevat Lishi në dajre, etj.

Si një formacion muzikor i traditës që përmban të gjitha instrumentet tradicionalë të trevës, pasurimin e melosit dhe origjinalitetit tingëllues, që ka ruajtur stilin e ka promovuar shoqërimin ekselent të zërave në këngët e traditës e që vazhdon të tërheqë rreth vetes talente të rinj, për autoritetin e opinionit të shkëlqyer që gëzon në rrethet artistike kombëtare të muzikës tradicionale, Presidenti i Republikës së Shqipërisë i ka akorduar titullin e lartë *"Mjeshtër i Madh"* në vitin 2017.

Përkujtimi i Jubileut të 50 Vjetorit të marrjes së Çmimit të Parë nga kjo Orkestrinë në tetor të vitit 1968 është edhe një homazh nderimi për shumë nga artistët themelues të cilët nuk janë më në mesin tonë.

Po kaq nderim meritojnë edhe ish drejtues të institucioneve kulturore në rrethin e Matit për ndihmesën dhe vlerësimin e punës me instrumente muzikorë tradicionalë nëpër ansamblet e tyre artistike. Këto ditë në shtëpinë e Kulturës në Burrel do të mbahet një veprimtari artistike Jubilare në respekt të rrugëtimit të suksesshëm të kësaj orkestrine me instrumente të traditës, si një emblemë e trashëgimisë së identitetit kombëtar në fushën e muzikës.

** Studiues i etnomuzikologjisë, tetor 2018.*

Përtej kufirit të Dibrave, me fare pak identitet

Nga **Alban TUFA**

Kufiri i parë i njeriut është barku i nënës, aty është hapësira e tij, nga ku kufizohet edhe me botën jashtë. Ky lloj kufiri nuk është vendosur nga njeriu. Të gjithë pastaj janë sajesat e njeriut: djepi, dhoma, oborri, ara, fshati, qyteti, qarku, shteti dhe së fundmi kontinenti. Duke qenë se barku nuk është kufi i vendosur nga njeriu, kurrsesi nuk mund të zhvendoset nga njeriu, në të kundërt të të tjerëve: dhoma mund të shtohet dhe ndahet me mur mes, ara mund të blihet dhe bashkohet, oborri mund të ndryshohet në formë fizike dhe konceptim estetik, siç qyteti a qarku mund të ndryshohen me vendime administrative, qeverie a parlamenti, po ashtu edhe kufinjtë e shtetit mund të lëvizin nga luftërat dhe futja e duarve (sidomos e të mëdhenjëve) në to.

Kufinjtë shumicën e rasteve nuk janë të drejtë ose të merituar, dhe çdoherë janë konvencione të ardhura si produkte luftrash ose negociatash të stërzgjatura apo tregtive të momentit, bash në ato çaste delikate. Për shembull: disa parcelave në fshatin tim iu kanë lëvizur kufinjtë dhe kjo ka sjellë shumë keqkuptime sepse "guri i kufinit" nuk iu ka shërbyer më si konvencion dhe pasojat kanë qenë të rënda.

Ndërsa kufinjtë më kompleks në botë më duken kufijtë shtetëror. Në ato ku të bëhen skanera, ku të bëhen kontrolle, ku duhen policë, ku duhen vula, pasaporta, leje, gjuhë, euro, garanci dhe plot e plot kushte me plot parakushte. Dhe me të tillë kufinjë jam ndeshur jo rrallë herë. Në fund, kulmi i absurdit është që nga njëra anë e kufirit është Dibra dhe nga ana tjetër po Dibra. Këtu bie edhe teoria e konvencionit në kushte normale duke qenë se në perceptimin e përgjithshëm dibranët as këtë anë e as matanë kufirit nuk e kanë dashur atë.

Tashti na lind e drejta ta quajmë si konvencion pa konvencion. Shpesh kësisoj çështjesh nuk mund të zgjidhen nga asnjëlloj teorie mbi identitet kombëtare, anipse nuk e pretendojmë, duke e lënë kështu thjeshtë në dorën e historisë.

Janë disa ngjarje që pasi t'i dëgjosh nuk të shqiten kurrë nga mendja madje dhe po të duash, siç janë dhe disa ngjarje që pasi t'i përjetosh edhe këto (më shumë) nuk harrohen kurrë. Ajo që do të lexoni më poshtë i përket një kohe para katër vitesh dhe e gjitha që po shkruhet bazohet tërësisht në kujtesë. Arsyeja pse nuk i kam shkruar që më herët është, jo se nuk i kam parë me interes, por sepse sot besoj se më janë mprehur më shumë aspektet e arsyetimit, gjykimit dhe më së shumti ato të shkrimit.

I vendosur në disa kushte të detyrueshme, njeriu merr një vendim të shkojë diku gjetkë, në një vend dhe shtet tjetër dhe që në mënyrë të njëkohshme të braktisë vendin, kulturën, zakonin dhe ç'është më me rëndësi, shoqërinë e vet. Kështu njeriu sapo del nga bota e vet, përballet me një botë tjetër reale, që nuk e zbeh kurrë qenësinë e asaj bote ku jetonte, vetëmse vërtetson gjërat, i zgjeron të vërtetat dhe vetëdijëson njeriun mbi ato që ekzitojnë si dhe e bën atë më njeri.

Kur njeriu kapërcen kufirin, fillon e bëhet më nostalgjik e mandej melodramatik deri në meditativ si shkallë e përme arsyetimi. Fillon pastaj njeriu dhe mendon për të shkuarën, duke sjellë imazhet e gjithë fëmijërisë para syve. Është një proces thuajse i pashmangshëm. Pasi i sos gjithë këto nostalgjitë e rastit, mprehet dhe futet në nocionet e kombit. Ç'është kombi, kjo gjë kaq e rrahur dhe e shumëdëshiruar nga intelektualët, dhe e mbjellur tek të gjithë njerëzia. Ja ky kombi a shteti që ne e deshtën aq shumë, dhe po e braktisim.

Kufiri, si të gjitha shpikjet e njeriut nuk ka ndonjë gjë të veçantë në të, pos një trau, disa policëve të kontrollit, disa makinave dhe disa paisjeve tekonlogjike (normale sot). Deri në Bllatë, kam ardh më një furgon tip Benz dhe rruga kushton 150 lekë. Dogana e krahut Tonë nuk ka asnjë gjë të veçantë, gjithçka ndodh normalisht. Polici kontrollon kartën, diç sheh në kompjuter. Pastaj të jep kartën dhe nuk të thotë asgjë, as falemnderit. As unë si them. Trau hapet vetëm për makinat, ndërsa njerëzit kalojnë përanash.

Kaloj dhe eci në këmbë nëpër asfalt. Eci avash duke herdhur hapat dhe duke arritu të gjej pikën ndarëse mes dy vendeve (një vendi). Në natyrë nuk e gjej dot, dhe them me vete: mund të jetë më tej.

Gjithë sa kisha mësuar në shkollë dhe nga gjyshërit më vjen tash në mendje: Dibra kishte qenë qendër tregtie, qendër arsimi, qendër kulture, ndër qytetet më të zhvilluara të Perandorisë Osmane. Gjithë ajo fantazi ishte ndërtuar në mendjen time, e bashkë më të edhe një lloj patriotizimi për atë vend që prisja ta gjeja dhe ta merrja me elementin e parë të dibranit: mikpritjen.

Pasi eca edhe disa dhjetra metra, e gjeta pikën e ndarjes, apo të bashkimit të dy vendeve...ose jo, të ndarjes mëmire, sepse ishim bashkë para 1913, kështu që saktësisht vendin e ndarjes. Ishte vendi ku bashkoheshin dy asfaltet. Aty ku mbaronte i yni niste i Tyre. Asfalti Ynë, shumë më i ashpër, më i zi dhe fatkeqsisht më i varfër, që dmth me më pak zift, sepse gurëzit kishin zënë të shqiten prej ziftit. Ndërsa asfalti i Tyre, ishte më cilësor, me një ngjyrë gati gri, dhe shumë i shtypur, ndoshta mund të ishte edhe me i vjetër.

Pasi e kalova këtë pikëndarjeje (zonë neutrale), fillova të mendoj në lidhje me dakordësinë që kanë arritur palët për ta nisur (nëse e kanë nisur punën që aty) asfaltin, apo përfunduar (nëse kanë përfunduar projektin aty) në atë pikë hapsinore. Mos ndoshta Ata e lanë aty dhe Tanët e shtruan deri ku e kishin lënë Ata, apo mos Tanët e lanë aty, dhe Ata punuan derisa i ngjitën. Apo mos ndoshta e nisën punën që të dyja Palët njëherësh nga ajo pike, ose patën ngulur në cep të rrugës një rrasë guri, siç bënin më parë pleqtë dhe e përdorën si shenjë kufiri, apo mos ndoshta ndonjë topograf thjeshtë vendosi një piketë dhe ata e zbatuan si konvencion. S'ma do mendja se i lihet i gjithë ky fat një topografi.

Pas këtyre përsiatjeve (qënjë pjesë po i bëj tashti, sepse ia kam ngenë) afrohem tek pika doganore e Dibrës së Madhe.

Pasi i dorëzoj kartën e identiteti, zotëria që merret me verifikimin kontrollon nëpër kompjuter dhe ma kthen kartën mbrapsht. Nga gjuha nuk kuptoj asgjë sepse flet maqedonisht, por nga shenjat kuptoj se diçka nuk shkon. Duke menduar se mos i ka fajet karta e ID, i jap pasaportën. As kjo nuk bën punë. Ah...e gjeta çfarë donte.

Tërhiqem nga sporteli, fus në mes të pasaportës një 5 euro-sh, dhe ia dorëzoj sërish. Ai e merr, buzëqesh dhe më thotë shqip: kalo.

Të gjithë fantazitë dhe përfytyrimet e mia për Dibrën e matanshme, fillon dhe m'i zhbën ky zotëria që edhe di edhe nuk di shqip. Nëse është shqiptar dhe nuk di apo s'do të flasë shqip, atëherë turp për të. Por nëse është maqedonas dhe vjen në atë tra dhe shfrytëzon si mundet postin dhe dobësinë tonë, atëherë turp për të dyja Dibrat.

Më duhet të shkoj së pari në Dibër dhe marr një taksi. Taksiti një djalë diku 30 vjeç, flet shqip, shumë pastër. E flas kështu së punoj me shqiptarë mu përgjigj. Ai më çon tek stacioni i autobuzëve, sepse rruga ime është për në Shkup.

As ata të sportelit në stacion, një djalë dhe një vajzë mbi të 20-at nuk flasin shqip. Por çudi të bën fakti se pranojnë që biletat ti paguash në lek. Pastaj rruga për në Shkup më shijon e tëra, edhe pse e vras mendjen për këtë çerek-shqiptari.

Ora ime e fluturimit për Milano po afrohet. Garancinë për në Itali ma kishte sjellë me email një mik i imi. Ngaqë po prisja me padurim të vinte ora, nisem pak para kohe të shkoj në portën e cila pret fluturimin tim, por më parë duhet të kaloj kontrollin.

Zonja me flokët bionde që kontrollonte pasaportat e mbajti timen, pastaj një tjetër më orientoi për në një sallon ku prisnin disa tjerë si puna ime.

Fill pastaj vjen një burrë që sa ka filluar të thinjet, dhe me disa pasaporta në dorë thërret emrin tim:

-Unë jam.

-Ku e ke marrë këtë garanci? -më pyet teksa ma tund garancinë (fletën e pritjes) parasyve.

-Ma ka sjellë një miku im.- i them.

-Kjo është fallso.- thotë ai.

-E keni gabim zotëri. - i them më një zë sqarues.

-Jo mor, është fallso...fallsoooo.

-Më ka ardh më email, unë thjesht e kam printuar.- e sqaroj.

-Ça imeill muti.

-Ja ta hapim tek ai kompjuteri dhe ju'a vërtetoj.- ngulmoj unë.

-Hape çantën! - më urdhëron.

E hapa.

-Hape dhe këtë xhepin e vogël.

E hapa edhe atë. Edhe pasi e pa që nuk kishte asgjë të dyshimtë më tha më një zë të lartë:

-Zhdukuuu!

-Nga cila anë? - e pyes.

-Nga të duash.- thotë, dhe ma hedh pasaportën në atë far mënyre sa gati më bie duarsh.

Teksa zbrisja shkallët, po mendoja: një gjuhë e një-jtë, e njëjta kulturë, të njëjtat sjellje. A mos vallë njeriu i vendosi kufijtë thjeshtë për t'i thënë njëri-tjetrit se ne jemi ndryshe?!

BOTIME

"Grazhdani i Dibrës" i Neki Osmanit, një libër me shumë vlera

Nga **OSMAN XHILI**

Vetëm pak ditë më parë, në një nga lokalet e bukura anës rrugës, në hyrje të fshatit të Grazhdanit u organizua një festë e vogël, promovimi i librit "Grazhdani i Dibrës", me autor profesorin e nderuar të kësaj zone, Neki Osmani. Kishin ardhur shokë e miq të autorit nga Maqëllara, Peshkopia, nga Tirana, bashkëfshatarë të profesorit. Kishte ardhur televizioni i Bulqizës për të pasqyruar këtë event sa të bukur, aq dhe të rëndësishëm për komunitetin e më gjerë. Ishte i pranishëm redaktori i librit, doktor Hajri Mandri, gazetari dhe shkrimtari dibran, miku im i nderuar, Halil Rama, drejtori i T.V. Bulqizës, djali i fshatit të Grazhdanit, Edmond Isaku, Aqif Ademi. Në emër të bashkisë së Dibrës merrte pjesë Zamira Gjeleshi dhe plot të tjerë, prania e të cilëve i dha shkëlqim e kolorit këtij takimi mbresëlënës.

Sapo libri doli nga botimi dhe u hodh një njoftim i vogël në internet, qindra komente, falenderime, respekte vërshuan nga Dibra, nga Tirana, pse jo dhe nga Franca, Kili, Amerika, kudo ku jetojnë e punojnë grazhdanas dhe dibranë.

Në fjalën e tij, Hajri Mandri e vlerësoi mjaft punën e profesor Nekiut, si një përpjekje titanike, për të shpëtuar historinë e këtij fshati, që ajo të mos pësonte të njëjtin fat si Kalaja e Grazhdanit. Disa gjëra veniten, me kalimin e kohës, tha doktor Hajriu, të tjerat bëhen më të bukura e marrin ndriçim. Kjo vepër e profesor Nekiut, i takon kategorisë së dytë, pra, sa më shumë kohë të kalojë, aq më e vyer dhe më e kërkuar do të bëhet për njerëzit.

Vlerësim mjaft të mirë i bëri librit të këtij autori, gazetari dhe publicisti, Halil Rama. Ai tha se libri "Grazhdani i Dibrës", është një mal historie, është kryqëzim i ngjarjeve dhe i fakteve. Është lapidar i personazheve që kanë ecur përmes epokave, në rrjedhën e vazhdimësisë, është pasqyrim i vërtetësisë historike të vjetër e të re, është simboli i një rrjedhshmërie ku renditen me art dhe vërtetësi figura e personazhe të shquar. Në këtë libër, vazhdoi ai më poshtë, ka dendësi ngjarjesh dhe faktesh, që pasqyrojnë në nivele të larta individë, fise, fshatra dhe epoka, që kanë formuar e formatuar trashëgiminë e pasur të Dibrës, trimërinë, dinjitetin, bujarinë dhe zgjuarsinë e bijve të tij, duke u bërë i veçantë në historinë tonë kombëtare.



Foto gjatë promovimit të librit

Është për tu habitur se si autori i librit, profesor Nekiu i qëmton ngjarjet dhe faktet, tamam si ai arkeologu i kujdesshëm q mbledh copërat e një relike antike, apo si ai i paleontologu durimtar e stoik, që përpiqet të bashkojë në një trup të vetëm eshtrat e fosilizuara të një gjallese prehistorike. Nuk kishte se si historiku i këtij fshati të mos fillonte e të mos lidhej me kalanë e Grazhdanit, ndërtuar 2400 vjet më parë. Është për të vënë kujën, se si një monument kaq i madh në kohë dhe në shtrirje, (sipërfaqja e tij, 36 hektarë), të mbillet me grurë e misër, duke mbuluar mistere, që po t zbuloheshin, do të na jepnin lavdi dhe pasuri në të njejtën kohë.

Shumë e spikatur dhe korrekte është historia e fiseve të këtij fshati, një arkivë e vërtetë dhe e gjallë, të cilës me siguri do ti referohen njerëz të thjeshtë e studiues, sa herë që do tu duhet të shtjellojnë data, fakte, hipoteza apo mendime. Në matematikë ka disa teorema që pranohen pa vërtetim dhe q quhen lema, ndaj i tillë do të jetë dhe ky libër. Askush nuk do të diskutojë e hulumtojë më pas mbi gjërat e thëna këtu, por do ta marrë si të mirëqenë e të vërtetë të padiskutueshme. Çdo fis ka vlerat, personat dhe personazhet, që e lartësojnë dhe i japin shkëlqim. Njerëzit janë lulet që e bëjnë fisin një kurorë të bukur dhe fiset e bëjnë fshatin të tillë. Fshati i Grazhdanit është një bashkësi vlerash, saqë më kollaj është të tregosh çfarë nuk ka se të kundërtën. Ky fshat ka nxjerrë doktorë si Suzije Hoxha, farmacistë legjendarë si Faiz Halili, shoferë të talentuar si Pëllum Halili, Fadil Halili, Nuri Hoxha, këngëtarë si Ilmi Hoxha, Lirim Hoxha, Gerald Hoxha. Aty gjen profesorë të nderuar si Eqerem Hoxha, Xheladin Isaku, Abdi Spahiu, Neki Osmani, siç gjen mjeshtëra të krasitjes e të shartimit si Arif Hoxha. Ky fshat ka nxjerrë mundës të kategorisë së parë, siç ka nxjerrë dhe futbollistë të po këtij niveli. Ka nxjerrë valltarë dhe instrumentistë që kanë përfaqësuar jo vetëm fshatin, por vetë Dibrën në festivalin e Gjirokastrës dhe aktivitete të tjera.

Ky është Grazhdani i Dibrës dhe prapë asgjë nuk ke thënë për të. Sepse nuk ke përmendur ata burra trima që u përleshën fyt a fyt me serbin, se aq shumë e deshën lirinë dhe vatanin, më shumë se vetë jetën e tyre. Trima që shkuan, luftuan, ndoshta dhanë dhe jetën në luftën e Shkodrës ndaj Malit të Zi, luftëtarë që u rreshtuan në brigadat partizane,oficerë e komandantë me aftësi të spikatura. Grazhdani ka biznesmenë si Zaimi Korsi, Mond Isaku, Jashar Kurti e plot të tjerë, që dinë të punojnë, të fitojnë dhe një pjesë të këtyre fitimeve ti investojnë për njerëz në nevojë, për vepra bamirësie, apo, në art, kulturë, letërsi, media dhe të tjera drejtime si këto. Ndoshta do të thoshim dhe dy fjalë për emblemën e gjallë të këtij fshati Abdulla Agën, njeriun që po mbush shekullin. Abdullai ishte kryetari i parë i kooperativës, njeriu që përjetoi shumë ngjarje të rëndësishme të këtij fshati, anëtari i delegacionit shqiptar në Kinë, njeriu që u përpoq aq shumë për ndërtimin e rezervuarit të fshatit, ngritjen e blloqeve me pemë frutore, apo vreshtat që i rrinin fshatit si kurorë.

Nëse dikush do të dijë se si bëhej shirja e grurit disa dekada më parë, le të lexojë librin e profesor Nekiut. Nëse dikush tjetër kërkon të prodhojë e të përdorë niseshte bio nga gruri, le ta kërkojë atë në libër dhe me siguri do ta gjejë. Aty gjen ritet që janë përdorur nga njerëzit e këtij fshati, gjen fenë dhe besimin, pa të cilët nuk ka kuptim jeta dhe veprimtaria e një populli.

Nuk do ta tepronim po të thoshim se ky libër është një thesar vlerash, por ca më shumë se thesari i vërtetë, pasi atë mund ta lexojnë të gjithë, në të mund të marrë kush të dojë e çfarë të dojë dhe ai sërish nuk shteret e nuk pakësohet.

Rruga e Arbërit nr. 151


homazh

Homazh për një partizan të radhës së parë dhe një diplomat me 44 vjet karrierë...

Zeqi Agolli *dhe* **Mit'hat Frashëri** *në Betejën e Dibrës, nandor 1943*

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Zeqi Agolli iku nga kjo jetë në moshën 93 vjeçare. Për të nuk shkroi asnjë gazetë, nuk u dha asnjë lajm në mjetet e komunikimit masiv. Kryeministri u harrua në bisedat me këdo në facebook. Ministri Bushati nuk u fol se shkoi për ngushëllim (pa le të lironte hollin e Ministrisë për t'i bërë homazhe e nderime një diplomati karriere që zor se i afrohet kush). Mendjen e kishin tek eshtrat e kryetarit të Ballit Kombëtar...



Dipomati Zeqi Agolli së bashku me bashkëshorten e tij, regjisoren Drita Agolli në R.P. të Kinës.



Stokholm, janar 1985

Zeqi Agolli: "Unë kam lindur në Tiranë në 23 mars 1923. Prejardhjen e hershme e kam nga Dibra. Babai im më ka vdekur shpejt. Ai, së bashku me të vëllanë, Vehbi Dibrën (Agollin), kanë qenë ndër veprimtarët e veçantë në shërbim të Pavarësisë së vendit, ndërkohë që Vehbiu pati edhe post të lartë në qeverinë e parë, e dalë menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë."

BALLË PËRBALLË ME MIT'HATIN E "BALLIT KOMBËTAR"

1 nandor 1943

Tanë natën lufta vazhdoi pa u ndërpre...

... Hamdi Lleshi, ZeqiAgolli e shokë të tjerë, që përdorin mitralozët e randë të vendosur ***nalt, nën pullaz, janë flliqëduersh e turinjsh si të ishin farkëtarë. Por ata, në realitet, janë farkëtarë të jetës së re dhe do të mbeten të tillë derisa të realizohet ideali i tyne...***

Është ky një fragment i shkëputur nga shënimet ditë e natë të shkrimtarit partizan Haki Stërmilli në "Shtigjet e lirisë"...

Betejë e zhvilluar në Dibër të Madhe, në anën tjetër të kufirit shqiptaro- shqiptar, betejë midis forcave të rregullta partizane dhe atyre të parisë dibrane nën komandën e Mit'hatFrashërit të Ballit Kombëtar dhe Bazit të Canit të Legalitetit.

Po çfarë donte Mit'hatFrashëri dhe AbazKupi në Dibër në një moment kthese historike kur Italia fashiste kishte kapitulluar pa kushte dhe gjeneral Azzi, komandant i Divizioni "Firence", i ishte dorëzuar me gjithçka kundërshtarit të vetëm ndërluftues, Batalionit Partizan të Dibrës?

Shkurt, me pak fjalë, aq sa shënon në një ditar që bie era barot, shkrimtari dëshmitar me sy, me veshë e me laps në dorë,tregon se Mit'hati ato ditë ka udhëtuar pa pra që nga Lura, Peshkopia, Dibra e Madhe, Mati etj...

"Krenët e Dibrës, të nxitun prej Mithat-Frashërit, HasanDostit dhe IsufLuzës që kanë ***ardhë*** këtu***, kërkojnë me e marrë sundimin e vendit bashkë me depot e materialeve ushtarake që kanë lanë italianët dhe që tash janë në duart tona" (24 gusht 1943)***

Dy beteja, dy fitore të forcave partizane në Peshkopi dhe Dibër të Madhe dhe dy humbje, në Peshkopi dhe Dibër të Madhe, kur forcat e Parisë së Dibrës, Ballit e Legalitetit me në krye gjermanët e operacionit "Edelweis" (rreth 3000 vetë) armatosur me topa të kalibrit të lartë, mitraloza, tanke etj. shkatërruan në themele qytetet dhe plaçkitën si barbarëqyetarët...

"16 nandor 1943

Sot, në orën 10.30 paradreke, plasi pushka. Qyteti u sulmue nga të tri anët. Tash lufta zhvillohet e egër dhe sa shkon shtohet furia e saj rritet.. Tash, mbasdreke, anmiqtëfilluen me përdorë artileri dhe mortaja të randa. Qëllojnë me përpikmëri. Kuptohet se janë gjermanët ata që gjuajnë me kaq saktësi. Artilerinë e randë e kanë vendosë mbi majat, tej urës së Spiles. Nji predhë e artilerisë anmike tash ra mu në strehën e dritares sime...

...Nji autoblindë, e mbetur prej italianëve, u riparue dhe u nis me krye aksione kundër pozitave anmike.

... Autoblinda nuk mundi me ngadhënjye. Ajo paska shku jashtë qytetit dhe paska ndeshë në pritat e anmikut. Gjithashtu qenka gjuejtë edhe prej artilerisë anmike. Hamdi Lleshi dhe shoferi paskan ra dëshmorë..."

Dibra e Madhe ra nën breshërinë e topave, mortajave, bombave të rreth 3000 forcave gjermane, Ballit Kombëtar dhe të parisë së Dibrës. Me pushtimin e Dibrës së Madhe filloi Operacionin gjermano-ballist i Dimrit 1943-1944...

***

Nuk do ti kisha cituar këto ngjarje huajtur nga ditari "Shtigjet e Lirisë", sikur plot 75 vjet më vonë, në Tiranë të mos ishin hapur "dy varre", njeri në Parkun Kombëtar dhe tjetri në Varrezat e Tufinës. Njeri do të mbulonte eshtrat e Mit'hat Frashërit e tjetri trupin e ZeqiAgollit, njeri kryetar i Ballit Kombëtar dhe tjetri partizan...

ZeqiAgolli iku nga kjo jetë në moshën 93 vjeç. Për të nuk shkroi asnjë gazetë, nuk u dha asnjë lajm në mjetet e komunikimit masiv. Kryeministri u harrua në bisedat me këdo në facebook.

Ministri Bushati nuk u fol se shkoi për ngushëllim (pa le të lironte hollin e ministrisë për ti bërë homazhe e nderime një diplomati karriere që zor se i afrohet kush).

Mendjen e kishin tek eshtrat e kryetarit të Ballit Kombëtar... Vetëm një portal, Dibraexpres.com përcolli një shënim në internet, shoqëruar me një fotografi, po nga interneti...

"ZeqiAgolli (shkruante portali) **ka lindur në Tiranë më 23 mars 1923, në një familje me tradita patriotike. I ati i tij, Rexhep Agolli, ka mbështetur fuqishëm lëvizjen për pavarësinë e vendit...**

Xhaxhai i tij, Vehbi Dibra (Agolli), është një nga drejtuesit patriotë të vendit. Ai ishte pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në ngritjen e flamurit të Pavarësisë më 28 Nëntor 1912 kuu zgjodh Kryetar i Senatit të qeverisë së kryesuar nga IsmailQemali...

Arsimin fillor dhe të mesëm ZeqiAgolli e kreu në Tiranë. Studimet e larta i ka kryer në degën Histori- Gjeografi, të cilat i ka përfunduar në vitin 1957 me vlerësimin "shkëlqyer". Është njohës i shkëlqyer i pesë gjuhëve të huaja: italisht, frëngjisht, rumanisht, rusisht dhe anglisht...

ZeqiAgolli është diplomat i shquar, me një përvojë 44-vjeçare në karrierën e tij...

ZeqiAgolli është i shoqi i dramaturges dhe shkrimtares së madhe Drita Agolli, si dhe vëllai i artistes së famshme të Teatrit dhe Kinematografisë sonë Esma Agolli...

***

Unë e kam njohur ZeqiAgollin **në vjeshtë të vitit 1959 kur erdhi në fshatin tim në shoqërim të një delegacioni të huaj**. Më tërhoqi pamja e tij, trupi i gjatë e i drejtë, fisnikëria e komunikimi i ëmbël. Më ngeli (edhe sot) në kujtesë zëri i tij melodioz dhe frëngjishtja e rrjedhëshme si në një poezi...

Në vitin 1966-1967 do ta njihsha **më** nga afër, tash si kolegë pune në bujqësi, ai kryetar i kooperativës bujqësore të Dohoshishtit **e unë si përgjegjës sektori në Ndërmarrjen Bujqësore të Dibrës. Nuk erdhi vetëm. Erdhi bashkë me të shoqen** Drita Agolli dhe me nënën. La emër në Dohoshisht atyre viteve kur punohej për përmirësimin e jetës në fshat, për daljen në dritë të figurës së gruas dhe vajzës, për shkollimin e të rinjëve dhe të rejave asokohe në dy shkolle të mesme në qytetin e vogël të Peshkopisë, Shkollës së Mesme Pedagogjike dhe Shkollës së Mesme Bujqësore... Më vonë, sa herë që takoheshim ndjeja ngrohtësinë e një njeriu që dinte të tëhynte **në zemër** e të ulej këmbëkryq në shpirtin tënd...

***

Por kush është ZeqiAgolli?

Një përgjigje **që** një libër i tërë, në luftë kundër pushtuesit nazi-fashist dhe shërbëtorëve të tyre, nuk e nxë, mbase edhe dy...

Nga goja e tij le të shkëpusim disa fragmente nga "hyrja në një intervistë"... "Unë kam lindur në Tiranë në 23 mars 1923. Prejardhjen e hershme e kam nga Dibra. Babai im më ka vdekur shpejt. Ai, së bashku me të vëllanë, Vehbi Dibrën (Agollin), kanë qenë ndër veprimtarët e veçantë në shërbim të Pavarësisë së vendit, ndërkohë që Vehbiu pati edhe post të lartë në qeverinë e parë, e dalë menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë.

Është një nga liderët patriotë që në krye të delegacionit të Dibrës, mori pjesë direkt në ngritjen e flamurit tonë kombëtar në Vlorë në 28 Nëntor 1912.



Kajro, 29 nëntor 1975. Dalë në pritjen me rastin e festës me ambasadorin e Rumanisë, Petru Burlacu dhe bashkëshorten e tij, Helena.

Komuniteti dibran i Tiranës humbi një personalitet të spikatur të diplomacisë e mendimit, së bashku me regjisoren dhe profesoren e Akademisë së Arteve të Bukura, Drita Agolli!

Arsimin fillor dhe të mesëm ZeqiAgolli e kreu në Tiranë. Studimet e larta i ka kryer në degën Histori-Gjeografi, të cilat i ka përfunduar në vitin 1957 me vlerësimin "Shkëlqyer". Njohës i shkëlqyer i pesë gjuhëve të huaja: italisht, frëngjisht, rumanisht, rusisht dhe anglisht... Zeqi Agolli është diplomat i shquar, me një përvojë 44-vjeçare në karrierën e tij...



Pikërisht në mbledhjen e parë solemne, ku u ndërtua qeveria e parë e shtetit të ri shqiptar, e cila do të hynte fuqishëm në historinë e vendit, xhaxhai im, i propozuar nga patrioti i madh Luigj Gurakuqi, u zgjodh Kryetar i Senatit të saj dhe gjatë gjithë kohës së qeverisë së IsmailQemalit ai ka qenë krahu i djathtë i tij. Madje, vlen shumë të përmendet një fakt më se historik, ku tregon më së miri afrimitetin e tyre. Ky fakt ka të bëjë me momentin kur është larguar IsmailQemali në krye të delegacionit shqiptar për në Londër për të mbrojtur interesat e vendit. Si zëvendës të tij në detyrën e kryeministrit ai nuk la Nikollë Kaçorin, që ishte juridikisht zëvendëskryetar, por ia delegoi kompetencat për të nënshkruar të gjitha aktet e qeverisë në emër të tij, pikërisht Vehbi Dibrës. Ky detaj është dhe në rrëfimin e vetë Ismail Qemalit në botimin e tij...

Ne e kemi pasur babain në gjendje. Ai, kur vdiq në vitin 1934, e la nënën vetëm 34 vjeç, mua 11 vjeç, time motër Esmanë 6 vjeç dhe motrën e vogël Semihanë vetëm 9- muajshe...

Pushtimi i Shqipërisë, mua më gjeti vetëm gjashtëmbëdhjetë vjeç. Megjithatë, nuk e di, por isha i përgatitur psikologjikisht të bëja diçka dhe të mos pranoja në heshtje realitetin e zymtë të Shqipërisë së asaj kohe. Nuk e di as sot se çfarë më bëri aq të vendosur, që në ditët e para kur prisnim me orë pushtimin...

...Unë kam qenë aktiv që në demonstratat e datës 4, 5 dhe 6 prill 1941, kur pritej të hynte ushtarakisht Italia fashiste...

...Ishte pasdreke e datës 6 prill 1939. Nëna ime, Ija, po lante rrobat në pusin e oborrit të shtëpisë. Kur në një moment dëgjojmë zhurmën e skuadriljeve të avionëve ushtarakë italianë që kalonin mbi qiellin tonë. Ija u ngrit në këmbë, ngriti sytë drejt aeroplanëve, përplasi duart në shenjë alarmi dhe me lot në sy thirri me të madhe: "Na iku Shqipëria". Kur pashë nënën ashtu duke qarë dhe dëgjova fjalët e saj aq të zjarrta për Shqipërinë, m›u rrëqeth trupi dhe nuk munda t›i mbaja lotët. Ky ishte mësimi më i mirë patriotik për atdheun që ma dha nëna ime e shtrenjtë, Ija ime e dashur. Kam qenë veçse 16 vjeç, por nuk e di, më dukej vetja shumë i burrëruar. Kisha një idealizëm patriotik që më digjte të tërin. Në çdo çast zieja për faktin se si mund një ushtri e huaj të vijë e të bëjë ligjin në shtetin tonë. Ndoshta është ajo mosha adoleshente dhe patriotizmi që karakterizonte fuqishëm djalërinë shqiptare në atë kohë.

Kështu, me gjithë nënën time e kthyem shtëpinë ku banonim në bazë të sigurtë të lëvizjes nacionalçlirimtare.

Në të kanë hyrë që nga Enver Hoxha, Qemal Stafa, Vukvanoviç Tempo me sekretaren e tij që më mbrapa u bë gruaja e tij, Miladin Popoviçi, Vojo Kushi, Gogo Nushi, Nako Spiru, Ramiz Alia, Ali Sina, Ali Zhuri, Galip Hatibi, Skënder Kosturi, Myfaret Dhrami, Jashar Mezelxhiu, Sadik Premtja, Sejfulla Malëshova, Misto Mame, Pirro e Alqi Kondi, Nexhmije Xhuglini, Naxhije Dumi, Liri Gega, Jovan Andoni, Fiqiri Basha etj.


Ka qenë një nga bazat kryesore të luftës. Pikërisht në shtëpinë time është zhvilluar Konferenca e Jashtëzakonshme e Partisë Komuniste.

Ka qenë një mbledhje që zgjati plot katër ditë e katër net, pa u ndërprerë që nga momenti kur ilegalët u futën brenda në dhomën e katit të dytë të sajuar për takim të posaçëm. Mbaj mend që punonin me orë të tëra në konferencë, ku dëgjoheshin debate e përplasje. Ishin rreth 15 veta gjithsej... Zeqiu, djalë i vetëm i familjes së Rexhep Agollit, vëllai i dy motrave dhe i një nëne dibrane trimëreshë, do të rrëmbente pushkën e do të dilte malit.

Atë do ta shohim trim në betejën e Dibrës së Madhe, partizanin ***"Zeqi Agolli e shokë të tjerë, që përdorin mitralozët e randë*** të vendosur ***nalt, nën pullaz, janë fliqëduersh e turinjsh si të ishin farkëtarë. Por ata, në realitet, janë farkëtarë të jetës së re dhe do të mbeten të tillë derisa të realizohet ideali i tyne..."***

Përballë kishte Mit'hatFrashërin... E mundi 75 vjet më parë...

Ndahet nga jeta diplomati dhe poligloti Zeqi Agolli



Unda nga jeta, më 18.11.2018, Zeqi Agolli, veteran i LANÇ dhe për disa kohë shef i Departamentit të Jashtëm në Komitetin Kombëtar të Veteranëve të LANÇ.

Zeqi Rexhep Agolli lindi në Tiranë më 23 mars 1923, në një familje patriotike dhe të lidhur ngushtë me luftën kundër pushtuesve të huaj, madje duke qenë Shtëpi Bazë e LANÇ. I Ati i tij, Rexhep Agolli, ishte burrë i nderuar dhe si financier i zoti, mbështeti fuqishëm lëvizjen për pavarësinë e vendit së bashku me të vëllain Vehbi Dibra (Agolli) që ishte një ndër nismëtarët e shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, dhe mori pjesë në ngritjen e Flamurit në Vlorë, më 28 Nëntor 1912, dhe në formimin e qeverisë së parë nën drejtimin e Kryeministrit Ismail Qemali, ku Vehbi Dibra u zgjodh kryetar i Senatit të qeverisë. Zeqi Agolli ishte bashkëshorti i Drita Agollit, regjisores së parë grua në Shqipëri, si dhe aktore, pedagoge dhe shkrimtare, e nderuar me titullin e lartë "Mjeshtre e Madhe e Punës". Ai ishte edhe vëllai i artistes së njohur të Teatrit Kombëtar dhe Kinematografisë shqiptare Esma Agolli. Pas çlirimit të vendit, Zeqi Agolli kreu studimet e larta në fakultetin e Histori-Gjeografi. Ishte njohës i pesë gjuhëve të huaja, italisht, frëngjisht, rumanisht dhe anglisht. Që në moshë të re Zeqi mori pjesë në grupet e edukimit në Tiranë, u aktivizua në aksione të ndryshme me rininë antifashiste që u zhvilluan në Tiranë në mbështetje të LANÇ. Ai mori pjesë në shpërndarjen e trakteve luftarake dhe në demonstratat që u organizuan në qytetin e Tiranës.

Shtëpia e Zeqi Agollit ka qenë një nga bazat më të fuqishme të njësive guerile të Tiranës. Në këtë bazë kanë hyrë udhëheqësit kryesorë të PKSH dhe LANÇ, si Enver Hoxha, QEmal Stafa, Misto Mame, Vojo Kushi, Gogo Nushi, Nako Spiro, Nexhmije Xhuglini (Hoxha), Ramiz Alia etj. Enver Hoxha qëndroi 9 muaj tek ajo shtëpi bazë e LANÇ.

Në 23 nëntor 1941 Zeqi Agolli mori pjesë në themelimin e Rinisë Antifashiste Shqiptare. Në shkurt të vitit 1943 u pranua anëtar i PKSH, në qershor 1943 zgjidhet anëtar i KQ të Rinisë Antifashiste. Në shtator të vitit 1943 caktohet sekretar politik i Rinisë Antifashiste të Dibrës së Madhe. Në të njëjtën kohë zgjidhet sekretar i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar të Qarkut Dibër, me Kryetar Haki Stërmillin. Në nëntor 1943 hyri në radhët e batalionit partizan të Dibrës së Madhe, me Komandant Haxhi Lleshi, Hero i Popullit, dhe mori pjesë me armë në dorë në luftimet e batalionit deri në çlirimin e plotë të vendit tonë, më 29 Nëntor 1944. Në gusht 1944 caktohet Sekretar Politik i KQ të Rinisë Antifashiste në Peshkopi. Mbas çlirimit të vendit Zeqi Agolli shërbeu si shef kabineti i Enver Hoxhës.

Dy vjet më pas, punoi për mëse 42 vjet me radhë në funksione të ndryshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme, si drejtues dhe diplomat në krye të disa ambasadve të vendit tonë në shumë shtete të botës. Pas një karriere të gjatë dhe të suksesshme diplomatike, në vitin 1988 në moshën 65 vjeçare, Zeqi Agolli doli në pension.

Ai ka qenë një prind shembullor që ka ditur me bashkëshorten, Dritën të edukonin, dy vajza të mrekullueshme, Tamarën dhe Elirën, të cilat kanë shërbyer me përkushtim në sektorë të ndryshëm të vendit. Për punë korrekte dhe si kuadër me dinjitet, Zeqi Agolli është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me disa urdhra dhe medalje. Si gjithë të tjerët Zeqi ka përkrahur dhe ka ditur të orientohet drejt në proceset demokratike të vendit tonë pas vitit 1990. Mbas daljes në pension u anëtarësua në Organizatën e Veteranëve të LANÇ, Zona nr. 2, në njësinë administrative nr. 2. Ka qenë gjithnjë i përkushtuar në zbatimin e detyrave të ngarkua duke kontribuar në mbrojtjen e vlerave të LANÇ dh propagandimin e tyre në radhët e brezit të ri. Për kontributin e dhënë ka qenë zgjedhur në disa konferenca Anëtar i Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Popullit Shqiptar. Është vlerësuar me titullin e lartë "Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ".


Me vdekjen e tij familja humbi njeriun e saj më të dashur dhe ne një shok besnik të idealeve të LANÇ. Në emër të Kryesisë së Komiteit Kombëtar, si dhe personalisht të Kryetarit Rustem Peçi, Sekretarit të Përgjithshëm Odise Porodini dhe Kryekëshilltarit të Komitetit Kombëtar Ziqiri Mero, i shprehim familjes ngushëllime më të thella për humbjen e njeriut të tyre të shtrenjtë.

Zeqi Agolli u nda nga jeta më 18.11.2018 dhe u përcoll me gjithë nderimet që meritonte.

Për të gjithë rolin dhe kontributin e tij është vlerësuar nga miqtë dhe dashamirësit e tij. Para disa muajsh u nda nga kjo jetë dhe bashkëshortja e tij Drita Agolli. Tashmë ato janë së bashku në jetën e amshueshme. I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre. Komuniteti dibran i Tiranës humbi një personalitet të spikatur të diplomacisë e mendimit, së bashku me regjisoren dhe profesoren e Akademisë së Arteve të Bukura, Drita Agolli!

U prehshi në paqe!

Rruga e Arbërit nr. 151



BOTIMET M&B

Një falënderim pas Panairit të Librit

Pas përfundimit të Panairit të 21-të të Librit, gjejmë rastin të falënderojmë publikisht të gjithë poetët e shkrimtarët që me botimet e tyre e zbukuruan stendën tonë.

Pjesëmarrja jonë në panair, duke filluar që nga viti 2012, është një angazhim i yni për t'u krijuar një mundësi autorëve dhe bashkëpunëtorëve tanë të prezantohen para lexuesit.

Në një treg me shumë vështirësi, aq më tepër kur hapësirat ngushtohen gjithnjë e më tepër për librin, pjesëmarrja në panair nuk është një dëshirë e jona, por një detyrim i yni ndaj autorëve që kanë zgjedhur që botimet e tyre të mbajnë logon tonë.

Stenda jonë në panair kishte mbi 140 tituj librash, gjysma e tyre të botuar vitin e fundit, ndërsa pjesa tjetër janë disa tituj që janë botuar 3-5 vitet e fundit, por që vazhdojnë akoma të kenë vëmendjen e lexuesit.

Shumë prej jush më pyesin nëse "shitëm" libra gjatë ditëve të panairit, por ne jemi të kënaqur të themi se jo vetëm kemi shitur, por edhe kemi vendosur kontakte te reja me librari e shpërndarës libri, me të cilët shpresojmë që gjatë vitit të kemi bashkëpunime të mira.

Megjithatë, mes autorëve më të shitur në stendën tonë ishin librat e Agron Tufës, Artan Gjyzel Hasanit, Xhafer Martini, Ramiz Gjinit, Munir Shehut, Sadik Lalës etj. I falënderojmë për besimin dhe mbështetjen e tyre.

"Thembra e Akcilil" dhe "Letërsia dhe procesi letrar në shekullin e XX" të Agron Tufës, vëllimi poetik "ID" dhe romani "Funeral" i Artan Gjyzel Hasanit, vëllimi me tregime "Posta që sjell era" dhe romani "Pëllumbat e rrugës" të Ramiz Gjinit, "Rrëfime dhe këngë popullore – Dibra 2" të Munir Shehut (përgatitur për botim nga i biri, Mirdash Shehu), ishin librat më të shitur në këtë panair. Po ashtu, vërejmë me kënaqësi që edhe "Kanuni i Dibrës" i Xhafer Martinit dhe "Historia e Dibrës" i Kristo Frashërit mbeten dy nga botimet tona që tërheqin akoma vëmendjen e lexuesit.

Risi e botimeve tona ishte edhe librit "Psikopatologjia" i prof.dr. Sadik Lalës, i cili, megjithëse ribotim, pati interes të dukshëm. Po ashtu, edhe dy botimet e prof. Adem Bungurit, "Prehistoria e Dibrës" dhe "Studime për prehistorinë e Shqipërisë (tashmë edhe në gjuhën angleze), patën interes nga studiuesit e fushës.

Falënderim i pamasë shkon për vizitorët në stendën tonë, me të cilët kemi ndarë sugjerime e biseda rreth librit, kemi marrë ide e mbështetje prej tyre. Ju kujtojmë të gjithëve se libraria jonë në rrugën "Isa Boletini" është një panair i hapur gjatë gjithë vitit.

Një falënderim shkon edhe për botimet "Naimi", me të cilët nuk ndajmë vetëm hapsirën e stendës dhe kostot e pjesëmarrjes në panair, por edhe një kohë të çmuar së bashku me librat dhe për librat.

M&B BOTIME DHE STUDIO GRAFIKE
Rruga "Isa Boletini", Nd.2, H.12,
Nj.Admin.nr9, 1017, Tiranë
Tel: +355 4 22 33 283
Mob. 069 20 68 603 (Viber).
Mob. 068 65 08 441 (ËhatsApp).
E-mail: **mbbotime@gmail.com**
Facebook: **https://goo.gl/hj606c**
ëëë.mbbotime.com
Vendndodhja në hartë: **https://her.is/2moOba1**

LIBRI I RI

MUNIR SHEHU

"Rrëfime dhe këngë popullore"

Histori, portrete dhe shënime të tjera
– Dibra 2 (1860 - 1913) –



MUNIR SHEHU: *"*Me dokumentacionin rreth ngjarjeve janë marrë e vazhdojnë të merren shumë historianë, kështu që unë jam i lirë të vazhdoj rrugëtimin tim në popull, në përmbushje të qëllimit që i kam vënë vetes herët, mbledhjes së folklorit, rrëfimeve gojore apo këngëve, ku, natyrisht, edhe këtë periudhë legjendare të historisë së tij, populli vetë e ka përjetësuar në morinë e pafund të vargjeve e melodive të epikës historike. Këto këngë shprehin urrejtjen e thellë ndaj lakmive të fqinjëve dhe fuqive të mëdha, kundër atyre që duan të bëjnë tregti me tokat e shqiptarëve, trimërinë, besën e tyre. Ato përshkohen nga fillimi në fund nga dëshira për liri, duke na i paraqitur me shumë vërtetësi ngjarjet e me larminë e pashtershme të motiveve, kanë një bukuri që të len pa mend.

...

Nuk duhet të ketë plagë ma të randë për nji popull, sesa ajo kur atij i mungon pushteti, regjimi, qeverisja që i duhet.

Botimet M&B | ISBN: 978-9928-256-58-4 | Faqe : 272
Formati: 155 x 235 mm | Çmimi: 1000 lekë



ëëë.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

cyan magenta yelloë black